



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT PËR VITIN 2019

Gusht, 2020

Tabela e përmbajtjes

Lista e shkurtesave.....	4
Fjala e Auditorit të Përgjithshëm.....	5
Hyrje	6
Pjesa I: Pasqyrat Financiare Vjetore	12
1 Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore 2019	12
1.1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	13
1.2 Opinioni i auditimit	15
2 Analiza e Buxhetit Shtetëror	21
2.1 Analiza e të hyrave të përgjithshme buxhetore dhe e shpenzimeve	24
2.2 Pasqyra e pasurive në para të gatshme dhe bilanci i fondeve.....	41
2.3 Deklarata për kufirin e deficitit buxhetor	44
3 Analiza e shënimeve shpjeguese	46
3.1 Konsolidimi i të dhënave nga Pasqyrat individuale me Pasqyrat e Qeverisë.....	46
3.2 Baza e përgatitjes, politikat kontabël dhe raportimi	47
3.3 Borxhet publike dhe Garancitë shtetërore	48
4 Pasuritë dhe stoqet	54
5 Llogaritë e arkëtueshme	58
6 Detyrimet e papaguara dhe kontingjente	61
6.1 Detyrimet kontingjente.....	63
7 Pagesat sipas nenit 39.2 të LMFPF	66
7.1 Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përbarimore	66
8 Të dhënat e punësimit.....	69
8.1 Të punësuarit jashtë listës së pagave dhe me kontrata për shërbime të veçanta	70
Pjesa II - Të përgjithshme	72
9 Zbatimi i rekomandimeve	72
9.1 Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në RVA për vitin 2018	72
9.2 Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale 2018	73
10 Opinionet e auditimeve në raportet individuale	76
10.1 Rekomandimet e dhëna në raportet individuale për vitin 2019.....	76

11 Sistemi i auditimit të brendshëm	78
12 Prokurimi	80
12.1 Çështjet e rregullsisë në fushën e prokurimit	80
13 Aplikueshmëria e ligjeve dhe sfidat ligjore	83
14 Auditimet e performancës	86
15 Ndërmarrjet publike.....	94
15.1 Opinionet e auditimit për ndërmarrjet publike	95
15.2 Rekomandimet e vitit paraprak	97
15.3 Prokurimet në ndërmarrjet publike.....	98
15.4 Analiza e gjendjes financiare në ndërmarrjet publike	101
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuar nga ZKA	103
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në RVA 2018.....	105
Shtojca III: Pasqyrat kryesore financiare të Qeverisë 2019	116
Letërkonfirmimi nga Ministria e Financave	120

Lista e shkurtesave

AP	Auditori i Përgjithshëm	MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit	MF	Ministria e Financave
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës	MAPL	Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal
BB	Banka Botërore	MFPP	Menaxhimi i Financave Publike dhe Përgjegjësitë
BE	Bashkimi Evropian	MAP	Ministria e Administratës Publike
BPV	Bruto Produkti Vendor	MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
BRK	Buxheti i Republikës së Kosovës	NJQH/AB	Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm
BQK	Banka Qendrore e Kosovës	NjAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
DK	Doganat e Kosovës	NP	Ndërmarrjet Publike
DUD	Dokumenti Unik Doganor	OB	Organizata Buxhetore
GPD	Grantet e Përcaktuara të Donatorëve	OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar	PFV	Pasqyrat Financiare Vjetore
IFN	Institucionet Financiare Ndërkombëtare	SHSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
KA	Komiteti i Auditimit	RFV/BRK	Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës
KBFP	Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike	RVA	Raporti Vjetor i Auditimit
KMFP	Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike	SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës
LMFPP	Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë	SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
LPP	Ligji për Prokurim Publik	SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik
LSHC	Ligji i Shërbimit Civil	SFQ	Statistikat Financiare Qeveritare të FMN-së
LLVTH	Llogaria e Vetme e Thesarit	ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
KOSTT	Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës		
KRPP	Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik		
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli		

Fjala e Auditorit të Përgjithshëm



Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Puna jonë është bazuar në Planin strategjik 2018-2021. Synimi jonë përmes këtij plani, krahas auditimeve të detyrueshme, ka rritjen e vazhdueshme të numrit të auditimeve në ndërmarrjet publike, auditimin e performancës dhe projekteve tjera kryesisht të financuara nga donatorët si dhe forcimin e kapaciteteve tona. Gjatë vitit raportues 2019, kemi audituar 95 organizata buxhetore me një buxhet të përgjithshëm rreth 2.5 miliardë euro, 14 ndërmarrje publike kryesisht në fushën e telekomunikimit, furnizimit me ujë dhe trajtimit të mbeturinave, 13 auditime të performancës si dhe 9 projekte të financuara nga fondet e donatorëve.

Auditimi i fondeve publike këtë vit ka qenë sfidues për shkak të ndikimit të pandemisë COVID 19. Balancimi i nevojave për ruajtjen e shëndetit të auditorëve dhe paralelisht zbatimi i mandatit duke siguruar cilësinë e punës sonë ka shkaktuar vonesa në disa raporte individuale të auditimit, por kam kënaqësinë që përkundër kushteve të rënda të punës t'iu dorëzoj me kohë Raportin Vjetor të Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Buxhetit të Republikës të Kosovës për vitin 2019 dhe kështu të përmbyllim me sukses të plotë vitin e auditimit. Përveç performancës financiare të Qeverisë, ky raport ofron informata shtesë edhe për fushat tjera që kanë të bëjnë me afarizmin e ndërmarrjeve publike, performancën e shpenzimeve të fondeve publike (ekonomizimi, efektiviteti dhe efikasiteti), si dhe zbatimin e procesit të prokurimit e raportimit financiar.

Duke qenë se kërkesat e publikut për llogaridhënie po rriten gjithnjë e më shumë, të njëjtat Zyra Kombëtare e Auditimit po vazhdon t'i trajtojë me kujdes dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse, me qëllim që Kuvendit dhe qytetarëve t'u ofroj informacionin e duhur se si fondet publike po administrohen nga ana e Qeverisë dhe shfrytëzuesit tjerë.

Fokusi parësor i punës sonë kanë qenë vlerësimet për cilësinë e raportimit financiar, dizajnimin dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Përmes procesit të auditimit kemi konstatuar se ka një progres të lehtë në fushën e raportimit financiar por mangësitë dhe dobësitë më të theksuara vazhdojnë të mbeten në aktivitetet ekzekutive të buxhetit ku shumë projekte kapitale fillohen pa fonde të mjaftueshme, dhe për shkak të kësaj, ato rrallë herë përfundohen me kohë, ndërkohë që mbikëqyrja nuk parandalon devijimet e shumta nga kushtet e përcaktuara me kontrata. Ne, megjithatë, po vazhdojmë të punojmë ngushtë me subjektet e audituara dhe Kuvendin, në mënyrë që t'i adresojmë sa më mirë këto sfida, si dhe të promovojmë praktika të mira të qeverisjes.

Në mënyrë të veçantë Qeveria ka nevojë të forcoj disiplinën financiare, sepse shumat e detyrimeve të papaguara dhe llogarive të arkëtueshme kanë arritur shifra të larta, dhe pa dyshim janë sfidat kryesore të Qeverisë derisa regjistrimi dhe menaxhimi i pasurive paraqet një problem të përsëritur prej shumë vitesh, dhe progresi në këtë fushë është i varfër.

Në fund, falënderoj Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Komisionet parlamentare për bashkëpunimin korrekt dhe mbështetjen e gjithanshme në përmbushjen e misionit tonë, subjektet e audituara për bashkëpunimin e tyre gjatë procesit të auditimit edhe në këto kushte të pandemisë, deri sa jam pafundësisht mirënjohës personelit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të cilët rrezikuan shëndetin e tyre dhe me përkushtimin e profesionalizmin e treguar mundësuan zbardhjen e të gjitha raporteve para Kuvendit e Publikut që janë në mandatin tonë.

Auditori i Përgjithshëm,
Besnik Osmani

Prishtinë, Gusht 2020

Hyrje

Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) paraqet një dokument përmbledhës të gjetjeve dhe konkluzioneve të auditimit, si dhe rekomandimeve të dhëna për vitin fiskal 2019 dhe shpreh Opinionin e Auditimit (në përputhje me SNISA 200) për Raportin Vjetor Financiar të Qeverisë së Kosovës për vitin 2019. Raporti prezanton një përmbledhje të çështjeve kyçe në fushën e menaxhimit financiar dhe kontroleve dhe i mundëson Kuvendit inicimin dhe zbatimin e llogaridhënies financiare të Qeverisë për përdorimin e burimeve publike. Në këtë raport, fushë e veçantë e rishikimit është Raporti Vjetor Financiar i Qeverisë, por pjesë të raportit janë edhe gjetjet dhe konkluzionet e dala nga raportet individuale të auditimeve të kryera për organizatat buxhetore dhe autoritetet tjera publike veç e veç.

Prandaj, raporti paraqet një verzion të zgjeruar, dhe përveç auditimeve financiare, përfshin edhe një numër informatash për llojet tjera të auditimeve të kryera gjatë sezonit auditues 2019/2020, siç janë auditimet e performancës, të menaxhimit, sistemeve, projekteve, etj.

Përkundër shumë sfidave për shkak të pandemisë, ne edhe gjatë këtij viti kemi arritur që të raportojmë me kohë auditimin e PFV të Qeverisë, dhe në këtë mënyrë i kemi dhënë mundësinë edhe Kuvendit, edhe Qeverisë, që të mbyllë ciklin buxhetor në pajtim me afatet ligjore. Kjo ka bërë të mundur shqyrtimin me kohë të raporteve dhe adresimin e rezultateve të auditimit nga të gjithë akterët. Ne jemi të kënaqur me faktin se kemi vërejtur një interesim në rritje nga të gjitha palët e interesit për rezultatet e auditimit. Megjithatë, për shkak të procesit zgjedhor, komisionet parlamentare, por edhe organet tjera për shqyrtimin e rezultateve të auditimit, nuk i kanë shqyrtuar shumicën e raporteve tona të vitit 2018, përfshirë edhe Raportin Vjetor të Auditimit.

Raporti është përgatitur në dy pjesë kryesore:

- (a) Pjesa e parë e raportit i dedikohet Pasqyrave Financiare Vjetore të Qeverisë për vitin 2019; dhe
- (b) Pjesa e dytë paraqet informata të rëndësishme për vitin raportues, por që nuk kanë ndonjë lidhje direkte dhe nuk i ndikojnë PFV-të e Qeverisë.

Pjesa e parë përmban tetë kapituj kryesor që janë pjesë përbërëse të PFV të BRK: (1) Opinioni i auditimit; (2) Analizat e Buxhetit Shtetëror; (3) Analiza e shënimeve shpjeguese; (4) Pasuritë dhe stoqet; (5) Llogaritë e arkëtueshme; (6) Detyrimet e papaguara dhe kontingjente; (7) Pagesat direkte nga Thesari dhe pagesat sipas vendimeve gjyqësore; dhe (8) Të dhënat e punësimit.

Pjesa e dytë përmban informacione për çështjet si vijon: (9) Zbatimin e rekomandimeve nga vitet paraprake; (10) Opinioneve të auditimeve individuale; (11) Sistemi i auditimit të brendshëm; (12) Prokurimi; (13) Aplikueshmëria e ligjeve dhe sfidat ligjore; (14) Auditimet e performancës; dhe (15) Ndërmarrjet publike.

Përveç dy pjesëve kryesore, raporti ka edhe tri Shtojca, të cilat kanë të bëjnë me: (1) Shpjegimi i llojeve të opinioneve të aplikuara nga ZKA; (2) Progresi në zbatimin e rekomandimeve; dhe (3) Tri Pasqyrat Financiare kryesore të Qeverisë. Informacione më të hollësishme për raportet individuale të auditimit, mund të gjeni në faqen tonë të internetit: www.zka-rks.org

Përmbledhje e përgjithshme

Në pajtim me Planin vjetor të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2019 ka kryer 132 raporte, prej të cilave: 95 auditime të rregullsisë për organizatat buxhetore, 14 auditime të ndërmarrjeve publike, 9 auditime të projekteve të Bankës Botërore dhe donatorëve tjerë dhe 13 auditime të performancës, përfshirë këtu edhe Raportin për Pasqyrat Financiare të Qeverisë. Rezultatet e këtyre auditimeve janë përmbledhë në mënyrë gjithëpërfshirëse në këtë Raport.

Sipas opinionit të Auditorit të Përgjithshëm, Pasqyrat Financiare Vjetore të Qeverisë për vitin 2019 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale

(Opinion i Pamodifikuar me Theksim të çështjes). Më gjërësisht, shih kapitullin 1.2.

Megjithatë, auditimet e vitit 2019 kanë nxjerrë në pah një sërë mangësish dhe dobësish në shumicën e organizatave buxhetore, të cilat karakterizojnë një menaxhim të dobët të fondeve buxhetore, si dhe mos arritjen e vlerës për para. Një çasje sistematike dhe më e fokusuar në zgjidhjen dhe adresimin e problemeve të identifikuara, do të ishte më se e nevojshme, në mënyrë që t'i hapet rrugë menaxhimit më të mirë dhe shërbimeve më të mira për qytetarët.

Konkluzionet kryesore të raportit nënvizojnë nevojën për një vëmendje të shtuar të drejtuesve të lartë dhe mbajtësve të buxhetit për forcimin e masave dhe përmirësimin e proceseve në fushat e identifikuara si në vijim:

(a) Planifikimi dhe realizimi i buxhetit- Përgatitja e buxhetit për vite me radhë vazhdon të mbetet një nga sfidat kryesore të Qeverisë. Analizat nga rishikimet tona shpalosin mospërputhje domethënëse në mes planifikimit të pranimeve buxhetore dhe shumave aktuale të këtyre pranimeve. Shuma aktuale e pranimeve në fund të vitit ishte për 258 milionë më e ultë sesa pranimet e parashikuara me buxhet final, apo realizimi kundrejt planifikimit ishte 89.6%. Situatë e njëjtë lidhur me planifikimet buxhetore ishte edhe gjatë vitit paraprak. Ndërsa, sa i përket planifikimit të shpenzimeve, ato sipas buxhetit final ishin projektuar me një deficit buxhetor prej rreth 37 milionë euro, por ky projeksion nuk ishte realizuar, dhe në fund të vitit shuma totale e pranimeve ishte shpenzuar në shkallën prej 96.8%. Pra, fondet buxhetore nuk ishin shpenzuar në shumën prej rreth 70 milionë euro.

Qeveria gjatë vitit 2019 nuk kishte bërë rishikim të buxhetit, dhe si rezultat i kësaj, buxheti nuk ka pasur korrigjime, respektivisht diferenca të mëdha në mes buxhetit fillestar dhe atij final sa i përket pranimeve, por një diferencë më e theksuar vërehet te shpenzimet, ku buxheti final kishte rezultuar me një rritje pre 65 milionë kundrejt atij fillestar. Pra, për shkak se projeksionet fillestare në shumë elemente ishin jo adekuate, dhe mungesës së rishikimit gjatë vitit, planifikimet e pranimeve buxhetore dhe pagesave kundrejt ekzekutimit, kanë rezultuar me përqindje relativisht të lartë të shpërputhjeve.

Konkluzionet e auditimit janë se procesi i përgatitjes së buxhetit shtetëror shoqërohet me mangësi, prandaj, si i tillë, duhet të kalojë nëpër disa procedura më efektive të kontrollit gjatë miratimit, për shkak se ne kemi vërejtur një komunikim të pamjaftueshëm në mes të departamenteve të Ministrisë së Financave, në veçanti Departamentit për politikën makroekonomike, Departamentit të buxhetit dhe Thesarit.

(b) Cilësia e raportimit - Pasqyrat Financiare Vjetore janë përgatitur brenda afateve ligjore. Thesari kishte dorëzuar në Qeveri për aprovim Pasqyrat më 23 mars 2020, ndërsa të njëjtat në mënyrë zyrtare i janë dorëzuar ZKA-së për auditim më 25 mars 2020. Pas rishikimeve analitike, ZKA ka vërejtur disa paqartësi dhe moskonsistencë të të dhënave në Pasqyra, dhe të njëjtat janë diskutuar me zyrtarët e Ministrisë së Financave. Pas diskutimeve të hollësishme, Pasqyrat në disa pjesë të caktuara, janë plotësuar me informata shtesë, sidomos në pjesën e shpalosjeve dhe pas korrigjimeve të sugjeruara nga ana jonë, Thesari ka dorëzuar draftin e dytë më 22.07.2020, të aprovuar më parë edhe nga Qeveria.

Siç u tha më sipër, për shkak të bashkëpunimit të mangët në mes departamenteve/strukturave të ministrisë dhe mos sqarimit me kohë të zërave të paraqitur në Tabelën 1 të Buxhetit, Pasqyrat Financiare kishin rezultuar me një mbivlerësim që ka të bëjë me Të Hyrat Vetiake të bartura të komunave nga vitet e mëparshme, të cilat ishin planifikuar sërish si pranime buxhetore, edhe pse të njëjtat ishin mbledhur dhe deponuar në llogarinë e Thesarit gjatë vitit paraprak dhe viteve të mëhershme. Me rastin e përgatitjes së PFV-ve, Thesari në respektim të obligimit ligjor si dokument referues ka përdorë informatat nga Tabela 1 e ligjit, tabelë e cila ishte përcjellë me gabime qysh në fazën e aprovimit të buxhetit për vitin 2019. Përndryshe, pasqyrat financiare, nga viti në vit janë gjithnjë e më cilësore, më gjithëpërfshirëse dhe me shpalosje më të plota. Në kapitujt tjerë të këtij raporti, do të flitet më gjerësisht lidhur me procesin e përgatitjes të PFV-ve dhe cilësinë e informatave të prezantuara.

(c) Keqklasifikimi i shpenzimeve - Dobësitë e identifikuar gjatë procesit përgatitor të buxhetit vjetor po përsëriten në mënyrë sistematike në disa fusha, dhe përmirësimet janë të ngadalshme. Përveç shpërputhjeve në planifikimin e të hyrave dhe shpenzimeve, dukuria më e theksuar është edhe planifikimi i shpenzimeve nëpër kategoritë jo adekuate buxhetore, me ç'rast kategoria më e atakuar vazhdon të mbetet ajo e Investimeve kapitale. Për shkak të ruajtjes së strukturës buxhetore sipas rregullave fiskale, në kategorinë e Investimeve kapitale përfshihen edhe projekte që kanë të bëjnë me mallra dhe shërbime, subvencione, pagesa në bazë të vendimeve gjyqësore dhe lloje tjera të shpenzimeve të cilat nuk janë të natyrës kapitale. Kjo, me rastin e raportimit ndikon në mbivlerësimin e shpenzimeve kapitale dhe nënvlerësimin e shpenzimeve në kategoritë tjera. Si rezultat i kësaj, edhe gjatë këtij viti, janë identifikuar shuma të larta të keq klasifikimit të shpenzimeve nëpër kategori të ndryshme ekonomike, që në total janë 15,045,487€, megjithëse dukshëm më e ultë se ajo e vitit paraprak (22,011,636€). Pjesa dërmuese e këtyre keqklasifikimeve ndodhë për tri arsye: **e para**, gabimet me rastin e planifikimeve përmes procesit buxhetor; **e dyta**, OB-të gjatë vitit për arsye të ndryshme kanë kryer pagesa nga kategoritë joadekuate; dhe **e treta**, ekzekutimi i pagesave të detyrueshme (vendime gjyqësore dhe përmbarimore, pagesa direkte sipas autorizimit të LMFPP neni 39.2 nga ana e Thesarit nga kategoritë jo adekuate, kryesisht për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore në kategorinë përkatëse të OB). Pas shumë rekomandimeve të dhëna gjatë viteve të mëhershme, kjo gjendje ka filluar të përmirësohet, por ende nuk është zgjidhur. Kjo situatë po vazhdon, për shkak se edhe gjatë shqyrtimeve buxhetore në Kuvend me amendamente të ndryshme ndërhyhet në ndryshimet buxhetore, me ç'rast nuk merren parasysh ndarjet sipas kategorive adekuate, dhe si pasojë, keqklasifikimet legjitimohen edhe me ligj të buxhetit, dhe si të tilla, procedohen në mënyrë të gabuar gjatë vitit nga ana e organizatave buxhetore.

(d) Pagesat e parregullta të pagave - Në tetë (8) ministri janë identifikuar pagesa të parregullta në paga për 215 të punësuar, në një shumë totale prej 1,021,321€. Kjo shumë e pagesave është kryer për stafin e angazhuar sipas Marrëveshjes së Brukselit, por të cilët janë paguar pa dalur fare në punë. Natyra e këtyre pagesave është materiale, për shkak të mungesës së një baze të qartë ligjore, dhe se as Marrëveshja e Brukselit nuk përcakton një mënyrë të tillë të pagesave.

(e) Deficiti buxhetor - Për shkak të mungesës së të hyrave buxhetore për mbulimin e shpenzimeve publike, edhe këtë vit Qeveria kishte planifikuar buxhetin me deficite. Sipas raportit financiar të Qeverisë, shuma maksimale e lejuar me ligj e deficitit buxhetor për vitin 2019 ishte 145 milionë (2%), aq sa edhe ishte aprovuar me Ligj të Buxhetit 2019. Mirëpo, me rastin e rishikimeve tona, ne kemi vërejtur se shuma e aprovuar e deficitit ishte 153 milionë (2.15%), ndërsa deficiti faktik (aktual) në fund të vitit ishte 33.3 milionë (duke përfshirë donacionet) apo 0.47%. Kalkulimi fillestar i deficitit ishte tejkualuar për 0.15% për shkak se të hyrat totale ishin llogaritur për 8 milionë më shumë, por ato ishin THV të mbledhura gjatë viteve paraprake, dhe si të tilla, nuk ishte dashtë të merren parasyh me rastin e përlllogaritjeve. Përkundër këtij gabimi në kalkulimet fillestare të buxhetit, mund të konkludohet se Qeveria ka mbajtur nën kontrollë të plotë pragun e deficitit dhe është në kuadër të kërkesave ligjore. Kjo, për arsyen se deficiti në fund të ishte vetëm 33.3 milionë apo 0.47% dhe vazhdon të mbetet në kuadër të limiteve të lejuara me ligj. Deficiti fillestar i planifikuar ishte tejkualuar për 0.15% si rezultat i gabimit, dhe nuk konsiderohet material për shkak se edhe ashtu nuk ishte realizuar në fund të vitit.

(f) Borxhi publik - Për shkak të burimeve të pamjaftueshme të financimit, Buxheti i Kosovës përveç të hyrave të rregullta, financohet edhe nga huamarrjet e brendshme dhe të jashtme, të cilat në fund të vitit 2019 kanë arritë shumën prej 1,201 milionë, duke mos i llogaritur edhe 42.7 milionë garancione shtetërore. Prej totalit të borxheve, 409.1 milionë janë borxhe të jashtme dhe 791.5 borxhe të brendshme. Në fund të vitit 2019 niveli i borxhit publik ishte 17.46% e Bruto Produktit Vendor (7,123 milionë). Rritja e borxhit të përgjithshëm gjatë vitit 2019 (përfshirë edhe garancionet) ishte 108 milionë. Problemi kyç lidhur me këto borxhe është mosefikasiteti i shpenzimeve të fondeve të marra si hua të jashtme. Shuma e kredive të ratifikuara, por që nuk janë tërhequr gjatë vitit 2019 është rritur në mbi 475 milionë, nga 393 milionë sa ishte në vitin 2018. Kjo, për shkak të vonesave në fillimin dhe realizimin e projekteve për të cilat janë ratifikuar këto shuma të kredive, por edhe për shkak të huazimeve të reja, ndërkohë që shuma të konsiderueshme të shpenzimeve për tarifa të zotimeve dhe tarifave tjera janë paguar brenda kësaj periudhe (740,000€). Nga kjo shumë, 410,000€ janë tarifa të paguara për projektet që kanë ngecje në zbatim, ndërsa shpenzimet e interesit për shfrytëzimin e mjeteve të këtyre kredive ishin 22.7 milionë.

Shuma e huamarrjeve gjatë vitit 2019 ishte 158.2 milionë, prej të cilave huamarrje të brendshme 115.3 milionë dhe kreditë e jashtme (përfshirë edhe nën-huazimet) 42.9 milionë. Më shumë informata lidhur me borxhet publike, mund të gjeni në brendi të kapitujve vijues të këtij raporti.

(g) Bilanci i parasë së gatshme - Shuma totale e parasë së gatshme në LLogarinë e Thesarit shtetëror më 31 dhjetor 2019 ishte 458.2 milionë, prej të cilave 97.4 milionë ishin fonde të shpërndara për qëllime specifike dhe 360.8 milionë janë fonde të depozituara, por të pa shpërndara. Shuma e bilancit bankar në para të gatshme në krahasim me vitin paraprak ishte rritur për më shumë se 70 milionë euro apo rreth 18%. Rreth 57% të fondeve të përcaktuara apo 55.2 milionë janë Të Hyra Vetjake (THV) të bartura si fonde të pa shpenzuara të komunave dhe OB-ve tjera. Kjo shumë është rritur në krahasim me vitin e kaluar për 7 milionë, dhe shpalos tendencën që, OB-të së pari i shpenzojnë fondet nga granti qeveritar, e pastaj të hyrat vetiake. Shuma e bartur e të THV-ve është e akumuluar edhe gjatë viteve të mëhershme, dhe nuk janë vetëm të hyra të pa shpenzuara të vitit 2019.

Rezervat shtetërore në para të gatshme janë rreth 5% e BPV dhe janë në kufi të rregullave fiskale dhe në pajtim me politikat e FMN-së. Bazuar në shifrat e raportuara të pasqyrave financiare, vlerësimet e përgjithshme janë se nuk ekziston ndonjë indikator serioz që rrezikon stabilitetin financiar të

shtetit. Por, sfida kryesore me ndikime në bilancin buxhetor mund të jenë detyrimet e pa paguara dhe kërkesat ndaj debitorëve (llogaritë e pagueshme dhe ato të arkëtueshme), të cilat në mënyrë direkte apo indirekte mund t'i ndikojnë llogaritë qeveritare, varësisht nga masat që do të merr Qeveria në menaxhimin e këtyre llogarive.

(h) Detyrimet e pa paguara dhe ato kontingjente - Fatura të pa paguara të Organizatave buxhetore ndaj furnizuesve dhe operatorëve tjerë ekonomik në fund të vitit 2019 ishin mbi 110 milionë (87 milionë të nivelit qendror, dhe 23 milionë në nivel të komunave), ndërsa obligimet e institucioneve qendrore (përfshirë edhe shpronësimet sipas vendimeve të Qeverisë rreth 232 milionë dhe subvencionet dhe transferet e MPBZHR 18 milionë) kapin shumën rreth 250 milionë euro. Të gjitha këto obligime në total kapin shumën prej 360 milionë euro. Shuma e detyrimeve të pa paguara krahasuar me vitin paraprak është rritur për rreth 102 milionë apo 39%.

Përveç këtyre detyrimeve financiare, ekzistojnë edhe disa detyrime potenciale apo kontingjente, të cilat janë rezultat i padive gjyqësore ndaj organizatave buxhetore dhe pritjet të marrin epilogun gjyqësor. Shuma e këtyre detyrimeve të mundshme vlerësohet në 196 milionë, prej të cilave në nivelin qendror 118.7 milionë dhe 77.3 milionë në nivelin lokal, të cilat për nga niveli i likuiditetit mund të renditen të fundit. Pra, duke i llogaritur obligimet sipas të gjitha bazave, operatorët ekonomik dhe qytetarët kanë pretendime financiare ndaj Qeverisë mbi 556 milionë euro. Këtë shumë dukshëm mund ta rritë edhe kthimi i kësteve të huamarrjeve të jashtme dhe i atyre të brendshme, kur kihet parasysh fakti se vetëm gjatë këtij viti, shërbimi i përgjithshëm i huamarrjeve ishte mbi 73 milionë euro.

(i) Llogaritë e arkëtueshme - Shuma e borxheve të qytetarëve dhe bizneseve ndaj Qeverisë është pothuajse e njëjtë me atë të vitit paraprak - mbi 637 milionë janë borxhe të pambledhura, nga të cilat në nivel qendror janë 452 milionë dhe në nivel lokal 185 milionë. Pjesa dërmuese e borxheve të pambledhura ka të bëjë me ATK-në dhe Doganën, të cilat së bashku kanë 404 milionë borxhe të pambledhura apo rreth 64% të shumës totale, pastaj KPMM ka 28 milionë, e kështu me radhë.

Ndikimi i këtyre dy llogarive (të pagueshme dhe të arkëtueshme) në planifikimet buxhetore ka një rëndësi kritike, si për të hyrat, ashtu edhe për shpenzimet buxhetore, me ndikimin përfundimtar në qëndrueshmërinë makro-fiskale. Ekziston rreziku real që llogaritë e arkëtueshme për shkak të vjetërsisë së tyre të shndërrohen në borxhe të këqia dhe të mos mbledhen asnjëherë. Qeveria duhet të ndërtoj strategji të veçantë se si t'i çaset edhe mbledhjes së borxheve, por edhe pagesës së detyrimeve, në mënyrë që të evitohen çrregullimet në ekuilibrin buxhetor në vitet vijuese. Në këtë drejtim, ndikimi i pandemisë vetëm sa mund të përkeqësojë situatën. Fakti se gjendja e llogarive të arkëtueshme është e njëjtë me atë nga viti i kaluar, është një tregues se OB-të kanë forcuar disiplinën financiare dhe janë më këmbëngulëse në inkasimin e borxheve.

(j) Pasuritë dhe stoqet - Regjistrimi i pasurive në kontabilitetin qeveritar ende vazhdon të mbetet një proces i pa përfunduar dhe mbase është një ndër problemet kyçe të menaxhimit. Arsye kryesore për këtë janë çështjet pronësore të pa zgjidhura për shkak të mungesës së dokumentacionit mbi pronësinë. Totali i pasurive neto në fund të vitit ishte 8 miliardë e 849 milionë. Si rezultat i regjistrimeve të reja gjatë vitit, saldo e pasurive kapitale (me vlerë mbi 1.000 euro) në krahasim me vitin paraprak është rritur për 300 milionë. Pasuritë me vlerë nën 1,000€ në total kapin vlerën prej rreth 41 milionë, me një gjendje pothuajse të njëjtë me atë të vitit paraprak.

Veç kësaj, ndër problemet kryesore mbetet edhe inventarizimi i pasurive dhe stoqeve në fund të vitit për të konfirmuar ekzistencën e pasurisë, dhe për të vlerësuar funksionalitetin dhe përdorimin e tyre. Kjo, është vërejtur tek një numër i madh i organizatave buxhetore. Komisionet e inventarizimit themelohen me vonesë, dhe për këtë arsye, ose i bëjnë me vonesë raportet e inventarizimit, ose nuk bëjnë fare barazimet e gjendjes së regjistrimit me gjendjen kontabël. Mungesa e regjistrimeve të fundvitit pamundëson pasqyrën e plotë të ekzistencës së pasurive dhe krijon mundësinë e keqmenaxhimit, keqpërdorimit apo edhe vjedhjes së pasurive.

(k) Likuiditeti i organizatave buxhetore - Për shkak të disiplinës së dobët financiare, përveç detyrimeve të shumta të papaguara, OB-të shpesh ju nënshtrohen edhe procedurave gjyqësore apo procedurave të ekzekutimit të pagesave direkte nga Thesari. Për arsyet e përmendura, Thesari ka ekzekutuar mbi 27 milionë euro pagesa në bazë të vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore si dhe pagesa direkte sipas autorizimeve të Nenit 39.2 të LMFPP ndaj operatorëve ekonomik dhe pretenduesve tjerë. Prej tyre, 1.5 milionë nga Thesari janë ekzekutuar si pagesa direkte në llogari të operatorëve për shkak të mos kryerjes së detyrimeve të subjekteve buxhetore brenda 60 ditësh, ndërsa rreth 26 milionë janë shumat e paguara në emër të Vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore për të cilat janë paditur organizatat buxhetore. Krahasuar me vitin 2018, trendi i ekzekutimit të pagesave direkte nga Thesari sipas këtyre dy bazave, ka pasur një përmirësim të lehtë (për 2 milionë më pak).

(l) Ndërmarrjet Publike - Rezultatet e auditimit shpalosin se raportimi financiar i 14 ndërmarrjeve të audituara ka mangësi dhe është i pasaktë. Për këtë arsye për 13 ndërmarrje është dhënë opinion negativ, dhe vetëm një prej tyre ka opinion pozitiv. Përveç raportimit të dobët, gjendja e tyre financiare është e vështirë dhe struktura e financimit është mjaft e pavolitshme. Nga pasqyrat financiare për vitin 2019, shihet se gjashtë ndërmarrje publike kishin operuar me humbje, që në total kap shumën prej rreth 28 milionë, ndërsa tetë ndërmarrjet tjera kishin prezantuar rezultat pozitiv financiar, me fitim simbolik prej më pak se 1,3 milionë.

Raportet individuale përmbajnë shifra shqetësuese për stabilitetin financiar të këtyre ndërmarrjeve. Ato, të gjitha së bashku, kanë mbi 160 milionë detyrime kreditore, prej të cilave 90 milionë detyrime afatshkurtëra, dhe mbi 70 milionë detyrime afatgjata. Këto detyrime janë rritur për 16 milionë në krahasim me një vit më parë. Pagesa e këtyre detyrimeve është mjaft e pasigurt, marrë parasysh faktin se ndërmarrjet kryesore operojnë me humbje. Madje, parimi i vijimësisë së veprimtarisë në disa prej tyre, mund të vie në pikëpyetje serioze. Trendet e tilla financiare në këto ndërmarrje janë negative, dhe Qeveria si aksionar, mund të ballafaqohet me sfida serioze në vendimet e saj se si të veprohet në rastet kur aftësia likuiduese e tyre është shumë e pasigurt, ndërkaq borxhet dhe kreditë duhet të kthehen brenda afateve ligjore, ndërsa shërbimet kundrejt qytetarëve duhet të kryhen.

(ll) Zbatimi i rekomandimeve - Rekomandimet e dhëna në vitin paraprak janë adresuar vetëm pjesërisht. Prej numrit të përgjithshëm të rekomandimeve të dhëna (921), plotësisht ishin zbatuar 370 ose 40%, në proces të zbatimit ishin 113 apo 12%, nuk ishin adresuar 312 apo 34% dhe 126 apo 14% ishin mbyllur të pa zbatuara.

Ne kemi dhënë veçmas edhe 51 rekomandime në Raportin Financiar të Qeverisë për vitin 2018. Prej këtij numri, 13 rekomandime ishin zbatuar plotësisht, 19 pjesërisht dhe 19 të tjera nuk ishin adresuar ende. Qeveria e Kosovës në nëntor të vitit 2019 kishte aprovuar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, ku janë obliguar të gjitha organizatat buxhetore (OB) për zbatimin e tij. Mirëpo, sipas KMFP-së, i njëjti nuk është dërguar edhe në Kuvendin e Kosovës për shqyrtimin e progresit të rekomandimeve.

Pjesa I: Pasqyrat Financiare Vjetore

1 Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore 2019

Auditori i Përgjithshëm e përmbushë përgjegjësinë e tij duke e kryer një herë në vit auditimin e Raportit Financiar Vjetor të Qeverisë për ekzekutimin e buxhetit dhe raporteve shoqëruese. Roli i Auditorit të Përgjithshëm është që të ofroj një bazë për mbylljen e procesit të llogaridhënies në mes të Kuvendit dhe Qeverisë për ekzekutimin e buxhetit shtetëror gjatë vitit. Kjo arrihet duke zbatuar parimet e llogaridhënies menaxheriale në të gjitha nivelet e qeverisë, përfshirë ministrinë, komunat, institucionet e pavarura dhe ndërmarrjet publike.

Baza ligjore për kryerjen e auditimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të Qeverisë 2019 përcaktohet nga:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 137 dhe 138);
- Ligji nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (neni 19);
- Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (neni 47 dhe 48); dhe
- Planit Vjetor të Auditimit, numër 01-10-1778 i datës 27.12.2019.

Auditimi është kryer duke u bazuar në:

- Doracakun për auditimin e rregullsisë;
- Doracakun për menaxhimin e cilësisë;
- Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore; dhe
- Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është planifikuar dhe është kryer duke u bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, në mënyrë që të arrihet siguri e arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime financiare dhe se aktivitetet qeveritare, transaksionet financiare dhe informatat e prezantuara janë në pajtim me ligjet, rregulloret dhe aktet tjera. Në fazën përgatitore janë identifikuar dhe vlerësuar rreziqet, mjedisi i kontrollit, si dhe kontrollet e brendshme. Në fazën e planifikimit të auditimit është përcaktuar edhe niveli i materialitetit prej 1% i shumës totale të pranimeve buxhetore, përkatësisht shkalla deri në të cilën tolerohen gabimet në prezantimin e të dhënave në PFV, e që nuk konsiderohen me ndikim domethënës për kredibilitetin e pasqyrave.

Sistemi kontabël dhe raportimit të buxhetit të Kosovës është i bazuar në para të gatshme apo në bazë të modifikuar të parasë së gatshme, ku të gjitha të hyrat dhe të dalat procesohen përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit, ndërsa regjistrohen në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK). Përkundër kësaj, organizatat buxhetore janë të obliguara të mbajnë edhe regjistra kontabël të veçantë, dhe sipas rregullores MF Nr. 01/2017 janë të detyruara që në bazë të këtyre regjistrave të përgatisin pasqyrat e tyre financiare dhe t'i raportojnë Ministrisë së Financave.

Raporti Vjetor i Auditimit i dorëzohet Qeverisë dhe Kuvendit, ndërsa rezultatet e auditimeve individuale i raportohen veçmas menaxhmentit të subjekteve të audituara dhe Kuvendeve Komunale.

Rishikimet tona analitike kanë rezultuar me faktin se asnjë nga 95 organizata buxhetore nuk kishte mos përputhje me kërkesat e Rregullores Nr.01/2017 për raportim vjetor financiar (formati, struktura, afatet e raportimit).

Të gjitha OB-të kanë dorëzuar pasqyrat financiare brenda afatit ligjor, deri më 31 janar 2020. Por, deri në hartimin e Pasqyrave financiare të konsoliduara të Qeverisë (31 mars 2020), 73 OB kanë bërë korrigjime në pasqyrat e tyre, dhe 22 nuk kanë pasur nevojë për korrigjime, mirëpo gjatë auditimit kemi vërejtur se në pesë (5) organizata buxhetore janë identifikuar gabime të pa korrigjuara.

Me datën 04.08.2020, Universiteti i Prishtinës kishte bërë me vonesë korrigjimet finale në Pasqyrat Financiare Vjetore, të cilat më pas janë dorëzuar në Thesar, dhe Thesari i ka pranuar si të tilla me pretekstin se ndryshimet në këto pasqyra, nuk i ndikojnë Pasqyrat e Konsoliduara të Qeverisë. Lidhur me këto ndryshime, është e njoftuar edhe Zyra Kombëtare e Auditimit.

Nga rishikimi rezulton se gabimet e pa korrigjuara më të shpeshta në raporte individuale kanë të bëjnë me:

- Diferenca në mes të shënimeve të prezantuara në Sistemin e Menaxhimit Financiare të Kosovës (SIMFK) dhe Pasqyrave financiare vjetore;
- Mungesa e shpalosjes së avanseve në pasqyrat financiare individuale;
- Mos prezantimi i realizmit të të hyrave nga donacionet;
- Vlera e pasaktë e prezantuar e të hyrave jo tatimore;
- Të hyrat jo tatimore ishin prezantuar si të hyra të dedikuara, si dhe mos paraqitja e drejtë e detyrimeve;
- Keqklasifikimi i shpenzimeve apo regjistrimi në kategori ekonomike jo adekuate, çka ndikon në nënvlerësimin apo mbivlerësimin e llogarive; dhe
- Mos prezantimi i plotë i pasurive në Pasqyra Vjetore Financiare.

Çështjet e ngritura më lart, do të shqyrtohen në hollësi në kapitujt vijues të raportit.

1.1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Ministria e Financave është përgjegjëse që në emër të Qeverisë të përgatitë dhe prezantoj në mënyrë të drejtë Pasqyrat Financiare Vjetore sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, si dhe është përgjegjëse për aplikimin e kontroleve të brendshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara nga gabimet dhe mashtrimet.

Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit, brenda afateve ligjore dhe në formatin e kërkuar me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) dhe në pajtim me SNKSP, ka dorëzuar

për aprovim në Qeveri pasqyrat financiare vjetore për vitin 2019. Më 23 mars 2020, të njëjtat janë aprovuar nga ana e Qeverisë, dhe një kopje e Raportit Vjetor Financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2019, më 25 mars 2020 i është dorëzuar edhe Auditorit të Përgjithshëm.

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF të Qeverisë. Auditimi ynë është fokusuar në tri pasqyrat kryesore, dhe pasqyrën e shpalosjeve:

- Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme;
- Pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me ekzekutimin;
- Pasqyrën e konsoliduar të pasurive në para të gatshme dhe bilancet e fondeve; dhe
- Plotësinë dhe cilësinë e informatave në Pasqyrën e shpalosjeve.

Objektiv i auditimit ishte që të ofrojmë një siguri të arsyeshme:

- Nëse këto pasqyra financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, një pamje të drejtë dhe të vërtetë të gjendjes financiare për periudhën raportuese;
- Nëse pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe transaksioneve financiare për periudhën raportuese;
- Për efektivitetin e kontrolleve të brendshme të aplikuara gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare; dhe
- Nëse Qeveria ka ndërmarrë masat e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit për vitin e kaluar dhe vitet e mëhershme.

Ekzaminimi i PFV të BRK për vitin 2019 është ndërmarrë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorin Publik (SNISA) dhe udhëzuesit e brendshëm të ZKA. Çasja jonë është bazuar në një kuptim të plotë të procesit nëpër të cilin janë hartuar PFV. Ky kuptim ka të bëjë me zhvillimin e një strategjie të auditimit, e cila përqendrohet në adresimin e rreziqeve specifike për një opinion të pamodifikuar, ndërkohë që ofron një nivel të pranueshëm të sigurisë për pasqyrat e marra si tërësi.

Çasja e ndërmarrë reflekton edhe vlerësimin e rezultateve të dala të auditimeve të OB-ve të cilat janë konsoliduar në PFV. Vlen të theksohet se disa zëra të paqyrave të konsoliduara merren nga pasqyrat individuale, si: pasuritë, detyrimet, llogaritë e arkëtueshme, gjendja e borxheve publike, dhe më pas konsolidohen. Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim analitik të pasqyrave, vlerësimin e procesit të përgatitjes së pasqyrave, verifikimin e vlerës së llogarive në librin kryesor dhe përputhjen me vlerat e prezantuara në pasqyra financiare, vlerësimin e efektit të keq deklarimeve të pakorrigjuara, nëse bilancet e llogarive janë materialisht të sakta dhe aty ku janë identifikuar gabime, janë bërë rregullime në pasqyrat financiare, konfirmimin se të gjitha pohimet e auditimit janë adresuar në mënyrë adekuate, rishikimin e kontrolleve të brendshme menaxheriale, sistemeve të kontabilitetit dhe një numër të konsiderueshëm testesh e procedurash, të cilat janë konsideruar si të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit.

Seksionet e mëposhtme të Raportit ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, si rezultat i vëzhgimeve në çdo fushë të rishikimit. Gjetjet e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha gabimeve dhe dobësive që mund të

ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat qeveritare që kanë karakterizuar vitin 2019, por gjithsesi ofrojnë një nivel të pranueshëm të sigurisë.

1.2 Opinioni i auditimit

ZKA ka audituar RFV/BRK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, i cili përfshinë pasqyrën e Pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, Pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me realizimin, Pasqyrën e konsoliduar në para të gatshme dhe bilancin e fondeve, dhe shënimet shpjeguese/shpalosjet e pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës paraqet pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme) dhe Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me ndryshime dhe plotësime).

Si theksim i çështjes dëshirojmë të sjellim në vëmendjen tuaj se në Pasqyrën e Konsoliduar të krahasimit të buxhetit me realizimin, shumën e të hyrave ishte mbivlerësuar për 23 milionë, si dhe një shumë shpenzimesh prej më shumë se 15 milionë, ishte klasifikuar nëpër kategori ekonomike joadekuate. Për më shumë detaje, shih seksionet në vijim.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar tek pjesa "Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare". Besojmë se dëshmitë e marra gjatë auditimit, janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Qeveria kishte dërguar në Kuvend për miratim Ligjin e ndarjeve vjetore të buxhetit për vitin 2019, ku kishte parashikuar pranime në total prej 2,472,872,000€, dhe pagesa prej 2,452,237,000€, me një ndryshim në bilancin bankar prej 21,000,000€. Stoku i bilancit bankar i fondeve të pa pashpërndara ishte projektuar në shumë 340,000,000€ apo 4.8% të BPV-së.

Me rastin e analizës së pasqyrës së konsoliduar të krahasimit të buxhetit me realizimin, ne kemi gjetur se ekziston një dallim prej 23,000,000€ ndërmjet vlerës së prezantuar në RFV dhe vlerës së audituar. Në Tabelën 1 të buxhetit fillestar për vitin 2019, në totalin e pranimeve kemi identifikuar se në pjesën C ishin përfshirë si burim i financimit edhe të hyrat vetiake të bartura në shumën prej 23,000,000€, shumë e cila e ka ndikuar mbivlerësimin e pranimeve dhe ka ndikuar negativisht edhe në ndryshimet e gjendjes së bilancit bankar të fondeve të pashpërndara.

Të hyrat vetiake të bartura nga viti 2018 nuk është dashtë të përfshihen si burime të financimit të shpenzimeve, pasi që janë fonde të bartura për qëllime specifike, të cilat në Llogarinë e Vetme të Thesarit veçse janë pranuar gjatë vitit 2018. LMFP si dhe Ligji i Buxhetit përcakton mënyrën e bartjes së bilancit të fondeve të pa shpenzuara të të hyrave vetiake. Ato alokohen fillimisht, duke e

rritur buxhetin te organizata buxhetore të cilës i takojnë, dhe pastaj mund të shpenzohen. Për këtë qëllim ato edhe nuk duhet të planifikohen si shpenzime në tabelat e Ligjit Buxhetit, si dhe nuk ishin të përfshira si shpenzim në buxhetin e komunave.

Buxhetimi dhe alokimi bëhet në fondet përkatëse në SIMFK (Fondi Burimor 22) si dhe shpenzimi i ndodhur lidhet me këtë burim të financimit. Pra, këto nuk e ndikojnë bilancin bankar dhe deficitin buxhetor të vitit aktual.

Ndryshimet në bilancin bankar të planifikuar të fondeve të pashpërndara në RVF janë prezantuar në shumë prej 21,000,000€, mirëpo si rezultat i mbivlerësimit të pranimeve (THV të bartura), bilanci i pashpërndarë rezulton të jetë minus 2,000,000€. Njëkohësisht kjo ndikon edhe në zvogëlimin e stokut të bilancit bankar të fondeve të pashpërndara i cili në RVF dhe Tabelën 1 të buxhetit ishte prezantuar në vlerë 340,000,000€, por me zbritjen e të hyrave vetjake të bartura, stoku rezulton të ulet në 317,000,000€; dhe

- Me rastin e analizës së shpenzimeve, kemi vërejtur se me buxhet ishin planifikuar dhe klasifikuar shpenzimet nëpër kategori ekonomike joadekuate qysh në fazën e aprovimit të Buxhetit vjetor 2019, të cilat më pas, gjatë vitit edhe janë shpenzuar dhe regjistruar në kodet e gabuara ekonomike. Si rezultat i kësaj, por edhe gabimeve nga vet organizatat buxhetore, gjatë vitit në 49 OB janë identifikuar keq klasifikime të shpenzimeve në një shumë totale prej 15,045,487€. Prej tyre, 10,863,381€ apo 72% te 33 organizata të nivelit lokal, 3,090,016€ apo 21% te 21 OB të nivelit qendror, dhe 1,092,090 apo 7% te 4 agjenci të pavarura.

Tabela në vijim tregon keq klasifikimin e bërë nëpër kategori ekonomike. Kategoria më e ndikuar nga keq klasifikimi është kategoria e Investimeve kapitale me 10,679,045€ apo 71%, Mallra dhe Shërbime 3,589,307€ apo 24% dhe Subvencionet e Transferet me 777,135€ apo 5%.

Tabela 1 - Keq klasifikimi për kategori ekonomike


Kategoria e gabuar	Kategoria e duhur	E ndikuar nga OB	E planifikuar gabimisht	Me vendime gjyqësore	Gjithsej
Investime Kapitale	Paga dhe mëditje	341,680	19,759	716,703	1,078,142
	Mallra dhe shërbime	582,100	7,583,066	789,705	8,954,871
	Subvencione dhe Transfere	600	645,432	0	646,032
Gjithsej Investimet Kapitale					10,679,045
Mallra dhe shërbime	Paga dhe mëditje	355,844	54,823	1,949,308	2,359,975
	Subvencione dhe Transfere	69,060	428,271	31,055	528,386
	Investime Kapitale	238,762	120,309	341,875	700,946
Gjithsej Mallra dhe shërbime					3,589,307
Subvencione dhe Transfere	Paga dhe mëditje	2,256	0	40,669	42,925
	Mallra dhe shërbime	238,244	491,119	4,847	734,210
Gjithsej Subvencione dhe Transfere					777,135
Gjithsej keq klasifikimi		1,828,546	9,342,779	3,874,162	15,045,487

Nga totali prej 15,045,487€, nga kategoria ekonomike e Investimeve Kapitale, janë bërë pagesa në vlerë prej 10,679,045€ në emër të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, subvencione e transfere dhe paga e mëditje.

Nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve janë bërë pagesa në vlerë prej 3,589,307€ për paga dhe mëditje, investime kapitale dhe subvencione e transfere.

Nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve janë bërë pagesa në vlerë prej 777,135€ për mallra dhe shërbime dhe paga e mëditje.

KEQ KLASIFIKIMI PËR KATEGORI EKONOMIKE



Ndikimi në keqklasifikimin e shpenzimeve - Nga tabela më poshtë shihet se keq klasifikimi i shpenzimeve është i ndikuar nga planifikimi përmes procesit buxhetor në kategoritë jo të duhura. Si rezultat i planifikimit të gabuar, 9,342,779€ apo 62%, të fondeve për Investime kapitale janë shpenzuar për mallra dhe shërbime, subvencione dhe transfere, paga dhe mëditje.

Faktori i dytë me ndikim në keqklasifikime janë pagesat e ekzekutuara nga Thesari përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore në shumën prej 3,874,163€, apo 26% të totalit.

Ndërsa, për vlerën 1,828,546€ apo 12%, përkundër që planifikimi buxhetor ishte në rregull, Organizatat Buxhetore kanë bërë pagesa nëpër/nga kategoritë e gabuara.

Në Tabelën në vazhdim janë identifikuar 10 organizata buxhetore ku nga kategoria e Investimeve Kapitale kanë paguar shpenzime që i përkasin kategorisë mallra dhe shërbime, në vlerë prej 7,088,626€, projekte të cilat ishin të planifikuar me ligjin e buxhetit, dhe në tabelë është përshkruar në hollësi natyra e këtyre shpenzimeve.

Tabela 2 - Keq klasifikimet me planifikim të buxhetit

Organizata buxhetore	Kategoria e gabuar	Kategoria e duhur	Vlera financiare	Shpenzimet për mallra dhe shërbime të klasifikuara si shpenzime kapitale
MASHT	Investime Kapitale	Mallra dhe shërbime	1,118,209	Shpenzimet për blerjen e inventarit për objektet arsimore, shkolla dhe çerdhe.
MAP	Investime Kapitale	Mallra dhe shërbime	438,984	Pagesat për Platforma në mbështetje të administratës publike.
Ministria e Infrastrukturës	Investime Kapitale	Mallra dhe shërbime	283,619	Pagesat për mirëmbajtjen e rrugëve si: Furnizim me kripë, largimi i barrierave në rrugë, shërbime pastrimi etj.
SHSKUK	Investime Kapitale	Mallra dhe shërbime	702,046	Shpenzimet për servisimin e pajisjeve mjekësore dhe servisimin e liftave, blerjen e pajisjeve të TI dhe pajisjeve tjera me vlera individuale nën 1,000, sigurimin fizik të objekteve dhe furnizim me ushqim
AMMK	Investime Kapitale	Mallra dhe shërbime	298,383	Shpenzimet për mirëmbajtjen e komplekseve Memoriale.
Prishtina	Investime Kapitale	Mallra dhe shërbime	2,502,523	Shpenzimet për kontratën "Dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve në komunën e Prishtinës, Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe sportive në Komunën e Prishtinës, Mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbërta, Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçimin publik, Dekorimi i qytetit për festat e fund vitit Mirëmbajtja e shkollave dhe trajtimi i qenve endacak.

Peja	Investime Kapitale	Mallra dhe shërbime	515,036	Shpenzimet për "Rimorkim, tërheqjen e automjeteve të parkuar jashtë ligjit apo atyre të aksidentuar dhe bartja deri tek vend parkingu.
Suhareka	Investime Kapitale	Mallra dhe shërbime	489,208	Mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese në komunë, Shërbime për realizimin e vitalizimit të infrastrukturës për funksionalizimin e projektit "Shtretërit Shtëpiak, Mirëmbajtja dimërore e rrugëve", Shërbimet e varrimit, etj.
Graçanica	Investime Kapitale	Mallra dhe shërbime	379,149	Pagesat për larjen e rrugëve dhe trotuarëve, mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe intervenime të ndryshme, Shërbimet e pastrimit të mbeturinave, Dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve dhe për Blerjen e pajisjeve sportive.
Mitrovica	Investime Kapitale	Mallra dhe shërbime	361,469	Pagesat për Menaxhimin e mbeturinave të egra, larja, fshirja dhe mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe punët emergjente në qytet dhe Mirëmbajtja e parqeve në hapësirat publike.

Qeveria, sipas procesit të rregullt buxhetor, i kishte dorëzuar Komisionit për Buxhet dhe Financa Projektligjin e Buxhetit për vitin 2019, dhe ky Komision më pas i kishte dorëzuar Kuvendit këtë projektligj për miratim me një numër të madh amendamentesh të Komisioneve parlamentare, grupeve parlamentare dhe deputetëve, të cilat në masë të madhe edhe ishin aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në ligjin përfundimtar. Kjo edhe kishte ndikuar që shumë nga këto shpenzime të planifikuara me ndarje buxhetore, të mos klasifikohen drejt.

Rekomandimet për Pasqyrat Financiare

Rekomandimet për Kuvendin e Kosovës

Komisionet parlamentare për Buxhet dhe Financa, si dhe ai për Mbikëqyrje të Financave Publike duhet t'i forcojnë kontrollet monitoruese ndaj Qeverisë dhe Kuvendit në mënyrë që Kuvendi i Kosovës, para se të miratoj Ligjin vjetor të ndarjeve buxhetore për vitin vijues, duhet të sigurohet se të gjitha shpenzimet janë planifikuar sipas kategorive ekonomike adekuate.

Rekomandimet për Ministrinë e Financave

- Ministria e Financave duhet të vazhdoj me masat e filluara me përmirësimin e kontrolleve buxhetore, në mënyrë që shumat e keqklasifikuara me buxhet të reduktohen sa më shumë;
- Departamenti i Makroekonomisë, në Tabelën 1 të shpalos planin e të hyrave jo tatimore të nivelit qendror, sipas OB-ve, dhe i njëjti të shërbej si plan i të hyrave për secilën OB në pasqyrat financiare;
- Me rastin e planifikimit të të hyrave buxhetore, të siguroj se ekzistojnë analiza të mjaftueshme dhe të qarta për dokumentimin e burimeve përkatëse të të hyrave. Departamenti i Makroekonomisë, Departamenti i buxhetit dhe Thesari duhet të punojnë ngushtë për eliminimin e këtyre gabimeve, para se Plani buxhetor t'i dorëzohet Qeverisë. Në veçanti, duhet të bashkëpunojnë lidhur me të dhënat e paraqitura në Tabelën 1 dhe të analizohen ndikimet e mëvonshme në Pasqyrat Financiare;
- Thesari të kërkoj nga komunat që ta dërgojnë planin e rrjedhës së parasë edhe për të hyrat vetjake të bartura, ashtu që të ketë një financim të balancuar të buxhetit, gjithnjë duke respektuar të drejtën që komunat e kanë për të destinuar këto mjete në kohën dhe projektet e caktuara; dhe
- Me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit të buxhetit, për të gjitha lëvizjet dhe ndryshimet në librat kontabël të SIMFK duhet të mbeten gjurmë, ndërsa vetëm Thesari si ekzekutues i buxhetit (përkatësisht zbatues i ligjit) të realizojë ndryshimet në librat kontabël, duke përfshirë ekzekutimin e të gjitha vendimeve për ndryshime të ndarjeve buxhetore në përputhje me vendimet e marra në pajtim me legjislacionin.

2 Analiza e Buxhetit Shtetëror

Pasqyrat e Konsoliduara Financiare të Qeverisë paraqesin informacione për projeksionet fillestare dhe ato përfundimtare të buxhetit 2019, duke i përfshirë fondet dhe burimet e fondeve, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Buxheti për vitin 2019 është përgatitur dhe aprovuar në përputhje me Ligjin nr. 06/L-133 për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Qeveria, gjatë vitit 2019 nuk kishte vlerësuar nevojën për rishikim buxheti, kështu që nuk ishte ndërmarrë ndonjë proces rishikimi gjashtëmujor për të bërë ndryshimet e projeksioneve fillestare të buxhetit. Megjithatë, gjatë vitit me vendime të Qeverisë kanë ndodhur një sërë ndryshimesh të buxhetit nëpër kategori të ndryshme ekonomike brenda organizatave buxhetore. Qeveria kishte marrë një numër vendimesh me të cilat diku ka rritur, dhe diku ka reduktuar fondet dhe alokimet buxhetore të organizatave të ndryshme. Realizimi i buxhetit nëpër OB edhe këtë vit është përcjellë me mangësi të ndryshme. Reduktimi i fondeve dhe alokimeve nga ana e Qeverisë, ka ndikuar që shuma të konsiderueshme të detyrimeve të mbeten të pa paguara, por edhe një numër i projekteve kapitale të mos realizohen dhe të barten për vitin pasues.

Në aspektin e planifikimit, edhe të hyrat, edhe shpenzimet, nominalisht kanë shënuar një trend rritës në krahasim me vitet paraprake. Të hyrat e buxhetuara janë realizuar në shkallën prej 89.6%, ndërsa shpenzimet 85.5% në nivel të buxhetit përfundimtar. Ekzekutimi i buxhetit, krahasuar totalin e pranimeve me totalin e pagesave në para të gatshme ishte realizuar në shkallën 96.8%, që paraqet një efikasitet më të lartë të shpenzimeve sesa një vit më parë. Dukuria e shpenzimeve të rritura në fund të vitit ka vazhduar edhe këtë vit, ku vetëm gjatë muajit dhjetor ishin shpenzuar mbi 170 milionë euro nga kategoria e investimeve kapitale. Sidomos ky është një tregues i dobët i planifikimit dhe kontroleve mbi buxhetet e projekteve kapitale.

Gjatë vitit janë bërë rregullime të ndryshme në ndarjet fillestare buxhetore. Këto rregullime janë të bazuara në autorizimet ligjore që jepen në LMFP dhe janë të përshkruar në tabelën vijuese.

Tabela 3 - Lëvizjet buxhetore gjatë vitit 2019

(në '000' euro)


Përshkrimi	Ndarja Fillestare sipas Ligjit të Buxhetit	Ndryshimet sipas LMFP	Ndryshimet për të hyrat vetjake	Ndryshimet për grantet e përcaktuara të donatorëve	Ndarjet finale të buxhetit SIMFK	Ndryshimet e buxhetit fillestar
Paga dhe shtesa	619,997	7,977	2,080	1,280	631,334	2%
Mallra dhe shërbime	307,127	(2,984)	3,421	6,484	314,049	2%
Shpenzime komunale	29,483	(1,559)	952	12	28,888	(2%)
Subvencione dhe transfere	600,024	37,543	8,452	1,325	647,345	8%
Shpenzime kapitale	788,800	(32,174)	32,771	4,749	794,063	1%
Rezerva	4,800	(4,800)	0	0	0	100%
Tjera	102,005	0	0	0	102,005	0%
Gjithsej	2,452,237	4,002	47,678	13,850	2,517,767	2.7%

Tabela në vazhdim paraqet të dhëna mbi planifikimin e buxhetit fillestar, përfundimtar si dhe rezultatet e rishikimit analitik të dala nga auditimi, që kanë të bëjnë me totalin e të hyrave buxhetore dhe shpenzimeve.

Tabela 4 - Pranimet dhe Pagesat sipas buxhetit fillestar dhe final (në '000' euro)

Nr	Zërat buxhetor	Buxheti fillestar sipas Ligjit 06/L-133	Buxheti fillestar sipas auditimit	Dallimi Kolona 2 minus 3	Buxheti final sipas SIMFK	Buxheti final sipas auditimit	Dallimi Kolona 5 minus 6
	1	2	3	4	5	6	7
1.	Gjithsej të hyrat	1,949,277	1,949,277	0	1,957,664	1,957,664	0
2.	Financimi nga huamarrja	336,195	336,195	0	336,195	336,195	0
3.	Pranimet tjera	187,000	164,000	23,000	187,000	164,000	23,000
	Gjithsej pranimet	2,472,872	2,449,872	23,000	2,480,859	2,457,859	23,000
1.	Pagat dhe Mëditje	619,997	619,997	0	631,334	631,334	0
2.	Mallra dhe shërbime	307,127	307,127	0	314,049	314,049	0
3.	Shpenzime komunale	29,483	29,483	0	28,888	28,888	0
4.	Subvencione dhe Transfere	600,024	600,024	0	647,345	647,345	0
5.	Rezerva	4,800	4,800	0	83	83	0
6.	Investimet Kapitale	788,800	788,800	0	794,063	794,063	0
7.	Pagesa e interesit	28,000	28,000	0	28,000	28,000	0
8.	Pagesa e kryegjësë	50,000	50,000	0	50,164	50,164	0
9.	Nën huazimet	24,005	24,005	0	24,005	24,005	0
	Gjithsej pagesat	2,452,236	2,452,236	0	2,517,767	2,517,767	0
	Deficiti/Suficiti buxhetor	20,636	(2,364)		(36,908)	(59,908)	23,000

Me rastin e analizës së Pasqyrës dytë - pasqyra e konsoliduar e krahasimit të buxhetit me realizimin, ne kemi gjetur se ekziston një diferencë prej 23,000,000€ ndërmjet vlerës së prezantuar në PFV dhe vlerës sipas auditimit. Diferenca është identifikuar tek rrjedha hyrëse e parasë së gatshme, në kolonën e buxhetit fillestar si dhe kolonën e buxhetit përfundimtar, tek pozicioni Pranimet tjera në vlerë prej 187,000,000€. Kjo vlerë ka të bëjë me THV të bartura të komunave, të cilat janë planifikuar si pranime në Tabelen 1 të Ligjit të buxhetit për vitin 2019, por që në fakt kanë qenë të pranuar gjatë vitit 2018 dhe të deponuara në Llogarinë e Thesarit në BQK.



Bazuar në Ligjin e buxhetit 2019 (Tabela 1), vlera e buxhetuar e Pranimeve tjera është 187,000,000€, e cila përbëhet nga burimet e prezantuara në tabelën vijuese. Ndërsa sipas auditimit, kjo shumë duhet të jetë 164,000,000€. Në mënyrë analitike, zëri buxhetor Pranimet tjera përbëhet nga llojet e të hyrave si më poshtë.

Tabela 5 - Planifikimi i të hyrave nga Pranimet tjera

(në euro)

Zëri - Pranimet tjera	Sipas Ligjit Nr. 06/L-133	Sipas auditimit	Diferenca	Sipas Buxhetit final SIMFK	Sipas auditimit	Diferenca
Të hyrat e dedikuara	2,000,000	2,000,000	0	2,000,000	2,000,000	0
Kthimi i kredive NP (KEK)	11,000,000	11,000,000	0	11,000,000	11,000,000	0
Të hyrat e njehershme nga AKP	151,000,000	151,000,000	0	151,000,000	151,000,000	0
Të hyrat vetjake të bartura të komunave	23,000,000	0	23,000,000	23,000,000	0	23,000,000
Totali	187,000,000	164,000,000	23,000,000	187,000,000	164,000,000	23,000,000

Ne kemi diskutuar me menaxhmentin e MF-së lidhur me të hyrat e bartura të komunave në vlerë prej 23 milionë euro. Shpjegimet e tyre janë se “ky pozicion te planifikimi buxhetor (kolona B dhe C) është pasqyruar në përputhje me Tabelën 1 të Ligjit të Buxhetit Nr. 06/L-133, ndërsa sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit për sektorin publik (SNKSP) nuk trajtohen si pranime në LLVTH (pasi veçse janë pjesë e bilancit bankar të vitit paraprak), por meqë janë planifikuar si pranime - burim i financimit (pra vetem si e hyrë) sipas Ligjit të buxhetit (Tabelës 1), pozicioni pranimet nga të hyrat e bartura të komunave është paraqitur në këtë pasqyrë, ashtu siç është aprovuar me Ligjin e buxhetit”.

Pra, me rastin e planifikimeve fillestare, por edhe në buxhetin përfundimtar, shihet se për të njëjten shumë ishin mbivlerësuar të hyrat e përgjithshme buxhetore. Së këndejmi, po të zbriteshin THV nga tabelat buxhetore, deficitin sipas buxhetit fillestar del të jetë 2,364,000€, ndërsa sipas buxhetit përfundimtar 59,908,000€ (shih më lart tabelën 3). Megjithatë, pavarësisht kësaj diference brenda strukturës së tabelës, ndryshimi në bilancin bankar si dhe bilancin neto të prezantuar në pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, është prezantuar saktë dhe në mënyrë të drejt.

2.1 Analiza e të hyrave të përgjithshme buxhetore dhe e shpenzimeve

Të hyrat dhe shpenzimet shtetërore duhet të jenë të balancuara. Meqenëse të hyrat sipas buxhetit përfundimtar kishin rezultuar të jenë më të vogla se shpenzimet, diferenca prej 36,908,000€ paraqet shumën e deficitit buxhetor. Por, meqenëse plani buxhetor nuk ishte realizuar sipas parametrave fillestar, në fund të vitit bilanci bankar ka rezultuar me një rritje prej mbi 70 milionë. Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2019 nuk i është nënshtruar procedurave të rishikimit buxhetor, por gjatë vitit me vendime të Qeverisë janë bërë rregullime të ndryshme në ndarjet fillestare buxhetore, të cilat diku kanë rezultuar me rritje, e diku me reduktime buxhetore. Këto rregullime janë bazuar në autorizimet ligjore në bazë të LMFPP.


Pasqyra në vijim paraqet trendin e të hyrave sipas projeksioneve fillestare, përfundimtare dhe shumën aktuale të pranimeve dhe pagesave. Të dhënat për tri vite janë marrë nga Pasqyra e pranimeve dhe pagesave sipas MF.

Tabela 6 - Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme

(në euro¹)

Përshkrimi	Buxheti fillestar 2019	Buxheti final 2019	Realizimi 2019	Realizimi 2018	Realizimi 2017
Pranimet	2,472,872,000	2,480,859,000	2,222,922,000	2,009,673,000	1,923,360,000
Pagesat	2,452,237,000	2,517,767,000	2,152,546,000	1,979,559,000	1,836,805,000

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme (në euro)



Përveç çështjeve të përshkruara në bazën për opinionin e auditimit, çështjet kryesore të dala nga analizat tona janë si në vijim:

- (a) Buxheti fillestar i të hyrave/pranimeve në krahasim me buxhetin final kishte pasur një korigjim të lehtë (7,987,000€), ndërsa buxheti fillestar i pagesave ishte rritur në krahasim me atë final për 65,530,000€, dhe ishte planifikuar të financohet prej deficitit prej 36,908,000€. Pranimet sipas buxhetit final në fund të vitit kishin rezultuar me një shkallë më të ultë të realizimit prej 257,938,000€ apo ishin realizuar 89.6%, ndërsa pagesat për 365,222,000€ apo 85.5%. Pra, siç shihet, variancat në mes projeksioneve përfundimtare të buxhetit dhe nivelit

1 Për shkak se shifrat në Pasqyra janë prezantuar në mijëshe, në tabelë janë paraqitur të plota, por të rrumbullaksuara.

të realizimit janë mjaft të larta. Diferencat e theksuara në mes shumave të planifikuara dhe të realizuara janë kryesisht si rezultat i mos realizimit të projekteve kapitale me financim nga huamarrjet dhe niveli i ultë i mbledhjes së tatimeve indirekte kundrejt planifikimit;

- (b) Të hyrat e parashikuara me buxhet final gjatë vitit ishin realizuar 89.6%, kundrejt 92% në vitin paraprak. Pranimet gjatë vitit 2019, krahasuar me ato një vit më parë ishin realizuar për 213 milionë më shumë se një vit më parë apo 10.6%, kurse pagesat për 173 milionë apo 8.7%;
- (c) Diferenca në mes totalit të Pranimeve dhe totalit të Pagesave është 70,376,000€. Kjo shumë paraqet fondet e pa shpenzuara dhe reflekton rritjen e parasë së gatshme në llogarinë bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës, e cila në datën 31 dhjetor 2019 ka një saldo përfundimtare prej 458,251,000€;
- (d) Buxheti vjetor, përveç financimeve nga të hyrat e rregullta, ishte planifikuar të financohej edhe nga fondet e huamarrjes. Shuma e huamarrjeve vjetore ishte planifikuar 336,195,000€ apo rreth 13.6% e totalit të pranimeve sipas buxhetit përfundimtar. Megjithatë, huamarrjet në fund të vitit ishin realizuar 158,264,000€ apo vetëm 47% nga shuma e planifikuar;
- (e) Përveç të hyrave tatimore, jotatimore, huamarrjes, një shumë të konsiderueshme në zërat e të hyrave buxhetore e përbën edhe financimi i njëhershëm i Agjencisë Kosovare të Privatizimi (AKP). Shuma e financuar e buxhetit nga AKP ishte 150,002,000€ apo mbi 6.7%; dhe
- (f) Në përqindje të vogla, arka shtetërore është financuar edhe nga disa burime tjera jo të rregullta, si: (a) Grantet si mbështetje buxhetore 11,500,000€; (b) Grantet specifike të donatorëve 7,987,000€; (c) Kthimi i kredive nga Ndërmarrjet publike 10,876,000€; (d) Të hyrat nga interesi 2,691,000€.


2.1.1 Analiza e të hyrave sipas kategorive ekonomike

Pasqyra më poshtë ofron informata më të plota për buxhetin final dhe trendet buxhetore gjatë tri viteve të fundit.

Tabela 7 - Pasqyra e Buxhetit dhe Pranimeve sipas burimeve

(në euro)

Pranimet	Buxheti fillestar 2019	Buxheti final 2019	Realizimi 2019	Realizimi 2018	Realizimi 2017
Tatimet direkte	288,510,000	288,510,000	292,259,000	267,504,000	238,034,000
Tatimet indirekte	1,492,040,000	1,492,040,000	1,415,291,000	1,344,130,000	1,315,236,000
Kthimet tatimore	(50,000,000)	(50,000,000)	(45,507,000)	(47,880,000)	(57,583,000)
Të hyrat jotatimore	208,227,000	208,227,000	214,614,000	192,865,000	185,881,000
Financimi nga Huamarrja	336,195,000	336,195,000	158,264,000	122,018,000	211,934,000
Grantet dhe ndihmat ¹	10,500,000	18,487,000	19,487,000	8,319,000	8,312,000
Pranimet tjera ²	187,400,000	187,400,000	168,514,000	122,717,000	21,547,000
Gjithsej:	2,472,872,000	2,480,859,000	2,222,922,000	2,009,673,000	1,923,360,000



Tatimet direkte

Kjo kategori tatimesh përbëhet nga këto burime: Tatimi në të ardhura të korporatave, Tatimi në të ardhura personale, Tatimi në pronë, dhe tatimet tjera direkte.

Zërin kryesor në këtë kategori tatimesh e përbën Tatimi në të ardhura personale me 165,616,000€ (57%), Tatimi në të ardhura të korporatave 94,593,000€ (32%), Tatimi në pronë 27,277,000€ (9%) dhe tatimet tjera 4,773,000€ (2%). Tatimi në të ardhura personale dhe Tatimi në të ardhura nga korporatat ishte grumbulluar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), ndërsa Tatimi në pronë është mbledhur nga Komunat (duke i përjashtuar tri komunat e veriut). Krahasuar me vitin paraprak, shumta e përgjithshme e tatimeve direkte ka shënuar rritje prej 9%, përkatësisht rreth 23% krahasuar me vitin 2017.

Tatimet indirekte

Tatimi në Vlerën e Shtuar dhe Akcizat, janë kategoritë kryesore të tatimeve indirekte, të cilat njëherit janë edhe burimet kryesore të arkës shtetërore. Në strukturën totale të pranimeve, këto lloje tatimesh participojnë me 63.7%. Buxheti fillestar për këtë kategori të hyrash ishte realizuar 95%, ndonëse në vlerë nominale kishte një rritje prej 71 milionë krahasuar me vitin paraprak. Tatimi i mbledhur në Vlerën e Shtuar ishte 845,647,000€ (59.8%), me një rritje në vlerë nominale prej 46,627,000€ apo 5.8% në krahasim me 2018. Mbi 70% e TVSH-së është mbledhur në kufi, ndërsa pjesa tjetër është TVSH e brendshme. Të hyrat nga Akcizat ishin 435,496,000€ ose 30.8%, një rritje prej 4%, Të hyrat nga detyrimet doganore ishin 130,326,000€ ose 9.2% e totalit, një rritje prej rreth 7 milionë dhe pjesa tjetër e tatimeve indirekte ishte 3,822,000€ ose 0.2%.

Kthimet tatimore

Me rastin e barazimeve periodike të obliguesve tatimor me Administratën Tatimore të Kosovës, ndodhin kthimet e tatimeve. Shumta e kthimit të tatimeve gjatë vitit 2019 ishte 45,506,655€ apo 2.7% të totalit të përgjithshëm të tatimeve të inkasuara. Prej tyre, vlera e kthimeve nga ATK ishte 43,719,838€, ndërsa kthimet nga Dogana 1,786,817€.

Pjesa dërmuese e shumave të kthyera të tatimeve direkte dhe indirekte ka të bëj me: kthimin e TVSH-së së brendshme mbi 39 milionë, dhe kthimi i tatimit në korporata mbi 3,7 milionë.

Kthimet ndodhin për shkak të balancës kreditore në pagesën e tatimeve apo detyrimeve doganore. Kur tatimi i paguar është më i lartë se tatimi i llogaritur, prodhon teprica kreditore dhe kjo tepricë bazuar në legjislacionin tatimor mund/duhet të rimbursohet. Planifikimi i kthimeve tatimore me buxhetin përfundimtar ishte përlllogaritur 50 milionë, por shuma aktuale e kthimeve ishte 4.5 milionë më pak seç ishte planifikuar.

Gjatë rishikimeve tona kemi vërejtur se sfida kryesore në kthimin apo rimbursimin e tatimeve ndaj bizneseve janë vonesat në shqyrtimin e kërkesave për rimbursim nga ATK, çka si pasojë mund të ketë dëmtimin e bizneseve për shkak të mungesës së mjeteve qarkulluese. Faktorët kryesor për shkaktimin e vonesave janë: dokumentacioni jo i saktë i tatimpaguesit, vonesat në paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar nga ATK, gabimet në deklaram, por edhe neglizhenca nga ATK.

Performanca buxhetore e Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës

Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore janë dy agjencitë kryesore qeveritare për mbledhjen e tatimeve direkte dhe indirekte, si: taksa doganore, akcizat, tatimi në të ardhura të korporatave, tatimi në të ardhura personale, TVSH-ja dhe tjera.

Të hyrat e planifikuara bruto të DK për vitin 2019 ishin 1,234,000,000€, kthimet tatimore 4,900,000 ndërsa të hyrat e realizuara neto ishin planifikuar 1,229,100,000€. Të hyrat e planifikuara neto ishin realizuar 1,177,799,000€ apo 95.8% e planit. Vetëm nga Akciza, TVSH në kufi dhe Dogana në import, janë realizuar rreth 1.17 miliardë euro apo 62.2% e të gjitha të hyrave tatimore dhe jotatimore.

Duke marrë parasysh politikën favorizuese fiskale për lirime nga taksat në import për lëndën e parë që prodhuesit përdorin në procesin e prodhimit, si stimulim i zhvillimit ekonomik, si dhe ato që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, këto në vitin 2019 patën ndikim të madh në të hyrat e planifikuara. Zvogëlimi i të hyrave kishte ndodhur edhe për shkak së me datën 15.04.2019 kishte hyrë në fuqi Ligji nr. 06/L-155 për Ndalimin e Lojërave të fatit.

Përkundër përmirësimeve të vazhdueshme, procesi i menaxhimit të të hyrave në Doganë në raste të caktuara është përcjellë me mangësi që kanë të bëjnë me kalkulimin e bazës doganore dhe mos aplikimin e çmimeve uniforme me rastin e rivlerësimit të mallrave për qëllime tatimore.

Administrata Tatimore e Kosovës për vitin 2019 kishte planifikuar të inkasoj të hyra në shumën prej 516,400,000€, ndërsa ishin realizuar 504,282,000€, me një dallim nga plani për 12,118,000€ ose 97.6%. Të hyrat e realizuara në vitin 2019 janë rritur në raport me vitin 2018 për 35,834,024€ apo 7.6% si dhe 89,868,000€ apo 21.7% në krahasim me vitin 2017.

Në të hyrat tatimore prej 504,282,000€, pjesëmarrje më të madhe kanë TVSH-ja me 239,299,591€ ose 47%, Tatimi në të ardhura personale 165,616,000€ ose 33%, Tatimi në Korporata 94,593,409 ose 19 %, ndërsa tatimet tjera (gjobat) kanë një pjesëmarrje prej 4,773,000€ apo më pak se 1%.

Me gjithë shkallën e lartë të përmbushjes së planit në realizmin e të hyrave, procesi i mbledhjes dhe menaxhimit i të hyrave në ATK, në raste të caktuara është përcjellë mangësi, si: procesi i pa

përfunduar i fiskalizimit dhe mos përmbushja e planit të kontrollave. ATK në vitin 2019 kishte përmirësuar dukshëm numrin e fiskalizimit të bizneseve krahasuar me vitet e kaluara, ku nga 23,271 bizneset sa ishin të fiskalizuara deri në fund të vitit 2018, numri i bizneseve të fiskalizuara në fund të vitit 2019 kishte arritur në 32,881. Përkundër kësaj, ATK-së i mbetet edhe shumë punë deri në fiskalizimin e plotë të të gjitha bizneseve që i plotësojnë kriteret për fiskalizim, pasi që numri i mbetur i bizneseve të fiskalizuara, ende mbetet i lartë (21,517). Me qëllim të rritjes së efikasitetit, ATK kishte shtuar edhe numrin e kontrollave, dhe nga 2,246 kontrollet e planifikuara për vitin 2019, kishte realizuar 1,915 apo 85% të planit. Realizim më të ulët të planit, kanë shënuar kryesisht regjionet: Prishtina 1, Prishtina 2, Prishtina 3 dhe Drejtoria e tatim paguesve të mëdhenj (DTM). Më tej, nga gjithsej 1,915 kontrolle të kryera, 1,120 sosh janë kryer me propozim nga zyra qendrore - analiza e riskut.

Të Hyrat jo tatimore

Në kategorinë e të hyrave jo tatimore bëjnë pjesë: të gjitha llojet e taksave administrative dhe taksave tjera, të gjitha llojet e gjobave, të hyrat nga inspeksioni, shfrytëzimi i pronës publike, tarifave e shërbimeve, licencat, qiratë për pronat publike, taksat koncesionare, rentat minerare, etj.

Këto të hyra mbledhen edhe nga subjektet e qeverisjes qendrore (ministritë dhe agjencitë e pavaruara), dhe ato lokale. Me buxhet fillestar i cili nuk kishte ndryshuar as në fund të vitit, të hyrat jo tatimore për vitin 2019 ishin parashikuar 208,227,000€. Prej tyre, niveli Qendror 103,227,000€, niveli lokal 57,000,000€, Renta minerare 33,000,000€, Taksa koncesionare 11,000,000€ dhe të hyrat nga interesi 4,000,000€. Shuma totale e mbledhur e të hyrave jo tatimore gjatë vitit 2019 ishte tejkualuar për 3% dhe në fund të vitit ishte 214,614,000€. Prej tyre, shuma e mbledhur nga subjektet e Qeverisjes Qendrore 121,405,000€, nga Qeverisja Lokale 50,050,000€, nga Rentat minerare 28,385,000€, nga Taksat koncesionare 11,083,000€, dhe Të hyrat nga interesi i kedive për Ndërmarrjet Publike 2,691,000€.

Përderisa në nivelin qendror, plani i të hyrave jotatimore ishte tejkualuar për 18,405,000€ ose 17.9%, në nivelin lokal kishte ngecje në realizmin e planit për 6,950,000€ apo 12%. Kjo, për arsyen se 31 Komuna planin e realizimit e kishin përmbushë 90%, Krahasuar trendin e tri viteve të fundit, shihet se të hyrat jo tatimore janë rritur për 11% krahasuar me vitin 2018, përkatësisht 15% krahasuar me vitin 2017.

Taksat dhe ngarkesat tjera në nivel të organizatave buxhetore të Qeverisë Lokale

Të hyrat jo tatimore - taksat ngarkesat tjera niveli lokal kanë të bëjnë me: taksa komunale, leje ndërtimore, taksë për regjistrim të automjeteve, taksë për ndërrimin e destinimit të tokës, taksë për certifikata tjera, taksë për regjistrimin e trashëgimisë, leje mjedisore komunale dhe shfrytëzimi i pronës publike. Plani buxhetor për të hyrat jo tatimore në nivelin lokal ishte 57,000,000€, ndërsa realizimi 50,050,000€ apo 88%. Përqindja e realizimit të buxhetit në 31 komuna ishte nën 90%. Komunat me performancë më të dobët në realizmin e planit të të hyrave ishin: Leposaviqi 7%, Zveçani 8%, Zubin Potoku 9%, Kamenica 40%, Novobërda 53%, Kaçaniku 55%, Dragashi 57%, Podujeva 59%, Deçan 60%, Shtërpca 63%, Suhareka 63%, Peja 66% dhe Gjilani 69%.

Parregullsitë e identifikuar në këtë fushë në raportet individuale të auditimit janë:

Zonat komunale jo në pajtim me rregulloren;

- Vonesat në lëshimin e lejeve të ndërtimit;
- Faturimi i tatimit në pronë jo në pajtim me udhëzimin administrativ;
- Vonesa në shqyrtimin e ankesave të tatimpaguesve;
- Dobësi në menaxhimin e kontratave të dhënies me qira të pronave të paluajtshme parcelave dhe lokaleve afariste;
- Mos verifikimi i pronave tatimore, dhe dobësi në menaxhimin e të dhënave të tatimit në pronë;
- Mos arkëtimi i të hyrave sipas kontratave;
- Shfrytëzim i pronave publike me kontrata të skaduara;
- Mos aplikimi i taksës vjetore për shfrytëzuesit e pronës publike komunale; dhe
- Dhënia me qira e pronës komunale pa respektimin e procedurave.

Huamarrja e jashtme dhe e brendshme

Si burim për financimin e deficiteve buxhetore, me Ligjin e Buxhetit nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2019, Qeveria kishte planifikuar që një pjesë të pagesave ta financoj nga huamarrjet. Huamarrja e brendshme ishte planifikuar në shumë prej 135,000,000€, ndërsa janë realizuar 115,322,000€ apo 85.4% e planit për shkak se pas vlerësimit të nevojave të financimit, është ndryshuar kalendari duke hequr dorë nga disa emetime të Letrave me Vlerë. Dhe, huamarrja e jashtme ishte planifikuar në shumë prej 201,000,195€, ndërsa janë realizuar 42,941,000€ apo 21.4% e planit.

Ngecje ishte shkaktuar kryesisht tek klauzola e investimeve, me të cilin ishin paraparë të realizoheshin shumë projekte. Vlera totale e planifikuar nga klauzola e investimeve ishte 123,000,000€, ndërsa realizimi ishte 14,486,667€. Financimi i projekteve nga institucionet financiare ndërkombëtare të buxhetuara ishte 53,195,000€, ndërsa realizimi ishte 20,079,063€ apo 37.7% dhe nën huazimet për ndërmarrjet publike të buxhetuara ishin 24,000,000€, ndërsa realizimi ishte 7,901,000€ apo 33%. Kjo kishte ndodhur pasi që njësitë implementuese nuk kishin marrë parasysh të gjithë faktorët dhe nuk kishin bërë përgatitjet e duhura me rastin e planifikimit të projekteve kur ishin bërë kërkesat për inicimin e procesit të huamarrjes. Aranzhimet për huamarrje kanë ndodhur para se të krijohen kushtet për shfrytëzimin e këtyre fondeve.

Projeksionet fillestare të Qeverisë ishin që gjatë vitit të huazohen 336,195,000€, por gjendja aktuale e huamarrjeve në fund të vitit ishte dukshëm më e vogël – 158,264,000€, respektivisht vetëm 47% e shumës së planifikuar. Krahasuar me një vit më parë, huamarrja ka shënuar një rritje prej 36 milionë apo rreth 30%.

Në seksionet vijuese të raportit, kjo pjesë do të shtjellohet më hollësisht.

Grantet e përcaktuara të donatorëve dhe grantet për mbështetje buxhetore

Grantet e Përcaktuara të Donatorëve janë fonde të cilat duhet të shfrytëzohen në pajtim me kushtet e marrëveshjeve në mes Qeverisë dhe dhuruesve. Këto fonde destinohen për qëllime specifike dhe me buxhet vjetor llogariten si pjesë e të hyrave të përgjithshme buxhetore për financimin e projekteve të ndryshme, ndërsa grantet për mbështetje buxhetore i janë dhënë Qeverisë për zbatimin e Strategjisë për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike (2016-2020) dhe për projektin e Modernizimit të Administratës Publike.

Shuma e granteve sipas Buxhetit përfundimtar ishte 18,487,000€, ndërsa ishin pranuar 19,487,000€, prej të cilave si grante të përcaktuara 7,987,000€ dhe grante për mbështetje buxhetore 11,500,000€.

Pranimet tjera

Shuma e pranimeve tjera me buxhet final ishte parashikuar 187,000,000€, ndërsa ishin realizuar 168,514,000€ apo 90%. Këtë shumë e përbëjnë: Fondi i depozitave 2,081,000€, Kthimi i kredive nga Ndërmarrjet publike (KEK) 10,876,000€, të Hyrat e dedikuara 5,555,000€; dhe Të hyrat e njëhershme të AKP-së 150,002,000€. Siç është shpjeguar më lartë, në këtë grup të hyrash gabimisht ishte planifikuar edhe fondi i THV të bartura nga vitet paraprake, e që gjatë vitit nuk është realizuar për shkak se ato veçse ishin të pranuar më herët.

2.1.2 Realizimi i të hyrave buxhetore - struktura e të hyrave

Tatimet direkte dhe indirekte janë burimet kryesore për arkën shtetërore dhe përbëjnë afër 75% të të hyrave të tërësishme buxhetore. Këto të hyra tatimore realizohen përmes Doganës së Kosovës (DK) dhe Administratës Tatimore të Kosovës (ATK). Këto dy agjenci në vitin 2019 kanë pasur një performancë mjaft të mirë sa i përket përmbushjes së planit në realizimin e të hyrave.

Në vitin 2019 të hyrat neto nga tatimet direkte dhe indirekte të planifikuara (duke i zbritur kthimet tatimore) ishin 1,730,550,000€, ndërsa ishin realizuar në shumën prej 1,662,043,000€, me një realizim të planit prej 96%, ndonëse në vlerë nominale të hyrat e realizuara janë rritur për 69 milionë apo 3% krahasuar me një vit më parë. Me rastin e planifikimit ishte projektuar që këto të hyra të rriten mbi 10%, dhe për këtë arsye të hyrat ishin realizuar 4% më pak se plani. Në këtë performancë të mirë ka ndikuar: rritja e shpenzimeve dhe konsumit publik, rritja e importeve në funksion të mbështetjes së aktivitetit të shtuar ekonomik në vend, por edhe si rezultat i monitorimit më të mirë doganor, efekti nga masat e reja për përmirësimin e ambientit të të bërit biznes, lehtësimet me rastin e importeve për sektorin e prodhimit, planet për ngushtimin e hendekut tatimor dhe ekonomisë jo-formale, masat për avancimin në efikasitetin e mbledhjes së të hyrave nga agjencitë mbledhëse, përmes thjeshtësimit të sistemit tatimor dhe doganor, etj.

Të hyrat jo tatimore mbledhen nga Organizatat e nivelit qendror dhe Komunitat. Shuma totale e mbledhur e të hyrave jo tatimore gjatë vitit 2019 ishte 214,631,000€, kundrejt planit buxhetor 208,227,000€. Prej tyre: 121,405,000€ është shuma e mbledhur nga subjektet e Qeverisjes Qendrore, 50,050,000€ nga Qeverisja Lokale, Taksa koncesionare 11,083,000€, Rentat minerare 29,385,000€, dhe të Hyrat nga interesi (ndërmarrjet publike) 2,691,000€. Rritja e të hyrave jotatimore në vitin 2019 në raport me vitin paraprak ishte mbi 11%, ndërsa financimi i shpenzimeve të tërësishme buxhetore nga ky burim është rreth 10%

Nga të hyrat tatimore dhe jo tatimore, mbulimi i shpenzimeve buxhetore ishte në shkallën prej 87%, ndërsa pjesa tjetër e shpenzimeve është mbuluar nga huamarrjet dhe grantet e donatorëve.

2.1.3 Analiza e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike

Shpenzimet e përgjithshme për vitin 2019 të planifikuara sipas buxhetit final ishin 2,517,767,000€, ndërsa shkalla e ekzekutimit ishte 2,152,546,000€ apo 85.5% e shumës së planifikuar. Përqindja e shpenzimeve në raport me vitin e kaluar ishte më e ultë për 4.5%, por në vlerë nominale shpenzimet e vitit 2019 janë për 172,987,000€ më të larta se në vitin 2018.



Sipas Ligjit Nr. 06/L-133 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, shpenzimet sipas buxhetit fillestar ishin planifikuar në vlerë 2,452,237,000€, kurse me buxhet përfundimtar ato ishin rritur në 2,517,767,000€ apo për 65,530,000€.

Tabela në vazhdim paraqet trendin e shpenzimeve gjatë tri viteve të fundit sipas kategorive ekonomike.

Tabela 8 - Pasqyra e Buxhetit dhe Shpenzimeve sipas kategorive

(në euro)

Shpenzimet	Buxheti fillestar	Buxheti final	Realizimi 2019	Realizimi 2018	Realizimi 2017
Pagat dhe Shtesat	619,997,000	631,334,000	616,921,000	592,588,000	550,749,000
Mallrat dhe Shërbimet	307,127,000	314,049,000	273,312,000	229,057,000	204,161,000
Shërbimet komunale	29,483,000	28,888,000	24,866,000	23,440,000	24,158,000
Subvenc. dhe Transfere	600,024,000	647,345,000	627,959,000	558,778,000	508,316,000
Investime kapitale	788,800,000	794,063,000	533,773,000	533,064,000	471,098,000
Rezerva	4,800,000	83,000	0	0	0
Pagesat tjera ³	102,005,000	102,005,000	75,715,000	42,631,000	78,322,000
Gjithsej:	2,452,237,000	2,517,767,000	2,152,546,000	1,979,559,000	1,836,804,000



- Pagat dhe Shtesat
- Mallrat dhe Shërbimet
- Shërbimet komunale
- Subvenc. dhe Transfere
- Investime kapitale
- Rezerva
- Pagesat tjera

Nga të dhënat në tabelë shihet se shumatat e buxhetuara për shpenzime, kundrejt shpenzimeve faktike kanë një diferencë mjaft të theksuar. Shpenzimet e realizuara në krahasim me planin përfundimtar buxhetor janë 85.5%. Në shpenzimet aktuale të buxhetit, nuk janë përfshi pagesat e kryera nga palët e treta në shumën prej 146,290€.

Planifikimi i dobët i shpenzimeve vërehet sidomos te Shpenzimet Kapitale, të cilat në raport me buxhetin e planifikuar janë realizuar vetëm 67%, pothuajse në shumën e njëjtë nominale të shpenzuar me atë në vitin paraprak. Qeveria kishte një plan mjaft ambicioz në rritjen e shpenzimeve në këtë kategori, ngase prej 673 milionë sa ishin planifikuar në vitin 2018, shumata e investimeve ishte rritur në 794 milionë gjatë këtij viti, apo rreth 120 milionë më shumë.

Analiza e shpenzimeve buxhetore sipas kategorive ka rezultuar me rezultatet si vijon:

Pagat dhe Mëditjet

Planifikimi i shpenzimeve për paga ishte mjaft i përafërt me shpenzimet aktuale dhe ishte realizuar në shkallën 97.7%. Në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, pagat marrin pjesë me 28.7% dhe përfaqësojnë kategorinë e dytë me përqindjen më të lartë të shpenzimeve. Fondi i shpenzimeve të pagave bruto është rritur përafërsisht 25 milionë apo 4% në krahasim me vitin 2018. Kjo rritje është si pasojë e rritjes së numrit të punëtorëve në sektorin publik gjatë vitit 2019 për 3,565 të punësuar të rinj.


Me rastin e testimit të pagave, respektivisht vijueshmërisë në punë të punësuarve, ne kemi gjetur se 215 punëtorë të sistemuar në tetë (8) ministri, janë paguar gjatë tërë vitit në një shumë totale prej 1,021,321€ pa dalur fare në punë. Pagesat si të tilla trajtohen pagesa të parregullta. Ky staf ishte shpërndarë nëpër këto ministri si rezultat i Marrëveshjes së Brukselit në mes Kosovës dhe Serbisë të vitit 2016, por që futja e tyre në listën e pagave ishte bërë para se të krijoheshin kushtet normale për punë.

Ky problem është i pranishëm për vite me radhë, dhe ne kemi dhënë rekomandime se si të zgjidhet problemi, por i njëjti është adresuar vetëm pjesërisht. Vetëm tri (3) ministri, kanë marrë veprimet e duhura, dhe ky problem është adresuar nga: MSH, MPMS dhe MAPL, por në tetë (8) të tjera, çështja ka mbetur e pa zgjidhur dhe po përcillet nga viti në vit.

Të dhënat në detaje për këto pagesa mund t'i shihni në tabelën në vazhdim:

Tabela 9 - Pgesat e kryera sipas Marrëveshjes së Brukselit (në euro)

Nr	Organizata buxhetore	Numri i stafit të paguar	Pagesat gjatë vitit 2019
1.	MASHT	32	134,675
2.	MKK	21	98,362
3.	MZHE	18	92,708
4.	MTI	25	124,874
5.	MMPH	36	163,198
6.	MKRS	31	150,789
7.	MI	32	156,151
8.	MAP	20	100,582
	Totali	215	1,021,321



Sa i përket numrit të të punësuarve, sipas Ligjit të Buxhetit nr. 06/L-133, numri i lejuar i stafit në nivelin qendror dhe lokal ishte 85,983, ndërsa numri aktual i të punësuarve në fund të vitit ishte 83,789. Paga mesatare bruto në sektorin publik për vitin 2019 ishte 614 euro, pothuajse e njëjtë me mesataren e vitit 2018. Për shkak të kontesteve nga marrëdhënia e punës, përmes vendimeve gjyqësore organizatat buxhetore gjatë vitit 2019 kanë paguar paga në një shumë totale prej 820,000€.

Mangësitë apo parregullsitë e identifikuara nga raportet individuale të auditimit në kategorinë e pagave dhe mëditjeve janë:

- Pagesat e pagave jubilarë dhe pagave pas pensionimit të realizuara me vendim të gjykatave, e të paguara nga kategoria mallra dhe shërbime;
- Pagesat nga kategoria paga dhe mëditje për komisionet të brendshme në kundërshtim me kërkesat ligjore. Komisionet e tilla ishin për pjesëmarrje në hapje dhe vlerësimin e ofertave të prokurimit, regjistrimin dhe vlerësimin e pasurisë, planifikimin e buxhetit, pranimin e studentëve të rinj, për ankesa dhe parashtresa, rekrutim të stafit, ndarjen e bursave, hartimin e strategjive dhe rregulloreve mbështetëse;
- Mangësi në mbajtjen e evidencave të kujdestarive, vijueshmërisë në punë dhe pagesën e shujtave;
- Neglizhenca në zbatimin e rregulloreve për sistematizimin e vendeve të punës;
- Shpallje e konkurseve në mospajtim me katalogun e vendeve të punës;
- Ushtrimi i pozitave të punës në mospërputhje me gradat e fituara;
- Avancim i brendshëm i stafit pa plan paraprak të rekrutimit;
- Kompensimi i pagave jo në pajtim me Aktet e Emërimit; dhe
- Mos kompletimi i dosjeve të personelit konform kërkesave ligjore.

Mallrat dhe Shërbimet

Për furnizimin me mallra dhe shërbime gjatë vitit 2019 janë shpenzuar mbi 273 milionë apo 87% e buxhetit total. Rritja e shpenzimeve në këtë kategori, në krahasim me vitin e kaluar ishte rreth 44 milionë apo mbi 19%. Kjo rritje është si rezultat i kërkesave të shtuara për rritjen e fondeve për mirëmbajtjen e projekteve kapitale. Përkundër kërkesave të vazhdueshme të organizatave buxhetore për rritjen e shpenzimeve në këtë kategori, Qeveria zbaton politika mjaft restriktive në ndarjet buxhetore në këtë fushë, duke vendosur fokusin primar në rritjen sa më të madhe të shpenzimeve për qëllime kapitale.

Zërat dominant në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve të cilët përbëjnë 161,103,000€ apo 59% të totalit të shpenzimeve janë:

Shërbimet tjera kontraktuese	52,471,000	Vendimet e gjykatave	6,591,000
Furnizime mjekësore	38,931,000	Veshmbathje	6,019,000
Furnizim me ushqim dhe pije/deka zyrtare	12,806,000	Mirëmbajtja e ndërtesave	5,864,000
Qiraja për ndërtesa	10,409,000	Lëndë djegëse - dru	4,934,000
Shërbime intelektuale këshillëdhënëse	9,783,000	Dreka zyrtare	3,773,000
Karburant për vetura	8,522,000		

Mangësitë apo parregullsitë e dala nga raportet individuale të auditimit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishin:

- Mos mbyllja e avanseve konform kërkesave ligjore;
- Zhvillimi i aktiviteteve të prokurimit pa njoftuar AQP-në dhe lidhja e kontratave pa zotim të fondeve;
- Përdorimi i procedurave të negociuar pa publikim dhe kufizimi i konkurrencës;
- Mangësi në vendosjen e kriterëve më rastin e zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit;
- Dobësi në menaxhimin e kontratave publike;
- Aplikimi i anekse kontratave pa mbështetje ligjore;
- Tejkalimi i vlerës së kontratës kornize;
- Vonesa në liferimin e mallrave dhe furnizimeve; dhe
- Realizim i pagesave nga fondi i huamarrjes jo në pajtueshmëri me marrëveshjet.

Subvencionet dhe Transferet

Në totalin e shpenzimeve të përgjithshme marrin pjesë me mbi 29%. Në tri vitet e fundit ka pasur një rritje të shpejtë të këtyre shpenzimeve. Krahasuar me vitin 2018, rritja është 69 milionë apo 12%, kurse në krahasim me vitin 2017 subvencionet janë rritur për 120 milionë apo 23.5%.

Shpenzimet e listuara më poshtë përbëjnë 571,637,000€ mbi 90% të shpenzimeve në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve. Këto fonde janë shpenzuar për financimin e skemave pensionale dhe financimin e disa veprimtarive tjera. Kategoritë dominante të këto shpenzime ishin:

Pensionet bazë	145,440,000	Pagesat për personat me aftësi të kufizuar	32,031,000
Pensionet kontributdhënëse	119,935,000	Pensionet - Kategoria I	31,385,000
Pensionet për veteranë të luftës	76,756,000	Subvencionet për entitetet jopublike	28,100,000
Subvencionet për entitetet publike	63,502,000	Ristrukturimi i potencialit fizik	17,756,000
Pagesat për invalidët e luftës	41,124,000	Pagesat për kultura bujqësore	15,608,000

Mangësitë apo parregullsitë e identifikuarë përmes Raportëve individuale të auditimit në kategorinë Subvencione dhe Transfere:

- Mos përgatitja e planit vjetor dhe mos dërgimi në Qeveri për mbështetje financiare për Organizata jo Qeveritare (OJQ);
- Mbështetja financiare për OJQ pa shpallje publike;
- Mos specifikimi i afateve në programe dhe Udhëzimet lidhur më afatin e shqyrtimit të aplikacioneve për aplikuesit e subvencioneve në sektorin e bujqësisë;
- Mos respektimi i kriterëve për subvencionim nga komisionet vlerësimit;
- Dhënia e subvencioneve për përfituesit njëjtë;
- Përfitimi i pensioneve apo ndihmave sociale nga persona të cilët punojnë apo realizojnë të ardhura personale;
- Shpërndarja e subvencioneve për personelin e Ministrisë; dhe
- Mos raportimi për arsyetimin e subvencioneve nga përfituesit.

Investimet kapitale

Përkundër projeksioneve buxhetore mjaft ambicioze ku për investime kapitale ishin ndarë 794 milionë apo gati 32% e buxhetit final, kjo shumë gjatë vitit ishte shpenzuar vetëm 534 apo 67%. Mbi 260 milionë kanë mbetur të pa shpenzuara dhe kjo flet për një performancë të dobët të organizatave buxhetore. Kjo ka rezultuar me dështim të shumë projekteve kapitale. Krahasuar me vitin paraprak, buxheti i investimeve kapitale ishte realizuar saktësisht në vlerë nominale të njëjtë, ndonëse buxheti i këtij viti ishte parashikuar për 120 milionë më i lartë se ai i vitit paraprak.

Dhjetë fushat e listuara në vijim, përfshinë rreth 364,303,000 apo 70% të shpenzimeve totale të kategorisë së investimeve kapitale të shpenzuara gjatë vitit 2019:

Autoudhët	85,212,000	Mirëmbajtja investive	20,421,000
Rrugët lokale	84,642,000	Pajisjet tjera	18,529,000
Rrugët regjionale	57,119,000	Kanalizime	16,015,000
Objektet arsimore	29,116,000	Toka	14,114,000
Ndërtesat administrative afariste	27,845,000	Trotuare	11,290,000

Fondet buxhetore për investime kapitale janë të destinuara për financimin e projekteve në infrastrukturë, ndërtimin e autoudhëve, rrugëve lokale, në fushën e arsimit, shëndetësisë, objekteve kulturore dhe sportive, dhe shërbimeve tjera publike. Menaxhimi i projekteve kapitale bëhet përmes Programit për Investime Publike (PIP). Planifikimi i projekteve në PIP duhet të bëhet në mënyrë të detajuar dhe të aprovet nga krerët e organizatave bazuar në analizat dhe arsyeshmërinë e tyre. Në anën tjetër, MF aprovon këto kërkesa të OB-ve duke u bazuar në dokumentet e paraqitura në PIP në lidhje me arsyeshmërinë dhe duke siguruar se janë në përgjegjësi dhe kompetencë të tyre.

Për shkak të mungesës së përgatitjeve me kohë, vlen të theksohet se fonde të konsiderueshme kanë mbetur të pa shpenzuara: 115 milionë nga klauzola e investimeve, dhe buxheti nga të hyrat vetiake i cili ishte buxhetuar 145,547,203€, ndërsa ishte realizuar 89,903,470€ apo 62%.

Me rastin e përgatitjes së buxhetit vjetor, vërehet një tendencë permanente e Qeverisë që shpenzimet buxhetore në kategorinë e investimeve t'i rritë nga viti në vit, për shkak se investimet kapitale ndikojnë direkt në rritjen ekonomike kombëtare. Por, për shkak të procedurave të stërzgjatura të prokurimit, ankesave të operatorëve në OSHP, çështjeve të pazgjidhura pronësore, shkalla e ekzekutimit të buxhetit në këtë kategori, vazhdon të mbetet më e ulta për vite me radhë.

Mangësitë më të theksuara të kjo kategori e shpenzimeve të identifikuar nga raportet individuale të organizatave buxhetore janë:

- Planifikimet joadekuate dhe aprovimet e shpenzimeve si "kapitale", ndërkohë që të njëjtat nuk përmbushin kriteret të trajtohen si të tilla, për shkak se këto fonde shpenzohen për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, dhënien e subvencioneve apo qëllime tjera;
- Shumica e pagesave përmes vendimeve të të formës së prerë nga procedurat e përmbarimit dhe gjykatat bëhet nga kategoria buxhetore e Investimeve kapitale, kryesisht për shkak të mungesës së buxhetit në kategoritë adekuate të shpenzimeve. Gjatë këtij viti, me vendime të gjykatave dhe pagesat direkte nga Thesari, nga kjo kategori janë paguar mbi 17 milionë euro, të cilat për nga natyra nuk janë të gjitha për qëllime kapitale;
- Planifikimi i pjesshëm i fondeve buxhetore për financimin e projekteve, dhe rrjedhimisht, ndërprerjet dhe vonesat në realizimin me kohë të këtyre projekteve, dhe rifillimi i punimeve pas sigurimit të fondeve shtesë. Në shumë raste, për qëllime politike ndahen shuma simbolike për projekte sa për ta futur projektin në procedura të realizimit, dhe për pasojë, të njëjtat projekte më pas zvarriten për vite me radhë;
- Procedurat e prokurimit shpesh iniciohen pa projekte të gatshme ekzekutive, dhe si pasojë e kësaj projektet gjatë realizimit duhet të revidohen dhe korrigjohen në paramasa dhe parallogari, dhe rezultojnë me tejkalim të punimeve dhe kosto financiare shtesë;
- Mbikëqyrja e dobët e projekteve në fazën e ekzekutimit, ku në raste të caktuara konfirmohen sasi të punimeve të pakryera dhe faturohen materiale të pa harxhuara gjatë punimeve;
- Monitorimi i pamjaftueshëm i kontratave të prokurimit; dhe
- Çertifikimi i pagesave për punët e pa kryera dhe furnizimet e papranuara.

Pagesat tjera

Sipas buxhetit final, ndarjet buxhetore për këtë kategori ishin parashikuar në vlerë prej 102,000,000€, por gjatë vitit janë kryer këto lloje pagesash: Pagesat për kthimin e borxhit 66,118,000€, pagesa e

borxhit në emër të nën huazimeve 8,515,000€ dhe Kthimet nga fondet e depozitave 1,082,000€, që në total janë 75,715,000€. Prej tyre, mbi 51 milionë ishin pagesa për kthimin e kryegjësë dhe pagesave për nënhuazime, ndërsa rreth 23 milionë për pagesën e interesit për kreditë e jashtme, të brendshme dhe taksave e tarifave tjera. Buxheti kundrejt planit ishte realizuar 74%.

Shpenzimet nga kategoria e rezervës/të paparashikuara

Sipas Ligjit Nr. 06/L-133 për ndarjet buxhetore të vitit 2019, buxheti për kategorinë e rezervës ishte 4,800,000€. Gjatë vitit me Vendime të Qeverisë buxheti për rezervën ishte rritur për 1,330,242€. Këto mjete ishin transferuar nga programi i kontingjencës në Ministrinë e Financave në buxhetin e kategorisë së rezervës, me ç'rast buxheti final ishte rritur në 6,130,242€, ndërsa ishin shpenzuar 6,047,022€. Në krahasim me vitin 2018, shpenzimet në këtë kategori ishin me të vogla për 1,587,904 apo për 35.6%.

Janë gjithsej 11 Organizata Buxhetore që me Vendime të Qeverisë kanë përfituar buxhet shtesë nga kategoria e rezervës buxhetore:

- 6 OB në Nivel Qendror.....4,603,925€ apo 76%
- 1 Agjenci e pavarur.....171,864€ apo 3%
- 4 Komuna.....1,271,233€ apo 21%

Tabela 10 - Shpenzimet nga kategoria e rezervës

Organizata buxhetore	Kategoria e shpenzimeve	Fondet e alokuara	Ndarja e buxhetit sipas aktiviteteve
Ministria e Financave	Subvencione dhe Transfere	2,075,425	• Për shoqatat e dala nga Lufta e UÇK-së;
			• Për ndihmë Republikës së Shqipërisë me rastin e tërmetit;
			• Realizimi i projekteve filmike;
			• Mbështetje për Federata e Xhudos së Kosovës.
Zyra e Kryeministrit	Mallra dhe shërbime	894,910	<ul style="list-style-type: none"> • Për Komitetin Ndërmintor për Kompleksin Memorial; • Për Zyrën e Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport dhe për themelimin e Qendrës përkujtimore "Bllacë 1999".
	Subvencione dhe Transfere	363,000	Zyrës për çështje të komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit.
Administrata e Kuvendit	Mallra dhe shërbime	27,300	Për Komisionin e Ndihmës Shtetërore, për furnizimin me pajisje të zyrave, qira.
Ministria e Administratës Publike	Mallra dhe shërbime	95,000	Hartimi i akteve nënligjore për zbatimin e Reformës në Administratën Publike.
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Subvencione dhe Transfere	1,000,000	Realizimi i aktiviteteve për 11 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, dhe për ndarjen e mjeteve financiare për Kombëtaren e Kosovës në Futboll.
	Mallra dhe shërbime	57,994	Pagesa e punonjësve me kontrata për shërbime të veçanta në rezidencën presidenciale "Ibrahim Rugova".
	Investime Kapitale	20,296	Rregullimi dhe funksionimi i "Shtëpisë Muze në Lagjen Lumbardh - Mitrovicë".
Ministria e Drejtësisë	Subvencione dhe Transfere	70,000	Mbrojtje juridike dhe mbështetje financiare për personat e akuzuar potencial.
Këshilli Prokurorial i Kosovës	Paga dhe mëditje	171,864	Kompensimi i shtesave dhe stimulimi financiar për Prokurorët Special për 2019.
Komuna e Rahovecit	Subvencione dhe Transfere	1,000,000	Sanimi i dëmeve të shkaktuara nga breshëri dhe vërshimet.
Komuna e Istogut	Investime Kapitale	137,033	Projekti i ri "Zëvendësimi i gypit të azbestit"
Komuna e Mitrovicës	Investime Kapitale	114,200	Ngritja e monumentit kushtuar dëshmorit Harun Beka, dhe Blerja e aparaturës digjitale për shëndetësi.
Komuna e Skenderajt	Subvencione dhe Transfere	20,000	Mbështetje financiare për adresimin e nevojave për strehim të qytetarëve.
Gjithsej		6,047,022	

Neni 29 i Ligjit nr. 03/L-48 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit, përcakton se nëse ndodhë një rast për të cilin nevojiten shpenzime urgjente ose të paparashikuara, organizata përkatëse buxhetore mund të aplikoj pranë Ministrisë të Financave për fonde shtesë. Në aplikacion, ndër të tjera duhet të shpjegohen rrethanat të cilat kanë shkaktuar nevojën për fonde shtesë, të shpjegohen arsyet pse këto rrethana nuk kanë mundur të parashikohen dhe të identifikohen propozim shfrytëzimet e fondeve të kërkuara.

Në procesin e vlerësimit të pajtueshmërisë në lidhje me ndarjen e buxhetit shtesë nga kategoria e rezervës për Zyrën e Kryeministrit dhe Ministrinë e Financave, kemi identifikuar parregullsitë si në vijim:

- Në dy pagesa të testuara të Zyra e Kryeministrit, të cilat kishin ndodhur si pasojë e nxjerrjes së vendimeve të Qeverisë, për transferimin e mjeteve nga shpenzimet e paparashikuara në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, nuk ishin respektuar procedurat e kërkuara të aplikimit për fonde shtesë në Ministrinë e Financave.
- Për më tepër, shpenzimet e ndodhura, nuk ishin të natyrës urgjente apo shpenzimeve të paparashikuara, pasi këto shpenzime mund të planifikoheshin në buxhetin e rregullt të ZKM-së. Shpenzimet kishin të bënin me “Ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës hekurudhore në muzeun Bllaca” në vlerë 47,558€ dhe pagesa tjetër për “Ndarja e shpërblimeve ndaj personelit arsimor dhe Drejtorive Komunale të Arsimit”, me rastin e organizimit dhe pjesëmarrjes në garat e Programit Nacional për Rini, në vlerë 57,870€.
- Me rastin e testimin të tri pagesave të Ministrisë e Financave të cilat kishin ndodhur si pasojë e nxjerrjes së vendimeve të Qeverisë për transferimin e mjeteve nga shpenzimet e paparashikuara (rezervë), në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve, nuk ishin respektuar procedurat e kërkuara të aplikimit për fonde shtesë në MF.
- Shpenzimet e ndodhura nuk ishin të natyrës urgjente apo të paparashikuara. Rrjedhimisht këto shpenzime do të duhej të planifikoheshin në buxhetin e rregullt të MF-së dhe organizatave buxhetore përkatëse. Shpenzimet kishin të bënin me ndarjen e mjeteve financiare për përkrahjen e realizimit të filmit, „Lojë Jete” në vlerë 180,000€, për ndarjen e mjeteve financiare sipas kërkesës së Federatës së Xhudos së Kosovës 143,000€, si dhe 50,000€ për një rast për mbulimin e shpenzimeve për shërim jashtë vendit 50,000€; dhe
- Për realizimin e aktiviteteve për 11 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, MKRS-së i ishin ndarë fonde në shumë prej 500,000€. Ky nuk mund të trajtohet si aktivitet i parashikuar dhe i natyrës urgjente, dhe si i tillë është dashtë të parashihet me buxhetin e rregull vjetor, dhe jo të paguhet nga rezerva.

Shpenzimi i mjeteve nga fondi rezervë të cilat janë të përcaktuara për raste urgjente, për projekte të cilat duhet të planifikohen në buxhetin e rregullt, si dhe në mungesë të procedurës së kërkuar për aplikim në MF, rritë rrezikun që Qeveria të përballet me mungesë të buxhetit për trajtimin e situatave dhe ngjarjeve të paparashikuara (urgjente).

Rekomandimet për Pasqyrën e krahasimit të Buxhetit dhe Shpenzimeve

Rekomandimi për Qeverinë e Kosovës

Qeveria e Kosovës duhet të siguroj se janë krijuar të gjitha kushtet që stafi i punësuar në bazë të Marrëveshjes së Brukselit të vijoj procesin normal të punës. Deri atëherë, në listën e pagave të Thesarit, norma e punës duhet të jetë zero (0). Në të kundërtën, këto pagesa duhet të ndërpriten dhe vazhdimi i këtyre pagesave mund të bëhet nga kategoria e subvencioneve, me një bazë ligjore të mirëfilltë, sepse askush nuk duhet të kompensohet në emër të pagave, përderisa nuk kryen asnjë detyrë pune në interes të punëdhënësit.

Rekomandimet për Ministrinë e Financave

- MF duhet që përfundimisht me rastin e përgatitjes së Buxhetit fillestar të sqarojë të gjithë zërat buxhetor në mënyrë që bartja e të dhënave nga Tabela 1 në Pasqyra Financiare të jetë e qartë, konsistente dhe pa gabime; dhe
- Ministri i Financave dhe Departamenti i buxhetit duhet të sigurojnë se me rastin e aplikimit të organizatave buxhetore për fonde shtesë për nevoja urgjente apo të paparashikuara, të shpjegojnë në hollësi rrethanat të cilat kanë shkaktuar nevojën për këto fonde, të shpjegohen arsyet pse këto rrethana nuk kanë mundur të parashikohen dhe të identifikohen me rastin e përgatitjes së rregullt të buxhetit, dhe pas shqyrtimit nga Ministria e Financave, të dërgohen në Qeveri për aprovimin dhe ndarjen e këtyre fondeve nga rezerva.

2.2 Pasqyra e pasurive në para të gatshme dhe bilanci i fondeve

Bilanci i parasë së gatshme në fund të vitit përfshinë shumat e pa shpenzuara të fondeve nga: Paratë e gatshme në llogarinë kryesore, fondi zhvillimor në mirëbesim, paraja e gatshme në tranzit, kuotat në IFN, llogaritë e Ambasadave, paratë e gatshme (arka) dhe avancet e hapura.

Këto fonde në para të gatshme ndahen në fonde të destinuara për qëllime specifike dhe në fonde të pa shpërndara. Fondet për qëllime specifike përbëhen nga: Grantet e Përcaktuara të Donatorëve, Të hyrat vetjake të bartura, fondi i mirëbesimit për zhvillim, të hyrat e dedikuara, fondet tjera (kryesisht lloje të ndryshme të depozitave) dhe Fondet e pa shpenzuara nga huamarrja gjatë vitit 2019 dhe të bartura në vitin 2020.

Qeveria i menaxhon fondet përmes përdorimit të Llogarisë së Vetme të Thesarit (LIVTh). Pjesa më madhe e llogarive mbahen në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK). Shuma totale e parasë së gatshme në llogarinë e buxhetit të Republikës së Kosovës më 31 dhjetor 2019 ishte 458,251,000 €

Tabela në vazhdim paraqet të dhënat në detaje.

Tabela 11 - Pasqyra e parasë së gatshme dhe bilanci i fondeve

(në euro)

Llogaritë bankare të Buxhetit shtetëror	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017
Banka Qendrore e Kosovës	444,301,000	374,663,000	339,906,000
Fondi zhvillimor i mirëbesimit	4,754,000	4,514,000	5,047,000
Paraja në tranzit	4,632,000	4,031,000	10,179,000
Para në llogaritë e Misioneve Diplomatike	1,136,000	1,074,000	1,045,000
Para të gatshme (arka)	1,687,000	1,851,000	1,583,000
Kuotat në Institucione Financiare Ndërkombëtare	1,741,000	1,741,000	0
Gjithsej paraja e gatshme në fund të vitit	458,251,000	387,874,000	357,760,000
Bilanci i fondeve	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017
A. Gjithsej fonde të përcaktuara	97,395,000	82,870,000	63,642,000
Grantet e përcaktuara të donatorëve	8,866,000	7,803,000	6,452,000
Të hyrat vetiake të bartura - niveli qendror	5,741,000	3,932,000	2,772,000
Të hyrat vetiake të bartura - niveli lokal	49,477,000	44,308,000	30,108,000
Fondi zhvillimor në mirëbesim	8,004,000	8,689,000	8,755,000
Të hyrat e dedikuara	803,000	1,706,000	803,000
Të hyrat tjera	17,504,000	16,432,000	14,722,000
Fonde të pa shpenzuara nga huamarrja	7,000,000	0	0
B. Fonde të pa shpërndara	360,856,000	305,004,000	294,147,000
Gjithsej fondet (A+B)	458,251,000	387,874,000	357,760,000

Bilanci i llogarive në para të gatshme të mbajtura në BQK është rritur dukshëm në krahasim me dy vitet paraprake. Paraja e gatshme në fund të vitit 2019 është rritur për 70,377,000€ apo 18% në krahasim me bilancin e vitit 2018 dhe 100,491,000€ apo 28% në krahasim me vitin 2017. Kjo rritje është rezultat i fondeve të pa shpenzuara të huamarrjes, të hyrave vatjake të bartura dhe të hyrat e njëhershme të AKP-së.

Me rastin e rishikimeve analitike të Pasqyrave Financiare, ne nuk kemi gjetur mospërputhje në mes të dhënave të prezantuara në Pasqyrën e mësipërme me të dhënat në Librin e përgjithshëm të Thesarit.

Paraja e gatshme dhe paraja në tranzit

Kjo shumë përfaqëson paranë e imët e cila mbahet nga organizatat buxhetore, e të cilat nuk janë shpenzuar as depozituar në llogarinë kryesore në BQK deri më 31.12.2019. Shuma e mbajtur e këtyre parave nga të gjitha organizatat buxhetore është 1,687,000€, ku pjesa më e madhe e tyre ishte evidencuar në MSH (720 mijë), MPJ (329 mijë), etj. Paratë në tranzit janë para të cilat janë pranuar përmes bankave komerciale si të hyra të vitit 2019, por që në datën 31.12.2019 nuk janë transferuar në llogarinë e Thesarit në BQK, ndërsa janë të regjistruara në SIMFK si të hyra të vitit 2019.

Llogaritë e misioneve diplomatike, në pajtim me LMFPJ janë llogari të hapura nga Thesari në bankat komerciale në shtetet ku Qeveria e Republikës së Kosovës ka misionet diplomatike, dhe të cilat mbahen për qëllime të ofrimit të shërbimeve bankare për Ambasadat dhe Konsullatat në këto shtete, sipas kërkesës së MPJ. Gjendja e fondeve në këto llogari për vitin 2019 ishte 1,136,000€, e përafërt me shumën e vitit të kaluar.

Analiza e deficitit buxhetor

Sipas nenit 46 të LMFP, Ministri duhet t'i dorëzojë Qeverisë Raportin përfundimtar mbi buxhetin, të ardhurat dhe shpenzimet, në të cilin duhet të paraqiten të dhëna krahasimore për këto vite lidhur me diskutimin për respektimin e kufirit të deficitit, përfshirë: shkaqet e devijimeve dhe financimin e deficiteve, nëse ka të tillë, apo shkaqet e suficiteve buxhetore dhe investimin e atyre suficiteve, nëse ka të tillë.

Financimi i deficiteve buxhetore, sipas rregullave fiskale, bëhet nga fondet e huamarrjeve. Qeveria ka respektuar kërkesat e mësipërme dhe për qëllime të njëjta kishte planifikuar huamarrje prej 336,195,000€. Kjo shumë ishte planifikuar për të mbuluar shpenzimet të cilat ishin më të larta se të hyrat e planifikuara. Shuma aktuale e deficitit në fund të vitit ishte 33,246,000€ apo rreth 0.47 e BPV.

Sa i përket shpalosjes së të dhënave në Tabelën e deficitit buxhetor për vitin 2018, ne kemi identifikuar mospërputhje në prezantimin e Të Hyrave apo Shpenzimeve dhe përlllogaritjen e deficitit, të cilat janë prezantuar në mënyrë kumulative në tabelën në vijim.

Tabela 12 - Diferencat në përlllogaritjen e deficitit

(në euro)

Nr.	Zërat buxhetor	Sipas buxhetit fillestar RVF	Deficiti i përlllogaritur sipas auditimit	Aktuali në fund të vitit sipas RVF	Aktuali sipas auditimit
1.	Të hyrat e tërësishme	1,949,277,000	1,949,277,000	1,888,157,000	1,888,157,000
2.	Shpenzimet e tërësishme	2,378,232,000	2,378,232,000	2,093,420,000	2,093,420,000
3.	Të përjashtuara nga rregulla fiskale	(284,000,000)	(276,000,000)	(172,017,000)	(172,017,000)
4.	Deficiti i përlllogaritur	144,955,000	152,955,000	(33,246,000)	(33,246,000)
5.	Deficiti i përlllogaritur në %	2.00%	2.15%	0.47%	0.47%

Siç shihet nga të dhënat më sipër, deficiti i përlllogaritur me buxhetin fillestar sipas Ministrisë së Financave ishte 144,955,000€, ndërsa sipas kalkulimeve tona kjo shumë duhet të jetë 152,955,000€ apo me një diferencë prej 8,000,000€ më shumë sesa ishte përlllogaritur nga MF.

Pas rishikimeve tona analitike, ne kemi verifikuar saktësinë e përlllogaritjes së deficitit, dhe informatat në detaje janë paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela 13 - Përlllogaritja e deficitit të planifikuar dhe deficitit aktual për vitin 2019 (në euro)

Nr. rend.	Të Hyrat/Shpenzimet buxhetore	Buxheti fillestar	Realizimi
A	Pranimet/Të Hyrat e tërësishme (1 deri 4)	1,949,277,000	1,888,157,000
1.	Të hyrat tatimore	1,780,550,000	1,707,550,000
2.	Kthimet tatimore	(50,000,000)	(45,507,000)
3.	Të hyrat jo tatimore	208,227,000	214,614,000
4.	Grantet mbështetje buxhetore	10,500,000	11,500,000
B	Pagesat/Shpenzimet e tërësishme (5 deri 10)	2,350,232,000	2,069,970,000
5.	Shpenzimet e pagave	619,997,000	615,933,000
6.	Shpenzimet për mallra dhe shërbime	307,127,000	270,685,000
7.	Shpenzimet komunale	29,483,000	24,864,000
8.	Shpenzimet e Subvencioneve/Transfereve	600,024,000	627,271,000
9.	Shpenzimet për Investime kapitale	788,800,000	531,216,000
10.	Rezerva	4,800,000	0
C	Deficiti primar (A minus B)	(400,954,000)	(181,812,000)
11.	Shpenzimet e interesit	28,000,000	23,450,000
D	Deficiti i përgjithshëm	(428,954,000)	(205,263,000)
12.	Pagesat nga Të Hyrat Vetiake të bartura	0	30,656,000
13.	Shpenzimet nga pranimet e dedikuara për AKP	2,000,000	2,000,000
14.	Klauzola e investimeve	123,000,000	7,487,000
15.	E hyra e njëhershme e AKP-së	151,000,000	131,874,000
E	Deficiti i përgjithshëm sipas rregullës fiskale	(152,955,000)	(33,337,000)
F	Deficiti i përgjithshëm në përqindje	-2.15%	- 0.47%

2.3 Deklarata për kufirin e deficitit buxhetor

Në bazë të nenit 22.A.1 të Ligjit nr. 04/L-194 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) nr. 03/L-048 përcaktohet se: “Asnjë Ligj për ndarjet buxhetore nuk duhet të përfshij një deficit të përgjithshëm që kalon nivelin prej 2% të Bruto Produktit Vendor (BPV) të parashikuar”.

Neni 22.A.3 përcakton se me qëllim të mbajtjes së borxhit total në masë të konsiderueshme nën kufirin e borxhit të përcaktuar në Ligjin për Borxhin Publik, për çdo vit të pestë fiskal, Kuvendi shqyrton dhe sipas nevojës mund të bëjë përshtatje në:

- kufirin e deficitit në përputhje me kufirin e borxhit dhe me rritjen afatmesme të BPV-së të parashikuar në KASH-in më të fundit, dhe
- procedurat e zbatimit dhe parametrat kyç që shërbejnë si bazë për kufirin e deficitit.

LMFPP nr. 03/L-048 (me plotësime dhe ndryshime), përfshinë një vlerësim të pajtueshmërisë për kufirin e deficitit buxhetor i cili nuk duhet të tejkalojë nivelin prej 2% të Bruto Produkti Vendor (BPV) që për vitin 2019 ishte parashikuar në vlerë prej 7,123,000,000€, ndërsa BPV në fund të vitit kishte rezultuar me vlerën prej 7,006,000,000€².

Neni 7 i Ligjit nr. 05/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) nr. 03/L-048 përcakton se: "Për qëllime të përputhshmërisë me kufirin e deficitit, shpenzimet për projektet kapitale të financuara nga jashtë, nga institucionet financiare ndërkombëtare, Bashkimi Evropian apo institucionet e saj, qeveritë e huaja apo agjencitë e tyre të zhvillimit, nuk do të merren parasysh". Pra, në totalin e shpenzimeve të përjashtuara nga rregulla fiskale janë përfshirë shpenzimet e Të Hyrave Vetiake të bartura, shpenzimet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Kthimi i kredive qeveritare të dhëna më herët, dhe pagesat nga donatorët e jashtëm.

Ne kemi vlerësuar proceset në kuadër të MF-së për të siguruar zbatimin e këtyre kërkesave nga ligji lidhur me kufijtë e deficitit buxhetor dhe kemi vlerësuar kufirin aktual në fund vitin 2019. Ligji i buxhetit për vitin 2019 i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës është aprovuar me një deficit buxhetor prej 2%, megjithatë sipas kalkulimeve tona deficiti i planifikuar në fakt ishte 2.15% të BPV-së, derisa deficiti aktual në fund të vitit 2019 ishte 0.47%.

Ne kemi bërë analizën e shifrave të prezantuar në Tabelën 1 - parashikimet fiskale 2019-2021 të Ligjit nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2019, si dhe aneksin 1 të Raportit Financiar Vjetor të BRK-së, Tabela e deficitit buxhetor për vitin 2019.

Në Tabelën 1 parashikimet fiskale 2019-2021 të Ligjit Buxhetit dhe në aneksin 1 të RFV të BRK-së, në tabelën e deficitit buxhetor për vitin 2019, shpenzimet e përjashtuara nga rregulla fiskale ishin prezantuar në vlerë totale prej 284,000,000€. Në shpenzimet e përjashtuara sipas rregullës fiskale ishin llogaritur shpenzimet nga të hyra e njëhershme nga AKP në vlerë 151,000,000€, shpenzimet e financuara nga klauzola e investimeve 123,000,000€, shpenzimet nga të hyrat vetjake të bartura në vlerë 8,000,000€ dhe shpenzimet nga pranimet e dedikuara për AKP 2,000,000€.

Sipas vlerësimit tonë, shpenzimet e përjashtuara nga rregulla fiskale duhej të kalkuloreshin në vlerë totale prej 276,000,000€. Pra, nga shuma e shpenzimeve të përjashtuara nuk është dashtë të përfshihen të hyrat vetjake të nivelit qendror dhe komunal të bartura nga viti paraprak në shumën prej 8,000,000€, dhe kjo shumë ka ndikuar që deficiti i planifikuar të tejkalohej për 0.15 pikë të përqindjes.

Konkluzion

Sipas vlerësimeve tona, edhe pse kufiri i deficitit sipas buxhetit fillestar ishte për 0.15 pikë të përqindjes më i lartë se kufiri i lejuar, aktual i deficitit në fund të vitit ishte vetëm 0.47%, dhe mund të thuhet se Qeveria me rastin e përgatitjes së Projekt Ligjit për Ndarjet Buxhetore për vitin 2019, kishte siguruar që deficiti i planifikuar të jetë brenda kufirit të lejuar me LMFPP.

² Sipas Ligjit të buxhetit Nr. 06/L-133 për BRK viti 2019, tabela Nr.1 parashikimet fiskale 2019-2021, shënime shtesë BPV i parashikuar ishte 7,123,000,000€, ndërsa BPV aktual sipas shënimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës ishte 7,006,000,000€.

3 Analiza e shënimeve shpjeguese

Qeveria dhe OB-të kanë nën kontroll dhe menaxhojnë me fonde publike, si dhe i përdorin këto burime për të arritur objektivat e realizimit të shërbimeve. Megjithatë, Qeveria do të duhej të mbajë evidenca dhe të ketë informatat të hollësishme lidhur me fondet publike të cilat i menaxhon.

BSNKSP inkurajon fuqimisht që t'i përmbahemi shpalosjes së informatave shtesë, aty ku është e mundur, në mënyrë që të ngritet transparenca dhe përgjegjësia financiare. Shpalosja e informatave të përshtatshme në PFV në lidhje me aktivitetet e përgjithshme të Qeverisë, mund të rris transparençën e raporteve financiare dhe të ofroj mundësi për kuptim më të mirë të relacionit ndërmjet aktiviteteve qeveritare dhe palëve të interesit.

Përmbajtja e shpalosjeve apo anekseve në PFV duhet të jetë e qartë dhe të ofroj informacion të mjaftueshëm dhe cilësor për të gjithë zërat e pasqyrave në mënyrë që shfrytëzuesit e PFV-ve t'i kuptojnë më mirë fushat e raportuara, përkatësisht trendet vjetore të buxhetit dhe arsyet për ndryshime.

Përgjithësisht, PFV-të përmbajnë shpalosje të shumta, të cilat ofrojnë informacione të hollësishme për përmbajtjen e shifrave në tri Pasqyrat kryesore. Por, konkluzioni ynë është se nuk është i mjaftueshëm vetëm prezantimi në mënyrë analitike i shifrave në këto tri Pasqyra. Krahasuar me RVF 2019 shënimet shpjeguese në RVF 2019 janë më të plota, megjithëse në disa elemente ende ka nevojë të zgjerohen shpjegimet përkatëse, veçanërisht në pjesët ku ndryshimet janë të vështira të kuptohen nga ana e përdoruesve.

3.1 Konsolidimi i të dhënave nga Pasqyrat individuale me Pasqyrat e Qeverisë

Procesi i auditimit të organizatave buxhetore ka nxjerrë në pah një sërë mospërputhesh ndërmjet pasqyrave individuale dhe konsolidimit të tyre në Pasqyrat financiare të Qeverisë. Kjo për shkak se disa prej OB-ve nuk kanë regjistruar dhe pasqyruar drejt disa zëra në pasqyrat e tyre financiare, të cilët janë kryesisht pjesë e shpalosjeve. Thesari ka bërë konsolidimin e të dhënave ashtu siç është raportuar nga organizatat individuale. Mospërputhjet në shifrat e konsoliduara, kanë të bëjnë me çështjet si më poshtë:

- Në pasqyrën e shpalosjeve në PVF, pasuria është prezantuar në vlerë prej 8,753,551,918€, ndërsa sipas auditimeve individuale, pasuria kapitale mbi 1,000€ ka rezultuar të jetë 8,849,743,572€, me një nënvlerësim prej 96,191,653€. Kjo diferencë mbetet pas thyerjeve të saldoeve, për shkak se disa organizata kanë pasuri më shumë sesa i kanë paraqitur në pasqyra, dhe të tjerat kanë prezantuar të dhëna të mangëta mbi gjendjen e pasurive;
- Poashtu, pasuria e prezantuar nën 1,000€ në pasqyrën e shpalosjeve është në vlerë 40,735,519€, ndërsa sipas auditimeve individuale, totali i pasurive është 40,849,831€, me një diferencë prej 114,312€.
- Stoqet në pasqyrën e shpalosjeve në RVF të BRK-së ishin në vlerë 23,319,403€, ndërsa sipas auditimeve individuale kjo vlerë rezulton 23,314,894€, me një mbivlerësim të vogël prej 4,509€.
- Obligimet e papaguara në nivel vendi, në pasqyrën e shpalosjeve janë prezantuar në shumën prej 360,550,906€, kurse sipas raporteve individuale të auditimit vlera totale e obligimeve të papaguara ishte 310,565,520€. Pra, ekziston një mbivlerësim i obligimeve prej 49,985,386€;

- Gjendja e detyrimeve kontingjente në RVF është paraqitur në total 192,337,757€, ndërsa vlera e këtyre detyrimeve sipas auditimit ishte 196,657,085€, apo me një nënvlerësim prej 4,319,328€; dhe
- Llogaritë e arkëtueshme ishin prezantuar në RVF në total prej 634,643,815€, kurse sipas raporteve individuale të auditimit, vlera totale e këtyre llogarive ishte 637,148,819€, e nënvlerësuar për 2,505,004€.

3.2 Baza e përgatitjes, politikat kontabël dhe raportimi

Ministria e Financave, në emër të Qeverisë përgatit Pasqyrat financiare vjetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës në pajtim me LMFP Nr. 03/L-048, të ndryshuar me Ligjin 03/L-221, Ligjin 04/L-116, Ligjin 04/L-194, Ligjin 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007, si dhe në bazë të SNKSP - *Raportimi Financiar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme*.

Baza e kontabilitetit dhe raportimit të Qeverisë është LMFP dhe SNKSP sipas parimit të parasë së gatshme. Në këtë bazë, informatat e prezantuara në këto pasqyra financiare paraqesin pranimet dhe pagesat e parasë së gatshme dhe lëvizjen e gjendjes së parasë.

Sipas parimit kontabël të parasë së gatshme, Pranimet (të hyrat) njihen atëherë kur paratë janë transferuar në llogari të Thesarit, janë pranuar në banka komerciale apo janë në pritje për t'u transferuar në llogarinë e Thesarit, dhe paratë e grumbulluara nga zyrtarët e organizatave buxhetore në pritje për t'u transferuar në llogarinë e Thesarit në BQK.

Pagesat (shpenzimet) njihen atëherë kur ato dalin nga Llogaria e Vetme e Thesarit, kurse shpenzimet e parave të imëta dhe avanseve për udhëtime zyrtare, njihen në momentin e mbylljes së llogarisë së parave të imëta dhe arsytimit të shpenzimeve për udhëtim zyrtar.

Menaxhimi i parasë është organizuar në formën e Llogarisë së Vetme të Thesarit. Llogaria e Vetme e Thesarit është sistem llogarishë bankare që shfrytëzohen për mbledhjen e të hyrave dhe realizimin e shpenzimeve, të cilat i menaxhon dhe kontrollon Thesari në Ministrinë e Financave.

Thesari është i autorizuar që të ekzekutoj edhe pagesat e faturave dhe kërkesave për pagesë sipas nenit 39.2 të LMFP-së dhe vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore sipas nenit 40 të LMFP-së. Pagesat e tilla janë bërë nga kategoritë e ndryshme nga fondet të cilat kanë qenë në dispozicion, gjegjësisht të lira për shlyerjen e obligimit konform kërkesave të LMFP-së.

LMFP ka disa kërkesa shtesë për prezantim të pasurive jo financiare dhe detyrimeve në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, në pajtim me Pjesën 2 të SNKSP në bazë të parasë së gatshme.

Pasuritë e prezantuara në aneksin 7 janë bazuar në shënimet e SIMFK, dhe përfshijnë pasuritë në vlerë mbi 1,000 euro në pajtim me Rregulloren Financiare 02/2013. Lista e pasurive jo financiare është paraqitur në vlerën kontabël neto, pas zbatimit të normave të zhvlerësimit sipas kësaj rregulloreje.

Raporti përmban shpalosje të informatave edhe për llogari tjera, të cilat janë paraqitur në anekset:

(8) Pasuritë me vlerë nën 1,000 euro; (9) Stoqet; (10) Të arkëtueshmet; (11 dhe 12) Detyrimet; (15) Numri i të punësuarve jashtë listës së pagave; (17) Numri i të punësuarve me kontrata për shërbime

të veçanta. Të gjitha këto anekse janë konsoliduar nga pasqyrat individuale të organizatave buxhetore.

Transaksionet ndërmjet organizatave buxhetore, të quajtura “Transaksionet ndërdepartamentale” nuk janë konsoliduar në këto pasqyra financiare, me qëllim të ruajtjes së konsistencës së informatave të raportuara me pasqyrat financiare individuale të organizatave buxhetore. Shpenzimet janë kategorizuar sipas klasifikimit ekonomik dhe funksional të Ligjit të Buxhetit, i bazuar në Statistikat Financiare Qeveritare të FMN-së (SFQ) që janë verzion i SFQ i vitit 2014 të bazuara në paranë e gatshme.

Pagesat e bëra nga palët e treta nuk konsiderohen pranime ose pagesa në para të gatshme, por janë përfitime të Qeverisë. Këto pagesa janë prezantuar si shënim i veçantë në aneksin 4.1 në përputhje me SNKSP 2017, efektive nga 1 janari 2019.

Paraja e gatshme përbëhet nga fondet të cilat mbahen në Bankën Qendrore të Kosovës, banka komerciale, si dhe paratë e gatshme në arkat e OB-ve dhe ekuivalentët e parasë së gatshme.

Pagesat e kthyera në BRK nga vitet paraprake në vitin aktual, evidentohen si të hyra të këtij viti.

Valuta raportuese zyrtare në Kosovë është Euro (€), ndërsa shpalosja e borxhit shtetëror, mund të jetë përdorur edhe valuta Të Drejtat Speciale të Tirazhit (DST) në aneksin 18, dhe USD te pagesat e kuotave për anëtarësim në IFN tek aneksi 20.

PFV autorizohen me datën e nënshkrimit të deklaratës nga Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit dhe pas aprovimit në Qeveri.

3.3 Borxhet publike dhe Garancitë shtetërore

Sipas Ligjit për Borxhet Publike 03/L-175, Borxhi i Përgjithshëm përkufizohet si “tërësia e Borxhit Shtetëror dhe Borxhit Komunal”. Borxhi Shtetëror është borxh që merret në emër të Institucioneve Qendrore Qeveritare të cilin Republika e Kosovës është e obliguar ta paguajë, por nuk përfshinë asnjë detyrim të entiteteve të tjera të caktuara qeveritare, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në Komuna, ndërmarrje publike, apo Bankën Qendrore të Kosovës”. Përmes këtij ligji, Qeverisë i mundësohet “për të marrë hua, për të dhënë garanci për hua, për të paguar shpenzimet për marrjen e borxhit dhe për të paguar kryegjënë dhe interesin e borxhit shtetërorë”. Ligji ia delegon Ministrin të Financave autoritetin e vetëm për të marrë borxh shtetëror për qëllime të caktuara (Neni 3 i Ligjit), si dhe i përcakton Thesarit të Kosovës të drejtën për menaxhimin dhe administrimin e borxhit shtetëror. Për më shumë, sipas Ligjit, shuma e papaguar e borxhit të përgjithshëm, në asnjë rast nuk duhet të tejkalojë kuotën e 40% të BPV-së, dhe garancitë shtetërore duhet të trajtohen si borxh shtetëror gjatë llogaritjes së këtij kufizimi. Për të rritur transparencën e menaxhimit dhe përcaktimin e përgjegjësive menaxhuese, Ministria e Financave ka hartuar Akte nënligjore dhe Procedura.

Borxhet e përgjithshme shtetërore apo publike përbëhen nga Borxhet e Brendshme (emetimi i Instrumenteve financiare) dhe Borxhet Ndërkombëtare (Kreditorët e jashtëm). “Borxhi i Brendshëm përkufizohet si Borxh Shtetëror i cili i nënshtrohet ligjeve të Republikës së Kosovës, ndërsa Borxhi Ndërkombëtar si Borxh Shtetëror i nënshtrohet marrëveshjeve me qeveritë e huaja, agjencitë qeveritare, organizatat ndërkombëtare financiare apo organizata dhe kompani tjera të huaja në

bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare, traktateve, konventave apo marrëveshjeve tjera të ngjashme të cilat i nënshtrohen ligjeve të një juridiksioni legal, përveç atij të Republikës së Kosovës”.

Objektiva kryesore e Qeverisë së Kosovës për menaxhimin e borxhit shtetëror është që të sigurojë financimin e deficitit të buxhetit me kosto sa më të ulët të mundshme, gjithmonë duke pasur parasysh nivelin e pranueshëm të ekspozimit ndaj risqeve financiare.

Përshkrimi i procesit

- Nga Qeveria e Republikës së Kosovës hartohen Prioritetet nacionale të cilat kanë të bëjnë me sektorë të ndryshëm, ndër to edhe të zhvillimit ekonomik. Në këtë kontekst, Zyra për planifikim strategjik pranë ZKM, përmes dokumentit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, identifikon çështje të reja dhe të rëndësishme të politikave strategjike për analizë. Më tutje, bashkëpunon me Ministrinë e Financave për rishikimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), si dhe përgatitjen e udhëzimeve më të hollësishme për përgatitjen e strategjive sektoriale të KASH;
- Në Ministrinë e Financave, Divizioni për Menaxhimin e Borxhit (DMB) vepron në kuadër të Thesarit. Ky divizion koordinohet me Departamentin për Politika Makroekonomike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar, Departamentin e Buxhetit në Ministrinë e Financave si dhe Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, si agjent fiskal i Qeverisë. DMB është përgjegjës për funksionet e menaxhimit të riskut të huamarrjes shtetërore, negociimit të kushteve financiare, menaxhimit të strategjisë së huamarrjes, raportimit, regjistrimit dhe shërbimit të borxheve shtetërore. Rrjedhimisht ky departament, harton pjesën makroekonomike (niveli i borxhit shtetëror, zhvillimet dhe perspektiva për vitet në vijim) të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (ku përfshihet klauzola e investimeve) të përfshira në Librin e Buxhetit dhe Programit të Borxhit Publik;
- Pas aprovimit të projekteve që do të financohen përmes huamarrjes dhe projekteve kapitale (nga klauzola e Investimeve) në Ligjin e Buxhetit, Ministria e Financave inicion procesin e marrëveshjeve me Kreditorët. Me aktin e nënshkrimit të marrëveshjeve përmes Qeverisë, projektet dërgohen për ratifikim në Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- Pas ratifikimit të marrëveshjeve dhe plotësimit të kushtit të efektivitetit, bëhet disbursimi i mjeteve nga kreditorët; dhe
- Procesit të disbursimit i paraprinë alokimi i mjeteve nga Thesari sipas kërkesës së organizatave buxhetore zbatuese të projekteve.

Në vazhdim do të paraqitet një analizë për trendin e borxheve publike në tri vitet e fundit.

Tabela 14 - Borxhi i brendshëm dhe i jashtëm shtetëror për vitet 2017-2019

(në euro)

Përshkrimi	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017
Borxhi Ndërkombëtar	409,100,000	416,150,000	422,150,000
Borxhi i Brendshëm	791,942,000	676,620,000	574,270,000
Borxhi i Përgjithshëm	1,201,050,000	1,092,770,000	996,420,000
Garancitë Shtetërore	42,680,000	44,000,000	44,000,000
Borxhi i përgjithshëm + Garancitë	1,243,720,000	1,136,770,000	1,040,420,000
Borxhi i Përgjithshëm (% e BPV)	17,46%	16,90%	16,63%
BPV nga ASK	7,123,100,000	6,725,910,000	6,257,000,000

Në fund të vitit 2019, Borxhi i Përgjithshëm ka arritur në 1,201,050,000€, që krahasuar me vitin paraprak shënoi një rritje prej 108 milionësh apo rreth 10%. Në këtë vlerë nuk janë të përfshira garancitë shtetërore prej 42,680,000€. Borxhi publik në raport me Bruto Produktin Vendor për vitin 2019 ishte 17%, që është brenda kufizimit prej 40% siç përcaktohet në Ligjin për Borxhin Publik.

Sipas tabelës më sipër, Borxhi Ndërkombëtar në fund të vitit 2019 paraqet rreth 34% të Borxhit të përgjithshëm Shtetëror apo 6% e BPV-së. Pjesa më e madhe apo rreth 66% e Borxhit Ndërkombëtar është ndaj BNRZh-së dhe FMN-së.

Borxhi i brendshëm është krijuar përmes shitjes së letrave me vlerë nga ana e Qeverisë në formë të bonove të Thesarit (deri 1 vit) dhe obligacioneve (2 deri 10 vite). Në vitin 2019, Borxhi i Brendshëm ishte 791,942,000€, që paraqet rreth 66% të Borxhit total Shtetëror apo rreth 11% e BPV. Krahasuar me vitin 2018, rritja e borxhit të brendshëm (emetimi i letrave me vlerë) ishte për 115,320,000€, apo rreth 17%. Gjatë vitit 2019, janë ratifikuar pesë kredi/marrëveshje financiare të nënshkruara gjatë vitit 2018, katër prej tyre në mes Qeverisë së Kosovës si dhe kreditorit Uni Credit, dhe një në mes Qeverisë së Kosovës si dhe kreditorit RBI-Austria:

1. Projekti i Sistemit për largimin e ujërave të zeza për Komunën e Podujevës 5,349,000€;
2. Projekti për ndërtimin e Sistemit të ujësjellësit për Komunën e Graçanicës 5,115,108€;
3. Projekti për ndërtimin e Sistemit të ujësjellësit për Komunën e Istogut 5,094,247€;
4. Projekti për ndërtimin e Sistemit të kanalizimit për Komunën e Shtimes 2,385,000€; dhe
5. Projekti për ndërtimin e Sistemit të Furnizimit me ujë të pijshëm për Komunën e Ferizajt 5,125,000€.

Gjithashtu, gjatë vitit 2019 me qëllim të financimit të projekteve, janë kontraktuar tre marrëveshje të reja financiare me Bankën Botërore (ANZh) dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), por që nuk janë ratifikuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës:

1. Marrëveshja financiare për kredi me ANZH për financimin e Projektit për forcimin e sektorit financiar në vlerë 3,000,000€;
2. Marrëveshja financiare për kredi me ANZh, për financimin e Projektit për Kadastër të pa-tundshmërisë dhe infrastrukturës gjeohapësinore në vlerë 2,000,000€; dhe
3. Marrëveshja financiare për kredi me BERZh, për financimin e Projektit për trajtimin e ujërave të zeza në Komunitat Ferizaj, Gjilan dhe Mitrovicë në vlerë 5,000,000€.

Tabela në vazhdim paraqet listën e kreditorëve të jashtëm kryesor, të cilët kanë financuar huamarrjet.

Tabela 15- Borxhi i jashtëm sipas kreditorëve dhe borxhi i zotuar i padisbursuar (në €)

Kreditori	Borxhi i ratifikuar	Borxhi i tërhequr	Borxhi i pa tërhequr	Borxhi i pakthyer ⁵	Kthimi i borxhit
	(A)	(B)	(C=A-B)	(D=B-E)	(E)
BNRZh	381,210,000	381,210,000	0	135,640,000	245,570,000
FMN	287,380,000	287,380,000	0	132,600,000	154,530,000
ANZH	167,680,000	61,310,000	106,370,000	60,530,000	780,000
BERZH	139,900,000	4,300,000	135,600,000	4,110,000	190,000
BEI	122,000,000	7,000,000	115,000,000	7,000,000	0
KfW	71,000,000	68,430,000	2,570,000	42,790,000	25,640,000
NATIXIS Franca	66,000,000	0	66,000,000	0	0
FOZHN, BIZH, FSZH	47,500,000	13,050,000	34,450,000	11,890,000	1,160,000
UniCredit	24,980,000	13,430,000	11,550,000	13,260,000	180,000
RBKO-Austria	5,130,000	1,030,000	4,100,000	1,030,000	0
Borxhi Ndërkombëtar	1,312,780,000	837,140,000	475,640,000	409,090,000	428,050,000

Borxhi i jashtëm merret përmes marrëveshjeve ndërkombëtare nga Institucionet e jashtme financiare. Renditja e kreditorëve në tabelën sipër, është bërë sipas madhësisë së vlerës së borxhit të ratifikuar.

Nga borxhi i jashtëm i ratifikuar nga viti 2009 deri më 2019 në vlerë 1,312,780,000€, Qeveria ka tërhequr 837,140,000€. Ndërsa, kthimi i borxhit ishte prej 428,050,000€, ku pjesa kryesore e kthimit është bërë për BNRZh (Kredinë e konsoliduar C nga ish Jugosllavia) dhe FMN me rreth 93%. Vlera e pa tërhequr nga marrëveshjet e kredive të ratifikuara është 475,640,000€, apo 36% e borxhit të ratifikuar, derisa në vitin e kaluar ishte 393 milionë apo 33%.


Shërbimet e borxhit të përgjithshëm

Shërbimet e borxhit të përgjithshëm kanë të bëjnë me pagesat e kryegjësë, interesin dhe tarifatat tjera të cilat janë të përcaktuara në marrëveshjet mes Qeverisë dhe kreditorëve, për borxhet e brendshme dhe ato ndërkombëtare.

Tabela 16 - Shërbimet e borxhit të përgjithshëm për vitin 2019 (në €)

Kthimi i borxheve	Kryegjësja	Interesi i paguar	Tarifatat zotuese	Tarifatat tjera	Gjithsej pagesat
Borxhi i jashtëm	50,280,000	11,560,000	540,000	200,000	62,580,000
Borxhi i brendshëm	0	11,150,000	0	0	11,150,000
Totali:	50,280,000	22,710,000	540,000	200,000	73,730,000

Shërbimet e borxhit të përgjithshëm për vitin 2019 (në €)



Në vitin 2019, shërbimet e borxhit të jashtëm dhe të brendshëm ishin 73,730,000 milion euro. Tabela e mësipërme prezanton të dhëna për kthimin e borxheve të brendshme dhe të jashtme, duke përfshirë kthimin e kryegjësë, shpenzimet e interesit, tarifatat zotuese dhe tarifatat tjera si pjesë e borxhit.

Tarifatat zotuese si në tabelë në vlerë prej 540,000€, kanë të bëjnë me kreditë e ratifikuara që nga viti 2009 deri më 2019. Në angazhimet financiare ndërkombëtare, tarifa e zotimit paraqet një tarifë të cilën huadhënësi e kërkon nga huamarrësi si kompensim për ndarjen/zotimin e mjeteve që huazohen. Tarifa e zotimit llogaritet në shumën e padisbursuar të kredisë. Krahasuar me vitin e kaluar, ka një rritje të tarifës zotuese prej 250,000€ dhe tarifave tjera për 200,000€. Vlera e kësaj tarife është mjaftë e ndjeshme për shkakun që nuk kanë kundërvlerë për ndonjë shërbim të kryer apo financim të projekteve.

Garancitë shtetërore

Garancitë shtetërore, paraqesin detyrime të mundshme dhe ato bëhen borxhe faktike vetëm në rastet kur subjekti publik, dështon të paguaj obligimet kontraktuese të garantuara. Në këto raste, Qeveria duhet të paguaj obligimet për garancionin e dhënë. Nga tabela shihet se garancionet bankare janë në vlerë prej 42,680,000€. Varësisht prej kthimit të kredive, bëhet edhe zvogëlimi i garancionit Shtetëror.

Konkluzioni

Menaxhimi i financimit të projekteve nga huamarrja është karakterizuar me një performancë të ulët të efektivitetit dhe efikasitetit. Aranzhimet për huamarrje kanë ndodhur para se të krijohen kushtet për shfrytëzimin e këtyre fondeve. Lidhjet ndërmjet dokumenteve strategjike, KASH-it dhe buxhetit vjetor, janë mjaft sfiduese në aspekt të një planifikimi të arritshëm buxhetor. Si pasojë, vlerësimet e rrezikut për çështje më të dukshme si: vonesat në zbatimin e projekteve komplekse, zbrazëtitrat në strategji dhe planifikimin e kostos (interesin bankar dhe tarifatat tjera), nuk janë trajtuar me vëmendjen e duhur nga ana e Qeverisë.

Bazuar në raportimet e rregullta tremujore të OB-ve në Thesar/MF, vështirësitë që hasen gjatë zbatimit të projekteve janë të natyrave të ndryshme duke filluar nga vonesat në ratifikim, përmbushja e kushteve të efektivitetit të përcaktuara nga kreditori, harmonizimi i procedurave vendore me procedurat e kreditorit, vonesat në shpronësim e deri te mungesa e stafit të kualifikuar në njësitë e zbatimit dhe meanxhimit të këtyre projekteve.

Si pasojë, vlera e pa tërhequr e kredive të ratifikuara deri në fund të vitit 2019 ishte në nivel të ultë dhe fondet e huamarrjeve të mos shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe efektive. Nga fondet në dispozicion, mbi 475 milionë euro kanë mbetur fonde të pa angazhuara. Në anën tjetër, kjo ka reflektuar edhe me shpenzime tjera shtesë duke llogaritur tarifën e zotimit dhe tarifën tjera që arrijnë vlerën prej 740,000€ për borxhet e padisbursuara dhe të ngecjeve në dinamikën kohore të zbatimit të projekteve. Pra, borxhi i pa-disbursuar/pa-tërhequr nga marrëveshjet ndërkombëtare, pritet të tërhiqet varësisht nga dinamika e zbatimit të projekteve nga ana e organizatave zbatuese të projekteve.

Ministria e financave në baza të rregullta ka raportuar në Qeveri mbi dinamikën e ekzekutimit të projekteve të huamarrjes dhe ngecjet, megjithatë, rezultatet e auditimit (të dhënat e mësipërme), tregojnë se situata mbetet e pa ndryshueshme, madje edhe më e keqe se në vitin paraprak.

Rekomandimi për Qeverinë

Qeveria duhet që t'i shqyrtoj raportet periodike për borxhet publike të Ministrisë së Financave, dhe të analizojë ngecjet e identifikuara. Gjithshtu, në baza periodike të analizoj kushtet dhe kriteret për përzgjedhjen e projekteve për financim, buxhetim dhe monitorimin e shfrytëzimit të fondeve të huamarrjes, si dhe të shqyrtoj vonesat eventuale në tërheqjen e këtyre fondeve.

Rekomandimet për Ministrinë e Financave

- Ministria e Financave, duhet të vazhdoj me veprimet e ndërmarra në adresimin e projekteve që financohen nga huamarrja dhe t'i paraqes dy herë në vit Qeverisë për informim dhe shqyrtim raport të konsoliduar të progresit të projekteve, duke i identifikuar sfidat përkatëse dhe duke propozuar masat për tejkalimin e tyre;
- Të miratojë ligjin e rishikuar të borxhit publik, i cili ka adresuar në masë të konsiderueshme aspektet e trajtuara në këtë raport, që ka të bëjë me hyrjen në borxh dhe një qasje të bazuar në vlerësimin e nevojave nga MF, dhe jo nga organizatat zbatuese me kreditorët; dhe
- Para aprovimit të buxhetit (projekteve kapitale dhe jo vetëm), të monitoroj zbatimin e kriterëve përzgjedhëse si dhe prioritetëve të projekteve. Miratimi i projekteve duhet të bëhet vetëm nëse për to janë kryer të gjitha përgatitjet dhe ekziston siguri e mjaftueshme dhe e dokumentuar se realizimi i projekteve do të bëhet në kohën e duhur.

4 Pasuritë dhe stoqet

Rregullorja MF nr. 02/2013 mbi Menaxhimin e Pasurive në Organizata Buxhetore i obligon të gjitha organizatat të mbajnë regjistrat e pasurisë dhe vazhdimisht të bëjnë ripërtëritjen ose azhurnimin e tyre, varësisht nga blerjet/përvetësimet e reja apo shqyrtimit sistematik të gjendjes së tyre të përdorimit.

Pasuritë e organizatave buxhetore, si tërësi ndahen në:

- Pasuri kapitale që kanë afat të përdorimit më të gjatë se një vit dhe që kanë vlerë financiare mbi 1,000€;
- Pasuritë jo kapitale që kanë afat të përdorimit më shumë se një vit, por që kanë vlerë financiare më pak se 1,000€; dhe
- Stoqet ose pajisje rezervë dhe material zyre.

Menaxhimi i pasurive bëhet përmes dy sistemeve të centralizuara: Regjistrin kontabël të SIMFK, si sistem i integruar në kuadër të MF-së, ku evidentohen, mirëmbahen, vlerësohen dhe raportohen pasuritë që kanë vlerë mbi 1,000€, si dhe aplikacionit "E - pasuria" që është një sistem i integruar i menaxhimit të pasurisë në kuadër të MAP-it, ku të gjitha institucionet publike duhet të evidentojnë dhe raportojnë për pasuritë e tyre me vlera nën 1,000€.

Organizatave buxhetore kanë raportuar vlera të ndryshme të pasurive në PFV-të individuale, shifra të cilat më pas janë konsoliduar në Pasqyrat e MF-it. Me rastin e auditimit të pasqyrave individuale, janë vërejtur mospërputhje në mes shifrave të raportuara dhe vlerave të audituara.

Gjetjet kryesore lidhur me raportimin dhe kontrollin e pasurive janë si vijim:

Pasuritë e institucioneve qendrore

Nga auditimet individuale, ka rezultuar se disa organizata nuk i kanë përfshirë në regjistrat e tyre një pjesë të pasurisë, dhe si rezultat i kësaj, vlera neto e prezantuar në RFV/ BRK ishte nënvlerësuar për 3,236,102€, për pasuritë mbi 1000, si dhe 857,194€ për pasuritë nën 1000€.

Tabela në vazhdim paraqet diferencat në mes të dhënave të prezantuara në RFV-BRK dhe auditimeve individuale.

Tabela 17 - Gjendja e pasurive në institucionet qendrore


(në euro)

Pasuritë më 31.12.2019	Sipas RFV të BRK	Sipas auditimit	Nënvlerësimi
Pasuritë kapitale (mbi 1,000€)	2,827,689,246	2,830,925,348	3,236,102
Pasuritë jo kapitale (nën 1,000€)	25,700,439	26,557,633	857,194

Gjendja e pasurive në institucionet qendrore (në euro)

Pasuritë kapitale (mbi 1,000€)

Pasuritë jo kapitale (nën 1,000€)



Gabimet e identifikuar apo mospërputhjet e gjendjes së pasurive të raportuara më pak apo më shumë, janë identifikuar në 21 organizata të nivelit qendror, ku bëjnë pjesë: dhjetë (10 ministri, Zyra e Kryeministrit, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar dhe nëntë (9) Agjenci të Pavarura.

Dobësi tjera në kontrolle dhe menaxhim të pasurive të cilat më së shpeshti janë hasur gjatë auditimit tek Institucionet Qendrore janë:

- Në gjashtë (6) institucione nuk është kryer harmonizimi i të dhënave në mes raportit vjetor të inventarizimit dhe regjistrit të përgjithshëm të pasurisë;
- Në pesë (5) institucione nuk kishte funksionuar sistemi e-pasuria; dhe
- Në tetë (8) institucione nuk është kryer inventarizimi vjetor apo procesi kishte përfunduar me vonesa në inventarizimin e pasurisë, respektivisht raportet e inventarizimit ishin dorëzuar pas hartimit të pasqyrave financiare.

Pasuritë e komunave

Te niveli komunal janë konstatuar dobësi të theksuara sa i përket evidentimit dhe raportimit të pasurive. Pasuria kapitale sipas vlerës neto e prezantuar në RFV është nënvlerësuar për 92,955,551€, ndërsa pasuria jo kapitale është mbivlerësuar për 742,882€.

Tabela në vazhdim paraqet diferencat në mes të dhënave të prezantuara në RVF-BRK dhe auditimeve individuale.

Tabela 18 - Pasuritë e komunave


(në euro)

Pasuritë më 31.12.2019	Sipas RFV të BRK	Sipas auditimit	Mbivlerësimi/Nënvlerësimi
Pasuritë kapitale (mbi 1,000€)	5,925,862,673	6,018,818,224	92,955,551
Pasuritë jo kapitale (nën 1,000€)	15,035,080	14,292,198	(742,882)

Pasuritë e komunave (në euro)

Pasuritë kapitale (mbi 1,000€)

Pasuritë jo kapitale (nën 1,000€)



Mangësitë dhe gabimet në mbajtjen dhe regjistrimin e pasurive janë identifikuar në shumicën e komunave. Nga gjithsej 38 komuna, 26 prej tyre kanë mbivlerësuar ose nënvlerësuar pasuritë e prezantuara në RRV-BRK.

Dobësi tjera në kontrolle dhe menaxhim të cilat më së shpeshti janë hasur gjatë auditimit të pasurive tek komunat janë:

Komuna e Zubin Potokut nuk ka raportuar pasuritë me vlerë mbi 1,000€. Komunat e Ferizajt, Istogut dhe Zveçanit nuk kanë raportuar pasuritë nën 1.000€, ndërsa komunat e Novobërdës, Zubin Potokut dhe Kllokotit kanë raportuar pasurinë nën 1,000€ me vlerën zero.

- Në nëntë (9) komuna, nuk ishte kryer harmonizimi i të dhënave në mes regjistrimit të përgjithshëm të pasurisë dhe raportit të inventarizimit;
- Në 18 komuna nuk ka funksionuar sistemi e-pasuria;
- Në 12 komuna, mungojnë politikat dhe procedurat e brendshme për menaxhimin e pasurisë;
- Në shtatë (7) komuna ka munguar inventarizimi i pasurisë ose është bërë inventarizim i pjesshëm;
- Në nëntë (9) komuna, nuk ishte aplikuar moduli i zhvlerësimit të pasurive; dhe
- Në shtatë (7) komuna, nuk ishin themeluar komisionet për inventarizimin dhe vlerësimin e pasurisë.

Po ashtu pesë (5) organizata të nivelit qendror dhe gjashtë (6) komuna, kanë raportuar pasurinë në RRV-BRK me vlerën zero ose nuk kanë raportuar fare. Kjo paraqet paqartësi lidhur me regjistrimin dhe përditësimet e të dhënave për pasuritë.

Stoqet për Institucionet Qendrore dhe Komunitat 2019

Stoqet ose pajisjet rezervë dhe materialet për zyre të institucionet qendrore sipas RRV/BRK janë 23,319,403€, ndërsa sipas auditimeve individuale 23,314,894€, me një mbivlerësim prej 4,509€.

Ndërsa, stoqet në komuna sipas RFV/BRK-së janë 1,588,046€, dhe vlerë e njëjtë është konfirmuar edhe gjatë auditimeve.

Vlen të theksohet se në fund të vitit 2019, në 12 organizata buxhetore janë raportuar stoqet me vlerë zero, prej tyre dy (2) institucione të nivelit qendror dhe dhjetë (10) komuna.

Konkluzioni i auditimit

Shpalosjet mbi pasuritë jo financiare dhe kontrollet mbi menaxhimin e tyre në vitin 2019 nuk kanë ofruar siguri të mjaftueshme se organizatat buxhetore kanë kontrolle dhe monitorime të plota mbi pasuritë dhe menaxhimin e tyre në mënyrë efikase. Përveç kësaj, të dhënat e pasurive fikse në sistemin e menaxhimit të pasurive SIMFK dhe E-pasuria, janë të pasakta dhe jo të plota në disa raste. Praktika të njëjta të menaxhimit të pasurive janë duke vazhduar edhe më tutje si te institucionet e nivelit qendror po ashtu edhe ato lokal, edhe pse vite më radhë janë dhënë rekomandime për përmirësime në këtë fushë.

Rekomandimet për Qeverinë

Pjesërisht përsërisim rekomandimet e vitit të kaluar se Qeveria duhet të luaj një rol proaktiv në adresimin e të gjitha çështjeve lidhur me menaxhimin e pasurive dhe të ndërtoj mekanizma llogaridhënës që:

- Të gjitha organizatat t'i përmbushin detyrimet ligjore, duke i regjistruar dhe raportuar saktë të gjitha pasuritë në posedim; dhe
- Të merr masa për funksionalizimin e plotë të sistemit e-pasuria, si një problem i trashëguar për vite me radhë. Në të kundërtën, të shfuqizoj pjesën e rregullores e cila i obligon OB-të që ta përdorin këtë sistem, dhe të dhënat të mbahen veçmas në programe tjera të OB-ve.

Rekomandimet për Ministrinë e Financave

- Thesari përmes trajnimeve të fund vitit lidhur me hartimin e Pasqyrave financiare, të fuqizoj kërkesën që të gjitha organizatat buxhetore t'i themelojnë me kohë komisionet e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive, dhe rezultatet e inventarizimit t'i reflektojnë në pasqyrat financiare të fundvitit; dhe
- Me rastin e pranimit të PFV-ve nga organizatat buxhetore, të vendos kontrolle formale në veçanti lidhur me raportimin e stoqeve me gjendjen zero, dhe në rastet e tilla të kërkoj sqarime, ngase në raportet e tri viteve të fundit ka diferenca të theksuara dhe raportim të mangët.

5 Llogaritë e arkëtueshme

Gjendja e llogarive të arkëtueshme (Ll/A) raportohet kryesisht në mënyrë manuale dhe pastaj të dhënat konsolidohen, si për hartimin e pasqyrave financiare individuale të organizatave buxhetore, ashtu edhe për ato të konsoliduara. Përderisa përbëjnë një zë tejet të rëndësishëm të pasurive afatshkurtëra, kërkojnë vëmendje të shtuar, si për qëllime të auditimit ashtu edhe përgjatë procesit të tërësishëm të buxhetit, aq më tepër kur një qasje e tillë e mbledhjes së informatave kontabël, lë hapësirë për gabime të mundshme në raportimin apo shpalosjen e tyre. Prandaj, gabimet e identifikuar gjatë auditimeve të fundit kanë qenë të theksuara.

Për vitin 2019, gjithsej vlera e deklaruar në Raportin Vjetor Financiar 2019, për nivelin qendror dhe lokal arrinë në 634,643,815€, ndërsa sipas auditimit vlera e llogarive të arkëtueshme është 637,148,819€. Pra, ekziston një diferencë prej 2,505,004€ (përfshirë nivelin qendror dhe lokal). Madje, dallime ka edhe kur krahasojmë shënimet e pasqyrave financiare individuale me ato të konsoliduara. Ll/A sipas pasqyrave individuale ishin mbivlerësuar për 15,816€.

Kjo mos shpalosje e saktë është si pasojë e mungesës së një strukture formale për raportimin, mbikëqyrjen dhe konsolidimin e të dhënave si dhe për shkak të gabimeve pothuajse teknike gjatë bartjes së shënimeve nga PF në RVF, me rastin e përgatitjes së pasqyrave të konsoliduara.


Në vitin 2019, llogaritë e arkëtueshme bazuar në RVF ishin rritur për 23,061,694€ apo 3.77%. Në vitin 2019 saldo e këtyre llogarive ishte 634,643,815€, ndërsa në fund të vitit 2018 ishte 611,582,121€. Ll/A normalisht kanë një rritje nga viti në vit ngase

Tabela 19 - Krahasimi i llogarive të arkëtueshme në tri vitet e fundit

(në euro)

Llogaritë e arkëtueshme	Sipas auditimit 2019	Sipas PF të OB 2019	Sipas RVF 2019	Sipas RVF 2018	Sipas RVF 2017	Krahasimi 2019-2018
Niveli qendror	451,927,926	452,231,507	452,231,507	460,029,786	405,315,423	(1.7)%
Niveli lokal	185,220,893	182,428,123	182,412,308	151,552,335	143,624,136	20.3%
Gjithsej	637,148,819	634,659,631	634,643,815	611,582,121	548,939,559	3.77%

Krahasimi i llogarive të arkëtueshme në tri vitet e fundit (në euro)



Llogaritë e arkëtueshme të nivelit qendror

Vlera e listuar në RVF 2019 për nivelin qendror është 452,231,815€, e cila gjatë auditimit ka rezultuar të jetë e mbivlerësuar për 303,581€, meqë kjo shifër sipas auditimit do duhej të paraqitet në vlerë 451,927,926€. Gabimet ishin kryesisht:

- Ll/A te Ministria e Shëndetësisë ishin mbivlerësuar për 189,481€. Shkaku i mbivlerësimit ishte se disa departamente kishin bërë gabime gjatë raportimit; dhe
- Ll/A te Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ishin mbivlerësuar për 114,100€. Shkaku i mbivlerësimit të llogarive ishte se vlera prej 114,100€ e të hyrave të realizuara ishte përfshirë gabimisht në kuadër të gjendjes së llogarive.

Rreth 89% të llogarive të arkëtueshme të nivelit qendror e përbëjnë të arkëtueshmet nga Dogana dhe ATK, respektivisht nga Ministria e Financave (shifra e audituar 404,009,690€). Krahasuar me vitin paraprak, Ll/A te niveli qendror karakterizohen me një trend pozitiv në ulje për 1.7%. Ll/A e vitit 2019 janë 452,231,815€, ndërsa ato të vitit 2018 ishin 460,029,786€.

Llogaritë e arkëtueshme të nivelit lokal

Sipas raportit të konsoliduar financiar (RVF), bilanci i të arkëtueshmeve në 34 komuna arrin në 182,412,308€, ndërsa sipas auditimit 185,220,893€. Pra, auditimi ka nxjerrë në pah një nënvlerësim prej 2,808,585€ te niveli lokal. Nēnvlerësimi i Ll/A ishte 3,157,387€ dhe mbivlerësimi për 348,800€, që në fakt efekti total për nivelin lokal rezulton në nënvlerësim për 2,808,585€. Kjo diferencë prej rreth tre milionë eurove, ka ardhur për shkak të pakujdesisë gjatë mbajtjes, raportimit të të dhënave, si dhe për shkak të harmonizimit në mënyrë manuale të të dhënave. Kjo ka ndikuar që procesi i raportimit dhe monitorimit për Ll/A nga drejtoritë përkatëse komunale të përcillet me një cilësi të dobët.

Ndërsa në vijim shpalosen informata për komunat tek të cilat janë vërejtur nënvlerësimet:

- **Komuna e Prishtinës** - 2,621,385€. Shkaku i këtij nënvlerësimi ishte se komuna nuk ka harmonizuar saldot përfundimtare të kartelës së llogarive të arkëtueshme për tatimin në pronë me saldote fillestare, mos konsolidimit të llogarive nga lejet e ndërtimit si dhe mos shpalosja e tyre për taksat (tarifa) për rregullimin e infrastrukturës. Ndërsa arsytet e mos arkëtimit ishin mos veprimi i mekanizmave adekuat nga ana e komunës për t'i arkëtuar të hyrat;
- **Komuna e Mitrovicës** - 338,649€. Shkaku i mos raportimit të saktë ishte se komuna nuk kishte përfshirë edhe saldote e llogarive për vitin paraprak;
- **Komuna e Prizrenit** - 117,220€. Shkaku i nënvlerësimit ishte se komuna e Prizrenit gjatë vitit 2019 kishte bërë kërkesë në Ministrinë e Financave që të lirohen objektet publike komunale nga tatimi në pronë. MF kishte aprovuar kërkesën e komunës së Prizrenit, por faturimi për ato objekte ishte bërë gjatë tre mujorit të parë të vitit 2019. Ndërsa sipas auditimit kjo vlerë është dashtë të përfshihet në gjendjen e llogarisë përfundimtare. Ndërsa, shkaku i mos arkëtimit ishte mungesa e mekanizmave adekuat të arkëtimit;
- **Komuna e Kaçanikut** - 45,966€. Shkaku i nënvlerësimit ishte mungesa e evidencës së plotë për shumën e llogarive;
- **Komuna e Parteshit** - 18,350€. Nuk ka ndonjë shpjegim konkret në pyetësorët e auditimit lidhur me këtë diferencë; dhe

- **Komuna e Deçanit** - 15,979€. Nuk ka ndonjë shpjegim konkret në pyetësorët e auditimit lidhur me këtë diferencë.

Ndërsa në vijim i shpalosim komunat që kanë mbivlerësuar gjendjen e këtyre llogarive:

- **Komuna e Klllokotit** - 268,250€. Nuk ka ndonjë shpjegim konkret në pyetësorët e auditimit lidhur me këtë diferencë;
- **Komuna e Ferizajt** - 28,944€. Shkaku i kësaj difference ishte mungesa e një data baze si dhe mungesa e komunikimit formal në mes departamenteve; dhe
- **Komuna e Graçanicës** - 51,606€. Shkaku i kësaj difference është mos harmonizimi i saldosh përfundimtare.

Krahasuar me vitin paraprak, këto llogari kanë pasur një trend në rritje për 20.36%. Gjendja e vitit 2019 ishte 182,412,308€, ndërsa e vitit 2018 ishte 151,552,335€.

Në llogari të arkëtueshme të nivelit lokal përfshihen të arkëtueshmet nga tatimi në pronë, taksat në biznes, taksat për shërbimet e mbeturinave, qiratë dhe tjera. Kjo kategori dominohet nga ajo e tatimit në pronë në të cilat përfshihen ngarkesat aktuale si dhe kamatat e dënimit për mos kryerje të obligimeve të mëhershme.

Fakti që shumica e llogarive të arkëtueshme te niveli qendror ishte më e ultë në raport me vitin e kaluar, është një tregues pozitiv, ndërsa te niveli lokal gjendja është përkeqësuar edhe më shumë pasi që në vitin 2019 ishin rritur për 30 milionë. Po ashtu, dobësi të theksuara janë vërejtur lidhur me procesin e raportimit dhe konsolidimit, sidomos te niveli lokal.

Rekomandimi për Qeverinë, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Pushtetit Lokal

Në koordinim me komunat dhe organizatat tjera që krijojnë të hyra, duhet të analizojnë në hollësi strukturën e këtyre llogarive, vjetërsinë si dhe gjasat për t'i inkasuar këto borxhe të trashëguara për vite me radhë. Gjithashtu, nga OB-të duhet të bëhet një vlerësim se cilat nga këto borxhe përmbushin kriteret e borxheve të këqia dhe të njëjtat të shlyhen nga llogaritë aktive. Qeveria duhet të shqyrtoj edhe masat tjera stimuluese, duke mos përjashtuar edhe masat ligjore për inkasimin e tyre.

6 Detyrimet e papaguara dhe kontingjente

Detyrimet e papaguara paraqesin faturat e pranuar për punët/shërbimet e përfunduara nga operatorët ekonomik por të cilat nuk janë paguar. Për shkak të përdorimit të kontabilitetit në para të gatshme, gjendja e detyrimeve të papaguara vetëm mund të shpaloset në pasqyrat financiare. Rrjedhimisht, ato përpunohen në mënyrë manuale nga organizatat buxhetore dhe raportohen në baza mujore në MF, për konsolidim të mëtejshëm. Ligji i buxhetit dhe rregullativa sekondare për shpenzimin e parasë publike, kufizon hyrjen e OB-ve në detyrime, meqë obligohen që porosinë e mallit (urdhërblerjen) ta bëjnë vetëm kur ka mjete në dizpozicion, por një gjë e tillë nuk respektohet çdo herë. Ky fakt ka sjellur një trend rritës të detyrimeve nga viti në vit, si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror.

Detyrimet totale të papaguara sipas auditimit janë 310,565,520€, ndërsa në raportin e konsoliduar financiar, detyrimet totale të papaguara janë paraqitur në shumën 360,550,906€, vlerë kjo që sipas auditimit është e mbivlerësuar për 49,416,950€. Krahasuar me vitin paraprak, detyrimet janë rritur 39%.

Tabela 20 - Detyrimet e papaguara në tri vitet e fundit

(në euro)

Detyrimet e papaguara	Sipas auditimit 2019	Sipas PF të organizatave buxhetore	Sipas RVF 2019	Sipas RVF 2018	Sipas RVF 2017	Krahasimi 2019-2018
Niveli qendror	287,785,169	319,127,612	337,202,119	226,643,000	170,334,000	49 %
Niveli lokal	22,780,352	23,352,896	23,348,787	32,149,000	29,077,000	(27%)
Gjithsej	310,565,520	342,480,507	360,550,906	258,792,000	199,411,000	39 %

Detyrimet e papaguara të nivelit qendror

Vlera totale e detyrimeve të papaguara të nivelit qendror sipas RVF raportohet 337,202,119€, e që duhet të paraqitet në vlerë 287,785,169€. Si rezultat i kësaj, obligimet janë mbivlerësuar për 49,416,950€. Kjo ka ndodhur për shkak të cilësisë së dobët në mbledhjen, konsolidimin dhe raportimin e shënimeve në organizata, kryesisht në organizatat si në vijim:

- Pjesa kryesore e gabimit rrjedh nga PF të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), e cila ka paraqitur afërsisht 32,235,037€ obligime më shumë në PVF. Kjo ka ndodhur për shkak të pakujdesisë së zyrtarit financiar i cili ka prezantuar dy herë kërkesat e shpronësimit në raportin e obligimeve dhe rrjedhimisht këto shënime janë bartur edhe në RVF; dhe
- Ministria e Infrastrukturës (MI) kishte nënvlerësuar detyrimet për 894,983€, të cilat i ka deklaruar më pak në PFV.


Detyrimet e papaguara të nivelit lokal

Gabimet në raportim, janë dukshëm të theksuara edhe në nivelin lokal. Këto janë kryesisht nga:

- Komuna e Prizrenit kishte mbivlerësuar detyrimet për 760,579€. Këto detyrime, nuk plotësonin kriteret për cilësimin e tyre si detyrime të papaguara në PFV-të e vitit 2019. Faturat e prezantuara si detyrime, nuk ishin fatura që i takonin vitit 2019;

- Komuna e Kaçanikut e cila i kishte nënvlerësuar për 202,213€, pasi kishte një vendim gjyqësor/përmbartimor të përmbartueshëm. Sipas ZKF, kjo ishte edhe arsyeja e mos shpalesjes;
- Komuna Mitrovica jugore, kishte nënvlerësim për 11,873€ obligim ndaj të punësuarve në fund të vitit 2019;
- Komuna e Malishevës, kishte mbi vlerësuar detyrimet për 21,553€. Kjo ka ndodhur për shkak të mosfunktionimit të kontrolleve të brendshme të komunës, ku fatura e raportuar si e pa paguar në vlerë 15,001€ ishte paguar pjesërisht në vlerë 13,333€ dhe fatura në vlerë 8,790€ ishte paguar pjesërisht në vlerë 8,220€; dhe
- Komuna e Podujevës, kishte nënvlerësim për 44,950€. Gabimi ishte se faturat e rregullta ishin trajtuar si detyrim kontingjent.

Gabimet në raportim në nivelin lokal



Komunat me detyrimet më të larta janë ajo e Gjilanit 9,956,455€ apo 43.7% të gjithë borxheve të nivelit lokal, pastaj Ferizaji 4,421,297€ apo 19.4%, si dhe Mitrovica Jugore me 1,120,411€ apo 4.9%.

Shpalesjet e pasakta të detyrimeve paraqesin një pasqyrë jo të drejtë të pozitës financiare të OB-ve dhe mund të rezultojnë me vendime jo adekuate gjatë procesit të buxhetimit. Kontrollat e dobëta me rastin e harmonizimit të të dhënave rrezikojnë identifikimin, raportimin e saktë dhe të plotë të detyrimeve duke vënë në pikëpyetje edhe kredibilitetin e pasqyrave.

Rekomandimet për Ministrinë e Financave

Ministria e Financave në koordinim me organizatat që kanë detyrime të papaguara, me rastin e ndarjeve buxhetore duhet të kenë prioritet të parë ndarjen e fondeve për pagesën e faturave apo detyrimeve nga vitet e mëhershme në mënyrë që të mënjanohej shpenzimet shtesë të kamatave dhe shpenzimet tjera administrative.

6.1 Detyrimet kontingjente

Në pjesën e detyrimeve, shpalosen edhe detyrimet kontingjente të cilat paraqesin pretendime të ndryshme nga ana e paditësve, që kanë gjasa në të ardhmen të krijojnë detyrime për organizatat, varësisht prej vendimeve të gjykatës të cilat mund të jenë në favor të palëve paditëse. Këto kanë të bëjnë me kompensime për shpronësime, kompensim të borxhit, dëmit material, pagave dhe pretendimeve tjera financiare në lidhje me to.


Në raportin e konsoliduar, detyrimet kontingjente janë gjithsej 192,337,757€, por të nënvlerësuar për 4,319,328€, sepse sipas auditimit detyrimet kontingjente do duhej të paraqiten në vlerë 196,657,085€. Kjo kategori, si e tillë, është subjekt i gabimeve potenciale në shpalosje, sepse shënime lidhur me këto detyrime varen nga bashkëpunimi mes zyrave ligjore të OB-ve, Avokaturës Shtetërore si dhe autoriteteve gjyqësore. Por, diferencat gjithashtu kanë të bëjnë edhe me disa gabime që janë lëshuar nga Ministria e Financave gjatë konsolidimit të shënimeve që i kanë pranuar nga organizatat buxhetore. Është shqetësues trendi pozitiv i këtyre detyrimeve dhe njëkohësisht pakujdesia dhe mos përkushtimi i duhur në raportimin e tyre. Krahasuar me vitin paraprak, detyrimet kontingjente janë më të larta për 25,597,555€ apo rreth 15.3%.

Tabela 21 - Detyrimet kontingjente për periudhën 2017-2019

(në euro)

Detyrimet Kontigjente	Sipas Auditimit 2019	Sipas PF të OB 2019	Sipas RVF 2019	Sipas auditimit 2018	Sipas auditimit 2017	Krahasimi 2018- 2019
Niveli qendror	118,760,146	118,538,931	118,539,654	91,032,124	56,202,386	30.2%
Niveli lokal	77,896,939	73,795,103	73,798,104	75,708,078	32,857,094	(2.52)%
Gjithsej	196,657,085	192,334,034	192,337,757	166,740,202	89,059,480	15.35%

Detyrimet kontingjente gjatë tri viteve të fundit (në euro)



Detyrimet kontingjente të nivelit qendror

Vlera e detyrimeve kontingjente te niveli qendror ishte raportuar në RFV 2019 në shumë prej 118,539,654€, por është e nënvlerësuar për 220,492€. Sipas auditimit, duhet të jetë 118,760,146€. Arsye për këtë është cilësia e dobët në mbledhjen, konsolidimin dhe raportimin e shënimeve nga OB-të tek MF, si dhe kjo e fundit në disa raste kishte bartur gabimisht shënimet. Disa nga gabimet ishin:

- Ministria e Shëndetësisë ka raportuar në PF të saj 1,178,758€ detyrime kontingjente, shumë kjo e paraqitur edhe në RVF, ndërsa sipas auditimit shuma e tyre ishte 1,435,255€. Pra, kishte një nënvlerësim prej 256,497€, për arsye se zyra ligjore kishte raportuar te ZKF vetëm detyrimet e vitit 2019; dhe
- Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës kishte raportuar në RFV shumën prej 3,489,101€, ndërsa sipas auditimit kjo vlerë ka rezultuar prej 3,453,819, me një mbivlerësim prej 35,282€. Shkaku i kësaj difference është se ShSKUK gabimisht kishte prezantuar në RFV shumën 35,282€;

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor prinë e para për nivelin e lartë të detyrimeve kontingjente prej 31,879,568€, pastaj Ministria e Infrastrukturës 22,274,580€ ku përfshihen obligimet e mundshme për shpronësimin e tokave, etj.

Detyrimet kontingjente të nivelit lokal

Detyrimet kontingjente të nivelit lokal janë dukshëm më të vogla në krahasim me ato të nivelit qendror. Paditë ndaj komunave janë të natyrave të ndryshme, duke filluar nga pretendimet për pagat jubilarë e deri tek paditë për shpronësim. Për shkak të qasjes aspak të strukturuar dhe jo formale në harmonizimin e të dhënave, auditimi ka nxjerrë në pah një mori gabimesh. Shuma e raportuar sipas RFV e detyrimeve kontingjente ishte 73,798,104€, ndërsa shuma e detyrimeve kontingjente sipas auditimit është 77,896,939. Pra, ishte një shumë e nënvlerësuar për 4,098,835€.

Në vijim janë shpalosur ndryshimet në raportime:

- Komuna e Prizrenit i kishte nënvlerësuar detyrimet kontingjente për 4,191,424€. Këto nuk ishin raportuar në PFV-të e vitit 2019. Shkaku i kësaj difference është se komuna detyrimet e vitit 2018 në vlerë 3,610,870€ dhe ato të vitit 2017 në vlerë 986,165€ nuk i kishte raportuar;
- Komuna e Gjilanit kishte një mbivlerësim prej 32,246€. Shkaku i kësaj ishte se komuna një obligim të papaguar e kishte prezantuar si detyrim kontingjent;
- Ngjashëm ishte edhe te Komuna e Kllokotitit, ku kishte një mbivlerësim në vlerë prej 24,406€. Shkaku i kësaj ishte se komuna një obligim të papaguar e kishte prezantuar si detyrim kontingjent;
- Komuna e Kamenicës, kishte mbivlerësuar detyrimet kontingjente për 21,600€, për shkak të një gabimi teknik, ku në vend të shumës 2,400€ ishte vendosur shuma 24,000€; dhe
- Komuna e Podujevës, kishte një mbivlerësim në vlerë prej 14,336€. Shkaku i kësaj ishte se komuna një obligim financiar e kishte prezantuar si detyrim kontingjent

Komunat me detyrime kontingjente më të larta janë: Komuna e Prishtinës 25,329,751€, Komuna e Prizrenit 10,696,110€, pastaj Komuna e Gjilanit 10,936,835€, si dhe Komuna e Ferizajt 8,141,889€. Shpalosja e jo saktë e detyrimeve kontingjente në PF dhe në RFV ka ndikuar që detyrimet

kontingjente të mos pasqyrojnë gjendjen e drejtë dhe të plotë. Kjo mund të ndikoj që informacioni i shpalosur për këto detyrime të jetë ç'orientues për palët e interesit.

Rekomandimet për Ministrinë e Financave/Thesarin dhe Ministrinë e Drejtësisë/ Avokaturën Shtetërore

Ministria Financave duhet të udhëzoj dhe kërkoj nga organizatat buxhetore të bëhet një vlerësim i përafërt i detyrimeve kontingjente në mënyrë që shpalosjet në RFV të jenë sa më të plota dhe të merren në konsiderate për analiza të mëtejme për adresimin e këtyre detyrimeve. Aty ku gabimisht nuk janë bartur shënimet në PF, të njëjtat të korrigjohen për vitin e ardhshëm dhe që të sigurohen se evitohen gabimet teknike gjatë raportimit.

7 Pagesat sipas nenit 39.2 të LMFP

Për vitin 2019, Thesari ka ekzekutuar pagesa në vlerë prej 1,539,298³ sipas nenit 39.2. Në raport me vitin 2018, pagesat e ekzekutuara brenda këtij viti janë zvogëluar në vlerë për 7,145,002€ gati për pesë fish më pak. Shkaqet kryesore të pagesës së faturave drejtpërdrejtë nga Thesari janë si rezultat i mos pagesave me kohë të obligimeve nga OB - të për punët dhe shërbimet e përfunduara nga OE, e që kryesisht kanë të bëjnë me: shpenzimet për mirëmbajtje e pastrim, furnizimet për zyrë, derivate, dru e tjera. Hyrja në obligime pa zotim paraprak të mjeteve, neglizhenca si dhe papërgjegjësia e zyrtarëve përgjegjës në pagesën e faturave me kohë, janë disa prej shkaqeve kryesore për ekzekutimin e këtyre pagesave.

Lidhur me këtë, Thesari kishte rishikuar procedurën për faturat e papaguara/vonesat në pagesa sipas Nenit 39.2 dhe në tetor të vitit 2017 kishte aprovuar procedurën për trajtimin e kërkesave të furnitorëve për obligimet e vonuara dhe të papaguara sipas nenit 39.2 të LMFP-së. Me këtë procedurë, është përshkruar në mënyrë më të qartë procedura që nga kërkesa deri të ekzekutimi dhe raporti i pagesave.

Tabela 22 - Pagesat sipas nenit 39.2 të LMFP

(në euro)

Pagesat sipas kategorive	Totali 2019	Totali 2018	Totali 2017
Mallra dhe Shërbime (Komunali)	52,066	1,673,869	1,892,000
Subvencione dhe transfere	0	0	316,000
Investime Kapitale	1,507,626	7,010,331	6,396,000
Gjithsej	1,559,692	8,684,200	8,604,000

Në vijim, janë pasqyruar disa prej organizatave buxhetore tek të cilat janë ekzekutuar pagesa në shuma më të larta, bazuar në nenin 39.2 të LMFP, që përfshinë mbi 70% të totalit të këtyre pagesave:

- Komuna e Gjakovës 512,796 €; Komuna e Ferizajt 80,557€.
- Komuna e Prizrenit 256,269€; MKRS 45,708€;
- Komuna e Rahovecit 202,268€; MSH 14,650€

Kjo mënyrë e realizimit të pagesave mund të rritë rrezikun e vazhdimin të praktikave të tilla nga OB-të. Me rastin e rishikimit të procesit të këtyre pagesave, nuk kemi vërejtur parregullsi dhe se procedura për trajtimin e kërkesave të furnitorëve për obligimet e vonuara dhe të papaguara sipas nenit 39.2 të LMFP-së është zbatuar me konsistencë nga ana e Thesarit.

7.1 Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore

Në vitin 2019 me vendime të gjykatave dhe vendime të përmbartuesve privat, janë bërë pagesa në vlerë prej 25,834,238⁴ Në raport me të dhënat e vitit 2018, vlera e këtyre pagesave është rritur për

3 Sipas LMFP - Neni 39.2 kur një faturë nuk është paguar nga OB-ja për një periudhë më të gjatë se 60 ditë, operatori ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin e pagesës drejtpërdrejt nga MF/Thesari i cili duhet ta ekzekutojë pagesën.

4 Sipas LMFP nenit 40, MF/Thesari obligohet të kryej pagesa sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore të formës së prere

5,574,163€ apo rreth për 28%, çka paraqet një tregues se organizatat buxhetore janë gjithnjë e më pak likuide apo vonohen në kryerjen e detyrimeve ndaj operatorëve ekonomik dhe furnitorëve tjerë.

Pagesat për organizata të nivelit qendrorë ishin 10,506,559€, apo 41% e totalit, ndërsa pagesat në nivelin lokal ishin në vlerë prej 15,327,678€ apo 59% e totalit të vendimeve gjyqësore.

Tabela 23 - Pagesat me vendim të gjykatave dhe përmbarimeve për tri vitet e fundit (në euro)

Pagesat sipas kategorive	Totali 2019	Totali 2018	Totali 2017
Paga dhe mëditje	819,679	303,522	34,000
Mallra dhe Shërbime (Komunali)	7,088,607	4,058,530	2,251,000
Subvencione dhe transfere	603,395	590,977	373,000
Investime Kapitale	17,322,557	15,307,046	8,886,000
Gjithsej:	25,834,238	20,260,075	11,544,000

Mos kryerja e detyrimeve me kohë nga ana e organizatave buxhetore, ka shkaktuar procedura gjyqësore të kushtueshme dhe të komplikuar. Vonesat e tilla kanë rezultuar me shpenzime shtesë të buxhetit dhe implikime negative në besueshmërinë ndaj institucioneve publike. Siç shihet nga tabela, pagesat në vlera më të mëdha, kryesisht janë kryer nga kategoria e investimeve kapitale, që do të thotë se shumë projekte kapitale janë reduktuar për t'u paguar këto detyrime. Të dhënat në tabelë tregojnë një trend në rritje të pagesave në bazë të vendimeve gjyqësore të cilat ishin rritur për 28% krahasuar me vitin paraprak, dhe 124% në raport me vitin 2017.

Më poshtë, janë pasqyruar dhjetë (10) organizata buxhetore tek të cilat janë ekzekutuar pagesa në vlera më të mëdha, të cilat e përbëjnë gjysmën e shumës së pagesave të kryera me vendime gjyqësore (rreth 13 milionë euro).

Pagesat të kryera me vendime gjyqësore



Organizata buxhetore

● Ministria e Financave	2,884,438€
● SHSKUK	1,219,611€
● Komuna e Mitrovicës	1,491,621€
● Ministria e Infrastrukturës	918,231€
● Komuna e Leposaviqit	1,334,356€
● Komuna e Pejës	862,900€
● Ministria e Administratës Publike	1,279,152€
● Komuna e Gjakovës	845,441€
● Komuna e Prishtinës	1,229,597€
● MKRS	423,760€

Shkaqet kryesore të pagesës së faturave nga Thesari sipas vendimeve gjyqësore kryesisht kishin të bëjnë me vonesat në realizim të pagesave të faturave të mbetura si konteste nga vitet e më hershme nga OB-të, mos kompenzimi i punëtorëve për paga jubilarë dhe përcjellëse të cilat ishin të rregulluara sipas kontratës kolektive, por që nuk ishin buxhetuar nga kategoria e pagave, mos pagesat tjera sipas procedurave të rregullta për shpenzimin e parave publike, mos pagesa e ndëshkimeve nga institucionet tjera, si dhe vonesat në pagesa për operatorët ekonomik si shkak i mungesës së mjeteve buxhetore.

Konkluzioni përfundimtar është se gjendja lidhur me këto pagesa jo që nuk është përmirësuar, por veçsa po përkeqësohet. Deri në kohën e raportimit, posedojmë të dhëna se vetëm gjatë periudhës 1 janar-30 qershor 2020, Thesari ka pranuar vendime të formës së prerë nga ana e gjykatave dhe përmbaruesve privat në një vlerë totale prej afër 15 milionë euro, prej të cilave i ka ekzekutuar mbi 10 milionë. Shumat e këtyre pagesave nuk janë parashikuar me ndarjet e rregullta buxhetore për vitin 2020, prandaj pjesa dërmuese e tyre pritet të paguhet nga investimet kapitale, çka e rritë edhe më tepër problemin, duke shkaktuar më pas edhe keq klasifikim të shpenzimeve. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre padive kanë të bëjnë me zbatimin e detyrimeve që dalin nga kontratat kolektive në fuqi në sektorin e arsimit dhe të shëndetësisë.

Rekomandimet për Qeverinë, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe Komunat

Të shqyrtohen të gjitha mundësitë ligjore që për rastet në gjykata, që kryesisht kanë të bëjnë me marrëveshjet kolektive, nga Komunat të arrihen marrëveshje jashtë gjyqësore dhe ri-programim i tyre në bazë të mundësive buxhetore dhe të njëjtat t'i planifikojnë në buxhetet e tyre, me qëllim që të shmangin pagesat për tarifa dhe kamata ligjore. Bashkëpunimi me Këshillin Gjyqësor dhe strukturat tjera, gjithashtu do të ishte i nevojshëm.

Rekomandimet për Ministrinë e Financave

- Me rastin e përgatitjes së Buxhetit vjetor të vitit 2021, Ministria e Financave duhet të kërkojë të gjitha të dhënat nga secila organizatë buxhetore lidhur me paditë e ngritura së bashku me një vlerësim nga zyrat ligjore për mundësinë e daljes së parasë, dhe të njëjtat sipas kategorive përkatëse t'i planifikoj me ndarjet e rregullta buxhetore, në mënyrë që t'i shmangët vështirësive në sigurimin e fondeve për këto pagesa si dhe keqklasifikimit të tyre në kodet ekonomike;
- Specifikisht të kërkohet nga të gjitha OB-të që me rastin e kalkulimit të pagave për stafin e tyre, të përlllogarisin edhe detyrimet që dalin nga kontratat kolektive dhe të njëjtin plan t'ia dorëzojnë Ministrisë së Financave në mënyrë që këto shpenzime të parashihen me buxhet të rregullt dhe të shmangen proceset gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore shtesë lidhur me këto konteste; dhe
- Si alternativë, të shqyrtojë mundësinë e rritjes së fondit kontingjent në Ministrinë e Financave, dhe nga i njëjti fond, të kompenzohen të gjitha pagesat fillimisht, ndërsa me rishikim buxheti apo me rregullimet e fundvitit, të korrigojë buxheti i organizatave buxhetore për të njëjtat shuma.

8 Të dhënat e punësimit

Sipas Ligjit Nr. 06/L -133 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, numri i lejuar i të punësuarve për nivelin qendror (Ministritë dhe Institucionet e Pavarura), dhe nivelin lokal ishte 85,963, përderisa numri faktik i të punësuarve sipas RFV të BRK-së ishte 83,789. Nëse e krahasojmë numrin e të punësuarve faktik të vitit 2019 me numrin e të punësuarve në vitin 2018 (80,224), kemi një rritje të punësuarve për 3,565 të punësuar. Siç shihet organizatat buxhetore në vitin 2019 nuk kishin arritur t'i plotësojnë të gjitha vendet e punës të lejuara me Ligjin e buxhetit. Dallimi në mes numrit të lejuar dhe faktik të të punësuarve ishte për 2,174.

Diferencat më të shprehura dhe shkaqet që kanë ndikuar në mos plotësimin e pozitave të lejuara janë identifikuar te organizatat si vijon:

Komuna e Mitrovicës Veriore, arsyeja për mosplotësimin 307 pozitave ishte se menaxhmenti i komunës ende nuk e kishte miratuar rregulloren e brendshme për strukturën organizative, sistematizimin e vendeve të punës dhe për pajtueshmërinë e saj me nevojat dhe me buxhetin e Komunës.

Ministria e Shëndetësisë, numri i pa plotësuar në këtë institucion ishte 296. Prej tyre 223 ishin pozita të lira për specializantë, dhe arsyeja e mosplotësimit ishte mos shpallja e konkursit nga ana e Ministrit përkundër kërkesave, ndërsa për departamentet tjera edhe përkundër se pozitat në Ligj kanë qenë të lejuara, buxheti ka qenë i pamjaftueshëm.

Universiteti i Prishtinës, arsyeja për mosplotësimin e 295 pozitave ishte dështimi në konkurset e shpallura si dhe moshpallja e konkurseve.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, arsyeja e mos plotësimit të 263 pozitave të lira ishte për shkak të mungesës së buxhetit.

Ministria e Punëve të Brendshme, arsyet për mosplotësimin e 238 pozitave ishte dështimi në zhvillimin e procesit të rekrutimit.

Ministria e Drejtësisë, nuk kishte arritur të plotësoj numrin e aprovuar të pozitave për 114 sosh për shkak të tej zgjatjes së procedurave të rekrutimit, si dhe ngrirja e pozitave nga MAP për shkak të Ligjit për paga që ishte në procedura të shqyrtimeve gjyqësore.

Më tej, kemi vërejtur se numri faktik i të punësuarve për nivelin lokal i raportuar në RVF të BRK-së është më i madh se sa numri i të punësuarve i raportuar në PVF individuale të komunave për 1,509. Kjo diferencë është kryesisht për faktin se komunat nuk i kanë raportuar asambleistët komunal në numrin e stafit në PFV-të e tyre.

Mos plotësimi i numrit të aprovuar të të punësuarve sipas Ligjit të buxhetit për vitin 2019, si në nivelin qendror dhe atë komunal, mund të rezultojë me performancë të dobët në nivel të organizatës dhe mos realizim të planeve dhe arritjen e objektivave të synuara. Po ashtu, mosharmonizimi i raporteve për të punësuarit mes RFV të BRK-së dhe atyre individuale, ndikon në prezantim jo të drejtë të numrit të punësuarve dhe paraqet pamje ç'orientuese.

8.1 Të punësuarit jashtë listës së pagave dhe me kontrata për shërbime të veçanta

Numri i të punësuarve jashtë listës së pagave

Sipas RFV të BRK-së për vitin 2019, numri total i të punësuarve jashtë listës së pagave ishte 376, ku institucionet e nivelit qendror (Ministritë dhe Institucionet e Pavarura) i kishin 335, ndërsa niveli lokal 41. Nëse krahasojmë me vitin e kaluar (431), ka një rënie për 55 presona.

Numri më i madh i tyre është hasur në Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (221). Ky numër ka të bëjë me specializantë dhe specialistë të cilët nuk janë në listat e pagave në QKUK dhe janë prezent vetëm në mbajtje të kujdestarive. Mjekët në specializim kanë kontratë me Ministrinë e Shëndetësisë për specializim, ndërsa mjekët specializantë nuk janë në marrëdhënie pune në QKUK, por në institucione tjera kanë kontrata pune me dedikim për mbajtje të kujdestarive apo kryerje të punëve të caktuara.

Po ashtu, edhe në Organin Shqyrtues të Prokurimit janë 48 punëtorë të angazhuar si ekspertë të jashtëm teknik dhe profesional.

Zyra e Kryeministrit i kishte 16 punëtorë jashtë listës së pagave, ku 12 prej tyre ishin të angazhuar me vendim të Qeverisë për shënjimin e demarkacionit dhe katër (4) për zhvillimin e një Programi mes të Qeverisë së Kosovës dhe asaj të SHBA-së.

Marrëveshjet për shërbime të veçanta

Sipas PFV të BRK-së për vitin 2019, numri total i të angazhuarve përmes Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta (MSHV), ishte 4,197. Krahasuar me numrin prej 2,618 në vitin 2018, ka një rritje të këtyre të punësuarve për 1,579. Rritja më e theksuar ishte tek Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për 1,115, të cilët ishin angazhuar për procesin e zgjedhjeve të parakohshme për kryetar në komunat: Mitrovicë Veriore, Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq dhe Zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2019.

Gjetjet kryesore të dala nga raportet individuale të auditimit për vitin 2019, sa i përket këtyre të angazhuarve ishin: angazhimi i tyre pa respektuar ndonjë procedurë të rekrutimit, siç kërkojnë rregullat ligjore, periudha e angazhimit të zyrtarëve më e gjatë se sa afati i përcaktuar me rregulla, kontratat e lidhura për këto pozita ishin për pozita të rregullta, e jo për ekspertë të fushave përkatëse, për çka lejohet ky lloj angazhimi dhe vazhdimi i angazhimit të zyrtarëve me MSHV nga vitet paraprake.

Plotësimi i pozitave të rregullta me staf të përkohshëm përmes MSHV-ve, si dhe në mungesë të procedurave të rekrutimit, rrezikon angazhimin e stafit jo adekuat në pozitat përkatëse dhe mund të rezultojë me performancë të dobët në kryerjen e detyrave. Këto mangësi mund të kenë efekt negativ në realizimin e objektivave nëpër organizatat buxhetore.

Rekomandimet për Ministrinë e Financave

- Ministri i Financave, të shtoj kontrollet dhe bashkë me krerët e organizatave buxhetore të siguroj se me rastin e planifikimeve, organizatat buxhetore kanë bërë analiza të mirëfillta dhe të qëndrueshme si dhe raportimi për të punësuarit faktik të jetë i harmonizuar; dhe
- Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit, të sigurojnë se institucionet për- katëse do të respektojnë të gjitha kërkesat ligjore sa i përket të punësuarve me marrëveshje për shërbime të veçanta, duke u pershtatur me kërkesat e Ligjit të ri për zyrtarët publik.

Pjesa II - Të përgjithshme

9 Zbatimi i rekomandimeve

Pas pranimit të RVA-së për vitin 2018, Qeveria kishte përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, por i njëjti nuk është dërguar në Kuvend (KMFP), për të diskutuar dhe shqyrtuar rekomandimet për zbatimin e tyre.

Në nivel të auditimeve individuale, shumica e organizatave buxhetore nuk zbatojnë proces sistematik për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve. Ndonëse, krahasuar me vitin 2018, numri i rekomandimeve ka shënuar rënie, megjithatë, numri i rekomandimeve të zbatuara plotësisht është në nivel prej 40%, ndërsa pjesa tjetër e rekomandimeve janë në proces të zbatimit ose të pa zbatuara, përfshirë këtu edhe rekomandimet nga vitet e mëhershme. Përveç kësaj, një numër i rekomandimeve janë trajtuar si të mbyllura për faktin e ndryshimeve të bazës ligjore si dhe ndryshimit të strukturës sonë të raportimit.

Ngecjet në zbatimin e plotë të rekomandimeve ndikojnë në përsëritjen e dobësive dhe mangësive të kontrollit dhe përsëritjen sistematike të parregullsive nga viti në vit. Shkaqet dhe arsyet që kanë ndikuar për një progres të dobët, janë të ndryshme, të cilat do të shpjegohen më poshtë.

Ndikimi i auditimit, matet me nivelin e zbatimit të rekomandimeve, dhe është treguesi më i mirë nëse menaxhmenti po përmirëson proceset ekzistuese dhe kontrollet në fushat ku janë identifikuar gabimet dhe parregullsitë. ZKA, përmes auditimeve individuale bën edhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në vitin paraprak dhe vitet e mëhershme, duke i pasqyruar qartë fushat në të cilat janë marrë masa dhe veprime përmirësuese, si dhe fushat ku nuk janë vërejtur ndryshime.

Shtojca II e raportit ofron informata të plota mbi progresin e rekomandimeve të dhëna në RVA, ndërsa Tabela 1 dhe 2 paraqet statistikën e rekomandimeve për organizatat individuale.

9.1 Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në RVA për vitin 2018

Në RVA për vitin 2018, Auditori i Përgjithshëm kishte rekomanduar Kuvendin të kërkojë nga Qeveria një raport në lidhje me rekomandimet e dhëna në RVA të vitit 2018 dhe të përgatisë një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të dhëna, si dhe raporte në lidhje me progresin e këtij plani në baza gjashtë mujore.

Qeveria e Kosovës në nëntor të vitit 2019 kishte aprovuar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, ku janë obliguar të gjitha organizatat buxhetore (OB) për zbatimin e tij. Mirëpo, i njëjti nuk është dërguar edhe në Kuvendin e Kosovës (KMFP) për shqyrtimin e progresit të rekomandimeve, por se i njëjti ka qenë pjesë dhe në shtojcë të RFV 2019.

Në bazë të informatave të mbledhura gjatë procesit të auditimit për pasqyrat e buxhetit si dhe nga auditimet individuale, kemi vërejtur se veprimet e ndërmarra nga ana e Kuvendit të Kosovës, Qeverisë dhe institucioneve tjera, kanë reflektuar me një progres të ultë në zbatimin e rekomandimeve, edhe pse krahasuar me vitin e kaluar për nga numri në aspektin cilësor, niveli i tyre ka shënuar rënie.

Nga gjithsej 51 rekomandime⁵ të dhëna në RVA 2018, 14 janë zbatuar plotësisht, 18 ishin në proces të zbatimit dhe 19 të tjera nuk ishin adresuar ende. Shtojca II paraqet të dhëna të detajuara për rekomandimet e dhëna në RVA 2018.

Moszbatimi i rekomandimeve ka ndikuar që dobësitë dhe parregullsitë e caktuara të përsëriten veçanërisht në fushat, si:

- Raportimi i shpenzimeve në PFV në kategori jo adekuate për shkak të keqklasifikimit (përfshirë edhe pagesat direkte nga Thesari) dhe shpalosja jo e mjaftueshme e informatave në raportimet individuale të organizatave buxhetore;
- Dobësi në procedurat e prokurimit;
- Dobësitë në menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve;
- Dobësi në menaxhimin e personelit dhe procedurave për subvencionet;
- Mungesë të shërbimeve të auditimit të brendshëm në disa organizata dhe për institucionet e vogla të pavarura; dhe
- Menaxhim joefikas i burimeve në komuna.

9.2 Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale 2018

Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve është pjesë e procesit të përhershëm të auditimit. Vlerësimi se si dhe sa janë zbatuar ato, bëhet për secilën organizatë buxhetore gjatë auditimit të rregullt, dhe rezultatet për vitin paraprak, paraqiten në raportet e auditimit për vitin vijues.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat për gjendjen e rekomandimeve të vitit 2018 dhe 2017, të cilat janë të kategorizuara sipas organizatave të audituara.

Organizatave të audituara janë ndarë në: Institucione të nivelit qendror⁶, Institucione të pavarura⁷ dhe Institucione të nivelit lokal (38 Komuna). Në vijim është paraqitur tabela me numrin e rekomandimeve të dhëna dhe përqindjet e zbatimit të tyre.

Tabela 24 - Zbatimi i rekomandimeve për vitin 2018 për organizatat buxhetore

Subjektet e audituara	Nr. total i rekomand.	Plotësisht të zbatuara		Pjesërisht të zbatuara		Të pa zbatuara		Të mbyllura të pa zbatuara	
		Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Institucionet e nivelit qendror	274	111	41%	32	12%	101	37%	30	11%
Institucionet e pavarura	59	42	71%	3	5%	10	17%	4	7%
Institucionet e nivelit lokal	588	217	37%	78	13%	201	34%	92	16%
Gjithsej	921	370	40%	113	12%	312	34%	126	14%

5 Tri (3) Rekomandime janë dhënë për Kuvendin e Kosovës, 47 për Qeverinë / ministrinë, dhe 1 për Kuvendet Komunale. Nga këto rekomandime shtatë (7) janë dhënë në lidhje me auditimin e performancës.

6 Kuvendi i Kosovës, Zyra e Presidentit, Zyra e Kryeministrit, 21 Ministri, Administrata Tatimore e Kosovës, Dogana dhe ShSKUK.

7 Në institucionet e pavarura janë përfshirë Universiteti i Prishtinës dhe 28 institucione tjera të pavarura.

Për qëllime krahasuese, tabela në vazhdim paraqet të dhënat për rekomandimet e vitit paraparak.




Tabela 25 - Zbatimi i rekomandimeve të organizatave buxhetore për vitin 2017

Subjektet e audituara	Nr. total i rekomand.	Plotësisht të zbatuara		Pjesërisht të zbatuara		Të pa zbatuara		Të mbyllura të pazbatuara	
		Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Institucionet e nivelit qendror	357	144	40%	59	17%	103	29%	51	14%
Institucionet e pavarura	164	106	65%	19	12%	22	13%	17	10%
Institucionet e nivelit lokal	600	188	31%	123	21%	229	38%	60	10%
Gjithsej rekomandime	1,121	438	39%	201	18%	354	32%	128	11%

Siç shihet edhe nga tabelat më lart, numri total i rekomandimeve të dhëna për vitet 2017/2018, është në rënie, e cila reflektohet sipas nivelit të institucioneve, megjithatë niveli i rekomandimeve të pa zbatuara ende është jo i kënaqshëm (32%).

Në përgjithësi, organizatat buxhetore nuk ndjekin ndonjë proces formal të monitorimit, vlerësimit apo raportimit mbi shkallën e progresit. Kjo pasqyron mungesën e përgjegjësisë për të siguruar që rekomandimet zbatohen me kohë dhe pengesat për veprim, identifikohen dhe adresohen.

Në vitin 2019, ZKA ka dërguar tek Organizatat buxhetore "Rregullore të punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit" si dhe formatet e formularëve për planin e veprimit të rekomandimeve dhe monitorimit (progresit) të tyre.

Në mënyrë që situata të përmirësohet, nevojitet rritje e përkushtimit dhe llogaridhënies nga personat përgjegjës dhe monitorim i rregullt i zbatimit të rekomandimeve nga të gjitha Organizatat Buxhetore.

Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet e performancës

Qëllimi i rekomandimeve në auditimet e performancës është në përmirësimin e procesit të zbatimit dhe funksionimit efektiv të sistemeve, programeve dhe aktiviteteve qeveritare. Rekomandimet i adresohen subjekteve të audituara në mënyrë që të përmirësojnë qasjen e tyre në raport me shpenzimin e fondeve publike.

Shumica e organizatave të përfshira në auditimet individuale të performancës nuk kanë përgatitur plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të dhëna. Andaj, zbatimi i rekomandimeve është bazuar në rezultatet e auditimeve individuale (të performancës, rregullsisë, dhe teknologjisë së informacionit) të përfunduara në vitin 2019/2020, të cilat kanë trajtuar çështje të ngjashme në organizatat e njëjta. Po ashtu, në rastet ku ka ekzistuar plani i veprimit është marrë parasysh.

Sipas këtij vlerësimi, një (1) rekomandim është i zbatuar, katër (4) janë zbatuar pjesërisht, një (1) rekomandim sipas planit të veprimit zbatohet gjatë vitit 2020-2021 dhe një (1) rekomandim për komunat nuk është vlerësuar, i cili nuk ka as plan veprimi. Në shtojcën II të këtij raporti, është paraqitur gjendja e zbatimit të këtyre rekomandimeve.

Arsyet për zbatim të ultë të rekomandimeve

Mungesa e proceseve formale për monitorimin e mirëfilltë dhe sistematik të planeve të veprimit për zbatim të rekomandimeve, si dhe mungesa e përkushtimit të duhur për trajtimin e tyre, janë ndër shkaktarët kryesor për nivelin e ultë të zbatimit të rekomandimeve. Po ashtu, mungesa e mbikëqyrjes efikase nga ana e Qeverisë dhe organeve mbikëqyrëse, ka ndikuar që organizatat buxhetore të shmangin zbatimin e plotë dhe konsistent të udhëzimeve për menaxhimin financiar, duke bërë që rekomandimet të përsëriten nga viti në vit.

Për të rritur nivelin e zbatimit të rekomandimeve, nevojiten masa shtesë nga ana e Qeverisë ndaj OB-ve dhe forcimi i masave të llogaridhënies ndaj Kuvendit të Kosovës.

Rekomandimet për Kuvendin e Republikës së Kosovës

Përsërisim rekomandimin e vitit të kaluar se Kuvendi duhet të siguroj që plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve i përgatitur nga Qeveria, është shqyrtuar nga KMFP. Po ashtu, të përcaktoj saktë veprimet, afatet kohore dhe personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve dhe monitorimin e tyre. Po ashtu, të siguroj që të paktën një herë në vit të shqyrtoj progresin e arritur për rekomandimet e dhëna.

Rekomandimi për Kuvendet e Komunave

Përsërisim rekomandimin e vitit të kaluar që Kryetarët e Komunave t'i diskutojnë në baza të rregullta raportet e menaxherëve përgjegjës për zbatimin e planeve të veprimit, dhe së paku dy herë në vit, të raportojnë në Kuvendin Komunal lidhur me progresin dhe sfidat në këtë fushë.

10 Opinionet e auditimeve në raportet individuale

ZKA për vitin 2019, ka kryer 95 auditime të rregullsisë (94 OB dhe Fondet e AKP në mirëbesim). Opinionet e auditimit në lidhje me PFV-të, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, derisa gjetjet e auditimit janë prezantuar në raportet individuale të auditimit të OB-ve.

Tabela 26 - Numri dhe lloji i opinioneve të dhëna për vitin 2019

Subjektet e audituara	Opinion i pa modifikuar	Opinion i pa modifikuar me theksim të çështjes	Opinion i kualifikuar	Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes	Gjithsej
Organizatat e nivelit qendror	19	8	0	0	27
Komunat	21	17	0	0	38
Institucionet e Pavarura	29	1	0	0	30
Gjithsej	69	26	0	0	95

Siç shihet edhe nga tabela, auditimet individuale të OB-ve kanë rezultuar të gjithat me opinione të pamodifikuara. Prej tyre, 69 të pamodifikuara dhe 26 të pamodifikuara me theksim të çështjes. Pasqyra më lartë tregon se auditimet në kuptim të raportimit, paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të PFV-ve, që do të thotë se pasqyrat nuk kanë pasur gabime dhe parregullsi materiale. Në krahasim me vitet paraprake, ka përmirësim domethënës pasi në 2018 në 10% të rasteve, dhe në vitin 2017 në 17% të rasteve, pasqyrat e OB-ve kanë pasur gabime materiale.


Arsyet për theksimin e çështjes kanë qenë në shumicën e rasteve keqklasifikimi i shpenzimeve, i cili ishte i ndikuar nga pagesat përmes vendimeve të gjykatave dhe përmbarimeve si dhe keqklasifikimet e ndikuara nga planifikimi i gabuar.

10.1 Rekomandimet e dhëna në raportet individuale për vitin 2019

Përveç opinionëve të auditimit, në raportet individuale të subjekteve të audituara kemi dhënë rekomandimet për përmirësimin e secilës fushë ku janë identifikuar mangësi dhe gabime. Tabela e mëposhtme paraqet numrin e rekomandimeve të dhëna në tri vite për subjektet e audituara.

Tabela 27 - Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale për tri vitet e fundit

Subjektet e audituara	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017
Institucionet e Nivelit Qendror	263	275	363
Komunat	488	585	600
Institucionet e Pavarura	52	60	166
Ndërmarrjet publike	265	254	149
Gjithsej rekomandime	1,058	1,174	1,278

Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale për tri vitet e fundit

Të dhënat e paraqitura në tabelë tregojnë për rënie të vazhdueshme të numrit të rekomandimeve nëpër vite, përveç NP-ve që kanë rritje, por kjo rritje është edhe rezultat i rritjes së numrit të ndërmarrjeve publike të audituara. Rënie më e madhe e numrit të rekomandimeve këtë vit vërehet te Komunat, derisa rënie më e lehtë e numrit është te OB-të e nivelit qendror dhe te Institucionet e pavarura.

11 Sistemi i auditimit të brendshëm

Auditimi i Brendshëm (AB) është funksion i rëndësishëm i sistemit i cili siguron menaxhmentin e lartë se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Komiteti i Auditimit (KA) është organ këshillëdhënës i menaxhmentit të lartë të subjekteve të sektorit publik, dhe mbështetës për auditorët e brendshëm duke siguruar pavarësinë e tyre, vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve dhe siguruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Njëra nga objektivat e Strategjisë së Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike (SKBFP) 2015-2019 është avancimi i auditimit të brendshëm përmes zbatimit të programit për zhvillim profesional, sigurimit të cilësisë për pajtueshmëri si dhe azhurnimit të kornizës ligjore. Pra, rëndësia dhe ndjeshmëria e profesionit i obligon auditorët e brendshëm që të kenë nivelin e duhur profesional.

Njësia Qendrore Harmonizuese është koordinatore e gjithë procesit për auditim të brendshëm dhe ndër të tjera monitoron subjektet e sektorit publik për kontrollin e brendshëm të financave publike. Si zhvillime pozitive të kësaj periudhe në kuadër të SKBFP 2015-2019, është edhe fakti që Ligji për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike ishte në zbatim dhe nga fillimi i vitit 2019 ishin në zbatim edhe UA 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit dhe Rregullorja 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm. Po ashtu, situatë më e mirë ishte te mbulueshmëria e auditimit pasi që rreth 65% e aktiviteteve të auditimit të brendshëm kishin në fokus vitin aktual, përderisa sa i përket veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti në zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm kemi vërejtur se 47% e rekomandimeve të dhëna kishin gjetur zbatim të plotë përderisa pjesa tjetër ishin në proces apo të pazbatuara.

Mangësitë e vërejtura në sistemin e auditimit të brendshëm i kemi paraqitur në vijim:

Rregullorja 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm përcakton kriteret që duhet plotësuar për themelimin e NjAB-së, dhe përcakton numrin minimal të auditorëve që duhet të ketë një organizatë buxhetore.

Bazuar në këto kritere kemi identifikuar se prej 70 OB-ve, përkundër që e plotësojnë kriterin, pesë (5) prej tyre nuk e kishin të themeluar NjAB-në. OB-të që nuk kanë themeluar NjAB janë: Mitrovica Veriore, Laposaviqi, Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Arsyet për këtë janë: mungesa e buxhetit, dështimet në proceset e rekrutimit, apo neglizhenca e vet organizatave. Përderisa, sa i përket stafit të mjaftueshëm me auditorë, nga 65 OB që kanë të themeluara NjAB, mbi gjysma (37) prej tyre kishin numër të auditorëve më pak se sa që e parasheh rregullorja; dhe

Sfidë mbetet mos themelimi i Komiteteve të Auditimit (KA) në të gjitha organizatat. Nga 65 OB, në gjashtë (6) prej tyre nuk ishin të themeluara KA në vitin 2019. Këto janë: Mitrovica Jugore, Ranillug, Agjencia për Verifikimin e Pronave, KQZ, Institucioni i Avokatit të Popullit dhe MASHT. Më tej, nga 57 OB ku funksiononte KA, është vërejtur se në 15 prej tyre KA-të kishin mbajtur me pak se katër (4) takime, siç kërkohet me UA. Po ashtu, 28 KA nuk e kishin dorëzuar raportin vjetore siç kërkohet me nenin 10 të UA. Kjo tregon se KA-të ende nuk janë efektive për të mbështetur plotësisht punën e NjAB.

Auditimet e brendshme vazhdojnë të mbeten të orientuara drejt pajtueshmërisë dhe më pak të përqendruara në auditime të performancës dhe të sistemeve. Sistemi i kontrollit të brendshëm

përkundër përmirësimeve nga viti i kaluar, ende nuk është në nivelin e kënaqshëm, në mënyrë që AB të veprojnë si mekanizëm parandalues i gabimeve dhe parregullsive.

Rekomandojmë Qeverinë që në bashkëpunim me NJQH/AB që të siguroj se:

- Menaxhmenti i OB-ve të cilat janë të obliguara të themelojnë NjAB sipas Rregullores QRK-nr. 01/2019, duhet t'i themelojnë këto njësi, ndërsa OB-të që nuk janë të obliguara të kenë NjAB, funksionin e auditimit të brendshëm ta përmbushin përmes mënyrave tjera të parapara me këtë rregullore dhe në përputhje me ligjin për funksionimin dhe organizimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura; dhe
- Për ta kompletuar sistemin e auditimit të brendshëm, NJAB duhet të plotësohen me staf dhe të themelojnë Komitetet e Auditimit për të mbështetur realizimin e objektivave të NjAB-së. Po ashtu, KA duhet të jenë efektive në mbajtjen e takimeve dhe të kontribuojnë në rritjen e llogaridhënies dhe forcimin e rolit të AB-së, si dhe të dorëzojnë raporte vjetore të punës, siç kërkohet me UA.

12 Prokurimi

Në vitin 2019 përmes procedurave të prokurimit publik janë lidhur kontrata në vlerë 781,396,035€ apo rreth 150 mijë euro më shumë se vitin paraprak. Këto procedura janë zhvilluar nga 161 autoritete kontraktuese përgjegjëse për zhvillim të procedurave, ndërsa për 16 institucione të pavarura, procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga Agjencia Qendrore e Prokurimit.

Numri i kontratave të nënshkruara për vitin 2019 ishte 12,461 dhe është numër i përafërt me atë të vitit paraprak. Pjesën më të madhe të këtyre kontratave, për nga numri por edhe vlera e kontraktuar, e përbëjnë Autoritetet Kontraktuese Qeveritare, ndërsa burimi kryesor i financimit ishte Buxheti i Kosovës me 83%, pastaj të hyrat vetjake me 17% dhe pjesa tjetër ishin donacione.

Vlenë të theksohet se përveç organizatave buxhetore, si autoritet kontraktues ka vepruar edhe AQP. Gjatë vitit 2019, Drejtoria për Prokurime të Centralizuara e AQP-së kishte nënshkruar 31 kontrata, vlera e përgjithshme e të cilave është afër 54.9 milion euro. Ndërsa, në fund të vitit 2019, në procedurë kanë mbetur gjithsej nëntë aktivitete, në vlerë të parashikuar prej 44.3 milion euro.

Më tutje, Drejtoria për Prokurime të veçanta e AQP-së kishte zhvilluar 68 aktivitete të prokurimit dhe kishte lidhur 81 kontrata për autoritete të ndryshme kontraktuese, sipas kërkesës së tyre. Vlera e përgjithshme e këtyre kontratave është rreth 1.5 milion euro.

Rritja e vazhdueshme e fondeve që shpenzohen përmes procedurave të prokurimit tregon rëndësinë dhe ndikimin që mund të ketë kjo fushë në zhvillimin e ekonomisë vendore. Auditimi ka identifikuar që gjatë vitit 2019 pothuajse asnjë autoritet kontaktues nuk kishte realizuar në tërësi aktivitetet e planifikuara të prokurimit, por njëkohësisht kishin lidhur kontrata të shumta jashtë planit të prokurimit.

Numri i identifikuar i kontratave të lidhura jashtë planit të prokurimit ishte 735 sosh, nga të cilat afër 5% ishin bashkëfinancime, çka tregon se planifikimi nuk ishte në nivelin e duhur e as i bazuar në nevoja reale të organizatave buxhetore.

Përdorimi i shpeshtë i procedurave për kontrata me vlerë minimale ishte evident edhe në 2019, procedura këto që mund të rrezikojnë parimet e ekonomisë, efikasitetit dhe jo diskriminimin. Ne kemi identifikuar se gjatë vitit 2019 janë lidhur 1,570 kontrata me vlerë minimale, e nga to kishte raste edhe kur kontratat ishin për mallra të ngjashme. Kur kontratat ishin të ngjashme, autoritetet kontraktuese kanë mundur që t'i bashkojnë këto kërkesa dhe të zhvillojnë procedura të hapura për të mundësuar konkurrencë dhe transparencë më të madhe.

Raportet individuale të auditimit të rregullsisë edhe këtë vit ka vënë në pah dobësi në procedura të prokurimit, duke filluar nga planifikimi i prokurimit, zhvillimi i procedurave të prokurimit, deri te menaxhimi i kontratave.

12.1 Çështjet e rregullsisë në fushën e prokurimit

Zbatimi i procedurave të prokurimit, sidomos në fazën e vlerësimit të tenderëve vazhdon të jetë një nga çështjet më problematike, dhe proceset e ankesave janë mjaft të shpeshta nga ana e operatorëve. Si rezultat i pakënaqësive të operatorëve ekonomik në procesin e vlerësimit, gjatë këtij

vitti në OSHP janë deponuar 981 ankesa. Vendimet e OSHP-së lidhur me ankesat kanë rezultuar me vendimet që më shumë se gjysma (54%) ose 535 raste janë kthyer në rivlerësim derisa numri i aprovimeve të vendimeve të AK-së është 261 raste ose 27% në raport me numrin e përgjithshëm të ankesave. Ndërsa, numri i gjobave të shqiptuara gjatë vitit 2019 nga OSHP ishte dy.

Pra, edhe në vitin 2019 sikur vitet e kaluara, raportet individuale të auditimit kanë nxjerrë në pah një sërë mangësish në zhvillimin dhe zbatimin e procedurave të prokurimit. Mangësi janë identifikuar në të gjitha fazat e prokurimit dhe në shumicën e autoriteteve kontraktuese, por që në tabelën në vijim, në hollësi kemi prezantuar dobësitë e përsëritura më së shpeshti.

Tabela 28 - Çështjet e rregullsisë në fushën e prokurimit

Çështja	Ndikimi	Veprimet e kërkuara nga organizatat buxhetore
Hyrja në obligime kontraktuale duke nënshkruar kontratat pa buxhet të mjaftueshëm në dispozicion.	Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme rritë rrezikun e vonesave në zbatimin e kontratës dhe rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat mund të jenë ngarkesë për buxhetin e vitit vijues.	Të ndërpriten praktikatat e hyrjes në detyrime kontraktuale pa zotimin e fondeve të mjaftueshme që sigurojnë përfundimin e projekteve sipas kontratës.
Fillimi i procedurave dhe nënshkrimi i kontratave pa hartuar projektin ekzekutiv.	Nënshkrimi i kontratave në mungesë të projekteve ekzekutive, rrezikon realizim të dobët të kontratave për punë të pa projektuara, studiuara dhe mund të rezultojë me shpenzime të paparashikuara apo ofrojnë vlerë të dobët për para.	Të sigurohet se me rastin e kontraktimit të punëve apo ndërtimit paraprakisht nivelet kompetente kanë hartuar projektin në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara. Në të kundërtën, procedurat e tilla nuk duhet të fillojnë.
Lidhja e kontratave duke anashkaluar procedurat e prokurimit.	Lidhja e kontratave në mungesë të procedurave të prokurimit përveç që dëmton transparencën, dhe eliminon konkurrencën po ashtu mund të rezultojë me vlerë të dobët për parën e shpenzuar.	Të sigurohet se janë zhvilluar procedurat e prokurimit për çdo blerje për të cilën kërkohet një gjë e tillë. Zhvillimi i procedurave dhe nënshkrimi i kontratës në përputhje me LPP është i obligueshëm dhe duhet të sigurojë transparencë, konkurrencë dhe vlerë për para.
Shpërblimi me kontratë i operatorëve ekonomik që nuk i kanë plotësuar kërkesat e përshtatshmërisë të vendosura në dosje të tenderit.	Anashkalimi i kriterëve të përcaktuara nga vet autoriteti kontraktues, rritë rrezikun e nënshkrimit të kontratave me operatorë ekonomik të pa përgjegjshëm, është diskriminim ndaj operatorëve tjerë konkurrentë, dhe po ashtu mund të rezultojë me mos përmbushje të kontratës.	Menaxhmentet përkatëse të OB-ve duhet të sigurojnë se gjatë vlerësimit janë zbatuar me përpikëri të gjitha kërkesat e rregulloreve të prokurimit dhe se asnjë operator i pa përgjegjshëm nuk është shpërblyer me kontratë.

<p>Mos caktimi i menaxherëve të kontratave, mungesa e planeve për menaxhimin e kontratave dhe menaxhimi i dobët i kontratave.</p>	<p>Mangësitë në procesin e menaxhimit të kontratave, rrezikojnë mos zbatimin e kontratave sipas kushteve kontraktuese, rrjedhimisht mos arritjen e objektivave dhe kërkesave të përcaktuara duke e rrezikuar edhe arritjen e vlerës për parane e shpenzuar.</p>	<p>Të sigurohet se pas lidhjes së çdo kontrate është caktuar personi përgjegjës për menaxhimin e saj, i cili duhet të bëjë përcjelljen e përmbushjes së kontratës sipas të gjitha kërkesave dhe standardeve të parapara dhe se ka parandaluar mundësitë për vonesa, ngecje apo mos realizim të kontratave.</p>
<p>Tejkalimi i sasive mbi 30% në kontrata kornizë dhe porosi të punëve pas skadimit të kontratës.</p>	<p>Vazhdimi i porosive mbi limitin e lejuar dhe pas skadimit të kontratës është në kundërshtim me ligjin dhe rrezikon që të eliminohet konkurrenca e lirë dhe transparenca.</p>	<p>Të sigurohet se në asnjë rast nuk tejkalohen sasitë e lejuara në kontratat kornizë dhe se pas arritjes së limitit të tejkalimit prej 30% apo skadimit të kontratës janë zhvilluar procedura të reja.</p>
<p>Mos caktimi i anëtarëve nga niveli qendror si pjesë përbërëse e komisioneve të vlerësimit të ofertave në proceset e prokurimit të zhvilluara në projektet e bashkë financuara me nivelin lokal.</p>	<p>Mos pjesëmarrja nga niveli qendror komisionet për hapje dhe vlerësimin në projektet e bashkë financuara, mund të rezultojë në përzgjedhjen e operatorëve të pa përgjegjshëm dhe mos informimin për dinamikën e projekteve.</p>	<p>Të sigurohet se në projektet e bashkë financuara janë caktuar anëtar të komisioneve edhe nga niveli qendror, në mënyrë që të ketë siguri për zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe të jenë të informuar me kohë me dinamikën e projekteve apo nëse duhet ndërmarrë ndonjë veprim.</p>

Rekomandim për organizatat buxhetore

- Ministritë që ndajnë fonde për bashkëfinancim të projekteve në komuna, të caktojnë nga një anëtarë në komisionet e hapjes dhe vlerësimit të ofertave për t'u siguruar se procedurat e prokurimit për projektet e bashkëfinancuara janë zhvilluar në përputhje me legjislacionin dhe të jenë të informuar me kohë për zhvillimin e projekteve; dhe
- Të reduktojnë sa më shumë përdorimin e procedurave të prokurimit për kontrata me vlerë minimale në mënyrë që përmes procedurave tjera të sigurojnë një konkurrencë më të hapur dhe të sigurohen çmime sa më të volitshme të tregut.

13 Aplikueshmëria e ligjeve dhe sfidat ligjore

Në auditimet e kryera janë identifikuar raste të mos pajtueshmërisë me dispozitat ligjore, përfshirë: mangësitë gjatë zbatimit të ligjeve të tatimit në pronë, dhënies së lejeve ndërtimore, shfrytëzimit të pronës publike, raportimit të PVF nga ndërmarrjet publike, si dhe procedimit të pagesave për kompenzime të ndryshme.

Nga raportet individuale ne kemi veçuar disa nga rastet më të rëndësishme:

(a) MASHT - Kompensimi i komisioneve të brendshme në kundërshtim me kërkesat ligjore

Sipas nenit 80 të LMFPF nuk lejohet kompensimi shtesë nëse një punonjës, shërbyes civil ose zyrtar i një autoriteti publik ose organizate buxhetore, sipas një akti të Qeverisë, kërkohet që të shërbejë në një komision, bord ose organ apo autoritet tjetër publik. Shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme të pozitës të cilën e mban punonjësi, shërbyesi civil ose zyrtari i sipër cekur.

Katër⁸ nga gjashtë Universitetet në kuadër të MASHT me aprovime të Këshillave Drejtues kishin përfshirë në rregullore kompensime shtesë për pjesëmarrje në disa lloje të komisioneve që konsiderohen si jo statutare. Komisionet e tilla ishin për pjesëmarrje në hapje dhe vlerësimin e ofertave të prokurimit, regjistrimin dhe vlerësimin e pasurisë, planifikimin e buxhetit, pranimin e studentëve të rinj, për ankesa dhe parashtrësia, rekrutim të stafit, ndarjen e bursave, hartimin e strategjive dhe rregulloreve mbështetëse etj. Këto komisione ishin emëruar nga Rektoret e këtyre Universiteteve dhe ishin paguar, për vitin 2019 në një vlerë totale prej 42,750€.

Kjo kishte ndodhur për shkak se Organet drejtuese të këtyre Universiteteve me rastin e aprovimit të rregulloreve përkatëse, nuk kishin marrë parasysh ndalesat ligjore për këto lloje të kompensimeve. Kompensimet shtesë për shërbimet që janë pjesë e detyrave të obligueshme të pozitës të cilin e mban punonjësi, nuk janë të mbështetura me bazë ligjore, dhe si të tilla mund ta dëmtojnë buxhetin e Universiteteve përkatëse - ministrisë.

(b) Ndërmarrjet Publike - Rregullimet e ndryshme ligjore për datat e raportimit dhe publikimit të PFV-ve të audituara

Bazuar në nenin 33.1 të Ligjit nr. Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (NP), Pasqyrat Financiare Vjetore të çdo Ndërmarrje Publike i nënshtrohen një auditimi të jashtëm të paraparë me ligj në pajtim me standardet e pranuar ndërkombëtare të auditimit. Ky auditim kryhet nga një auditor i pavarur, kompetent dhe i kualifikuar. Produkti përfundimtar i një auditimi të tillë duhet të jetë një opinion mbi vërtetësinë për Pasqyrat Vjetore Financiare përfshirë, këtu edhe Letër Menaxhmentin. Opinioni dhe Letra e Menaxhmentit duhet të dorëzohen tek Njësia e Politikave dhe Monitorim të NP-ve më së largu deri më 30 maj të vitit vijues për vitin paraprak. Përveç kësaj, Auditori i Përgjithshëm, Qeveria dhe Kuvendi mund të kryejnë çfarëdo lloj auditimi që konsiderojnë se është i nevojshëm. Bazuar në neni 17 të Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim (KRFA), afatet kohore për dorëzim dhe publikimin e pasqyrave financiare të shoqërive tregtare që auditohen në pajtim me SNA-të dhe në pajtim me nenin 7 paragrafi 1, dhe nenin 8 paragrafi 1 të këtij Ligji, dorëzohen dhe publikohen në KKRF dhe një kopje dorëzohet në Ministrinë

8 1) Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka", (2) Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", (3) Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani" dhe (4) Universiteti i Shkencave të aplikuara në Ferizaj.

përkatëse për Tregti dhe Industri jo më vonë se më 30 prill të vitit vijues.

Ligji nr. 03/L 048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi (me plotësim ndryshime) neni 48, për auditimet e rregullsisë, Auditori i Përgjithshëm i dorëzon raportet përfundimtare secilit institucion të audituar si dhe subjektit të cili i përgjigjet drejtpërdrejtë institucioni përkatës, si dhe Ministrin, jo më vonë se më 30 Qershor.

Prandaj siç shihet, për dorëzimin e raportit auditues të NP-ve me këto kërkesa ligjore përcaktohen tri afate të ndryshme: sipas Ligjit të KRFA- 30 Prilli; sipas Ligjit të NP-ve -30 Maji; dhe sipas LMFPP-30 Qershori. Kjo si rezultat i rregullimeve të ndryshme dhe mos harmonizimi i këtyre tri ligjeve që rregullojnë çështjen e raportimit të ndërmarrjeve publike.

Si pasojë e kolizionit ligjor në mes këtyre tri ligjeve, KKRF ka shqiptuar gjopa ndaj disa NP-ve të cilat janë vonuar për dorëzimin e PFV-ve të tyre brenda datave të përmendura me lartë (30 prill), edhe pse vonesat ishin shkaktuar për arsye të auditimeve të kryera nga ZKA në pajtim me ligjin në fuqi.

(c) Komunitat - Komunitat Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok nuk kanë zbatuar ligjet për mbledhjen e të hyrave (tatimi në pronë, leje ndërtimit, dhe dhënies në shfrytëzim të pronës publike)

Bazuar në nenin 2 të Ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme përcaktohet qartë se secila organizatë buxhetore duhet të mbledhë të hyra nga tatimi në pronën e paluajtshme. Po ashtu, edhe ligji nr. 04/L-110 për ndërtimet, në nenet 1 dhe 2 ka përcaktuar qëllimin e lëshimit të lejeve ndërtimore. Ndërsa Ligji nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, rregullon mënyrën dhe përcakton procedurat dhe format për dhënien në shfrytëzim të pronës.

Gjatë vitit 2019 si edhe në vitet e mëparshme, Komunitat Zecan, Leposaviq dhe Zubin Potok ende nuk filluar të mbledhin të hyra nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, pronat e dhëna në shfrytëzim si dhe nuk kanë nxjerrë rregullore të brendshme për taksat, tarifatat dhe ngarkesat e qytetarëve për shërbimet e përfituara publike. Prandaj, edhe niveli i mbledhjes së të hyrave vetjake është shumë i ultë. Kjo ka ndodhur pasi Komunitat ende nuk kanë vendosur politika të zbatimit të ligjeve dhe nuk kanë ndërmarrë veprime konkrete për arkëtimin e të hyrave nga këto veprimtari që kanë ndikim të rëndësishëm në krijimin e buxhetit të komunës dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Mos zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve për mbledhjen e tatimeve në pronë, taksave për leje të ndërtimit dhe të taksave e tarifave tjera nga ana e komunave, tregon një çasje mos përfillëse ndaj kërkesave ligjore në këto fusha. Kjo rritë rrezikun e pa pajtueshmërisë me ligjet e aplikueshme dhe redukton nivelin e të hyrave vetjake.

(d) Pagesa e zyrtarëve të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME) nga ana e komunave, pa posedimin e informatave nëse zjarrfikësit kanë vijuar rregullisht në punë

Ne kemi vërejtur se Komunitat i ekzekutojnë pagat për zjarrfikësit dhe nuk ka dosje të personelit/kontrata e as informata në lidhje me punën që bëjnë këta punëtor (vijueshmërinë në punë). Rrjedhimisht ne kemi rekomanduar që si fazë kalimtare, deri të bëhet bartja e buxhetit tek AME, Komunitat me rastin e ekzekutimit të pagave, të kërkojnë nga njësitë zjarrfikëse të paktën informatat bazike

(kontratat dhe evidencat për vijueshmëri në punë të punëtorëve) për t'i arsyetuar pagat. Pagesa për zyrtarët, në mungesë të kontratave dhe raporteve mujore për angazhimin, mund të rezultojë me pamundësinë për të justifikuar pagën dhe shtesat eventuale.

Rekomandimet për Qeverinë, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Ekonomisë

- Qeveria të inicioj ndryshimin e Ligjit të NP-ve dhe të bëjë harmonizimet përkatëse ligjore të datave të raportimeve të auditimit financiar, apo të precizohet/qartësohet mbizotërimi i rregullimeve të përcaktuara me njërin apo tjetrin ligj që rregullojnë këtë çështje;
- Qeveria të bëjë interpretim ligjor të mandatit dhe kompetencave të KKRF-së ndërlidhur me auditimin e PVF-ve të NP-ve kur auditohen nga ZKA. Ky interpretim të jetë obligues për KKRF-në, apo në të kundërtën të inicioj plotësim/ndryshimin e ligjit të KRFA-së për t'i eliminuar kundërthëniet e lartpërmendura; dhe
- Qeveria në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, në pajtim me ligjet në fuqi dhe vendimin e Qeverisë të ndërmarrë hapat e nevojshme për transferimin e buxhetit nga komunat në AME, respektivisht në MPB.

Rekomandimet për Komuna dhe Ministrinë e Pushtetit Lokal

Kryetarët e komunave Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok duhet të sigurojnë zbatimin e ligjeve për mbledhjen e të hyrave, që kanë për qëllim në radhë të parë zbatimin e kërkesave ligjore si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunave përkatëse. Njëherit, duhet të iniciojnë pa vonesë hartimin e rregulloreve të brendshme për taksat, tarifatat dhe ngarkesat e qytetarëve për shërbimet e ofruara publike.

Rekomandimi për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës

Ministri i arsimit duhet të merr masa të menjëhershme që të ndaloj të gjitha pagesat e paligjshme për kompensimin e komisioneve të brendshme në universitetet e përmendura më lart, dhe të kërkoj që statutet e tyre të harmonizohen me ligj.

14 Auditimet e performancës

Zyra Kombëtare e Auditimit, ndër vite është duke i dhënë rëndësi të veçantë auditimeve të performancës të cilat janë një faktor i rëndësishëm për të bërë ndryshim në jetën e qytetarëve. Këto auditime në veçanti vlerësojnë nëse fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe efektive dhe në dobi të mirëqenies së qytetarëve. Sapo të bëhen publike rezultatet e auditimit të ZKA-së, Kuvendi dhe qytetarët do të jenë në gjendje që t'i mbajnë llogaridhënës administruesit e burimeve publike.

Për të arritur këtë qëllim, ZKA për sezonin auditues 2019-2020 ka mbuluar fusha me interes shoqëror, ekonomik, mirëqenie sociale, shëndetësi dhe siguri, teknologji të informacionit dhe fushën e prokurimit publik. Përzgjedhja e temave në auditimin e performancës është bazuar në fusha të rëndësishme materiale në aspektin financiar dhe social, dhe po ashtu, duke marrë në konsideratë edhe kërkesat dhe interesin e organizatave të shoqërisë civile dhe donatorëve. Përmes këtyre auditimeve, Zyra Kombëtare e Auditimit ka synuar të promovojë efikasitetin, llogaridhënien, efektivitetin dhe transparencën e administratës publike.

Gjatë sezonit raportues, janë publikuar 13 raporte të auditimit të performancës të fushave të

ndryshme apo rreth 23% me shumë krahas vitit të kaluar. Në vijim, shkurtimisht është paraqitur përmbajtja e raporteve të publikuara të performancës, përfshirë objektivin, gjetjet dhe mesazhet e auditimit.

Tema 1 - Sistemi i përcaktimit të Tarifave të Energjisë Elektrike, Termike dhe atyre të Ujësjellësit

Shërbimet publike janë aktivitetet në shërbim të qytetarëve për ofrimin e të mirave apo shërbimeve publike që konsiderohen të rëndësishme vitale për interesin e tyre. Këto të mira apo shërbime publike dhe qasja e tyre efikase dhe efektive tek qytetarët mundësojnë një mirëqenie më të mirë për të gjithë. Megjithatë, për shërbimet publike të ofruara, qytetarët duhet të paguajnë një tarifë dhe përcaktimi i vlerës së tyre duhet të jetë në përputhje me llogaritjet sipas harxhimeve reale dhe natyrës së shërbimeve.

Mesazhi i auditimit - *Auditimi ka konstatuar që përkundër progresit të arritur nga rregullatorët në procesin e përcaktimit të tarifave, ka disa mangësi që ndikojnë në saktësinë e tarifave të aprovuara dhe të cilat rrezikojnë që tarifat të mos jenë drejtë të përcaktuara. Gjatë procesit të përcaktimit të tarifave, rregullatorët nuk kanë arritur të sigurojnë transparencë të mjaftueshme si dhe vendosje plotësisht të drejtë dhe të saktë të tarifave.*

Raporti thekson se Rregullatorët dhe ofruesit e shërbimeve publike nuk kanë zhvilluar një proces të identifikimit të sasisë së konsumuar të shërbimeve nga konsumatorët të cilët janë të liruar nga pagesa e shërbimeve publike për t'u kompensuar nga autoritetet përkatëse. Përcaktimi i kostove operative, kostove kapitale dhe koeficientëve tjerë të rëndësishëm financiar nuk aprovohet plotësisht bazuar në analiza përkatëse dhe të dokumentuara me sqarime të mjaftueshme dhe të qarta. Andaj, përcaktimi i tarifave për shërbimet publike nuk është bërë në plotësi sipas kriterëve të matshme me shpenzimet reale

Tema 2 - Siguria në Trafikun Rrugor

Siguria në trafikun rrugor është një nga problemet kryesore me ndikim të madh për shëndetin publik dhe zhvillim të shoqërive në mbarë botën. Më shumë se 1.3 milion njerëz vdesin çdo vit nëpër rrugët e botës. Lëndimet në trafikun rrugor krijojnë faktorin kryesor të vdekjeve globalisht. Vdekjet dhe lëndimet serioze në aksidentet rrugore mund të parandalohen nëse menaxhohen shkaktarët e aksidenteve në mënyrë që ato të mos tejkalojnë tolerancat njerëzore në aksidente.

Mesazhi i auditimit – *Auditimi ka konkluduar se mungesa e zbatimit, organizimit dhe koordinimit të aktiviteteve nga autoritetet përgjegjëse e bënë të pasigurt trafikun rrugor për pjesëmarrësit në trafik. Policia e Kosovës, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit dhe komunat, të cilat duhet të sigurojnë rrugë dhe infrastrukturë të sigurt për pjesëmarrësit në trafik, nuk janë treguar efektive dhe nuk po bëjnë sa duhet për të rritur sigurinë në trafik.*

Mbulimi i rrugëve me kontrolle policore në trafikun rrugor në rajonin e Prishtinës nuk është i mjaftueshëm. Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës karakterizohet me të dhëna jo të plota dhe të sakta sa i përket analizimit dhe identifikimit të shkaktarëve dhe faktorëve të aksidenteve në trafikun rrugor. Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit nuk kishte bërë përpjekje të mjaftueshme për identifikimin dhe menaxhimin e vendeve të rrezikshme në rrugë. Për më shumë, kjo ministri nuk kishte arritur të funksionalizojë Këshillin për Siguri në Trafikun Rrugor deri në fund të vitit 2018. Monitorimi ndaj qendrave për kontrolle teknike të automjeteve nga ministria dhe subjekti i autorizuar për mbikëqyrje ishte i mangët. Po ashtu, edhe Komuna e Prishtinës nuk ka arritur që të siguroj mirëmbajtje të duhur dhe permanente për të gjitha rrugët për të cilat është përgjegjëse, përfshirë edhe sinjalizimin.

Tema 3 - Siguria e Ushqimit - Rast studimi: produktet e mishit dhe të grurit

Ushqimi i sigurt është kyç për jetë të shëndetshme për secilin qytetar. Siguria në ushqim duhet të ofrohet nga organet shtetërore përmes kontrolleve që tregojnë se ushqimi në treg ka kaluar të gjithë hapat e kontrollit dhe është i gatshëm për konsum.

Mesazhi i auditimit - *Auditimi ka nxjerrë në pah se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ende nuk e ka plotësisht funksional sistemin e sigurisë në tërë zinxhirin ushqimor dhe për pasojë nuk ka siguri se ushqimi në treg është mjaftueshëm i kontrolluar dhe është i sigurt për konsumatorin.*

Ka ende mangësi pasi procedurat e vendosura nuk mbulojnë tërë procesin e sigurisë ushqimore. Por, edhe ato procedura që ekzistojnë, nuk janë zbatuar mjaftueshëm për të dhënë siguri se ushqimi në treg është i kontrolluar mjaftueshëm dhe ka siguri për konsumatorin. Mangësitë janë vërejtur në procesin e planifikimit të kontrolleve dhe mungesën e analizës së rreziqeve. Më tutje, vlerësimi i sigurisë në ushqim përmes listave të kontrollit nuk i përfshinë të gjitha parimet e Analizës së Rrezikut dhe Pikave të Kontrollit Kritik (HACCP) të cilat janë kërkesa që dalin edhe nga Ligji i Ushqimit. Po ashtu, Inspektorët komunal nuk janë transferuar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë si dhe nuk ka koordinim të mirë të kontrolleve mes nivelit qendror dhe atij lokal. Kjo rritë mundësinë e kontrolleve jo efektive sikurse në rastin e tregjeve të kafshëve dhe produkteve me prejardhje bimore që nuk kontrollohen nga asnjëri nivel.

Tema 4 - Sistemi i kontrollit dhe monitorimit të cilësisë së derivateve të naftës

Kosova është plotësisht e varur nga produktet e importuara të naftës nga të gjitha vendet dhe rajonet fqinje, si dhe pothuajse të gjitha importet e naftës realizohen përmes transportit rrugor. Importi i derivateve të naftës është në rritje dhe kjo nënkupton se kontrollet dhe monitorimi i cilësisë së derivateve para se atyre tu miratohet hyrja në territorin e Kosovës dhe gjatë kohës sa janë në qarkullim në tregun e brendshëm duhet të jenë funksionale dhe të qëndrueshme.

Mesazhi i auditimit - *Raporti ka nxjerr në pah se kontrolli dhe monitorimi i derivateve të naftës, që në import menaxhohet nga Dogana e Kosovës dhe në tregun e brendshëm nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, është përcjellë me mangësi të shumta, dhe kjo ka ndikuar që të mos sigurohet cilësia e derivateve të naftës në import dhe në tregun e brendshëm.*

Në pjesën e importit cilësia e derivateve të naftës nuk është arritur të sigurohet si rezultat i lejimit të importimit të derivateve të naftës duke u bazuar në testim të një numri të vogël të parametrave, në sistem i cili jo gjithmonë ka evidentuar trupat që kanë bërë marrjen e mostrave dhe me raste kur trupat nuk kanë mundur të identifikohen, si dhe në mungesë të akreditimit të laboratorit. Cilësia e derivateve të naftës në tregun e brendshëm, po ashtu nuk ka arritur të sigurohet për shkak të testimit të një numri të vogël të parametrave, mungesës së monitorimit adekuat të procesit të akreditimit, si dhe shkeljeve të kërkesave të autorizimit nga Laboratorët dhe funksionimit pa autorizim të Trupave Inspektuese. Mangësitë e identifikuar, e vejnë në pikëpyetje kompetencën dhe besueshmërinë e marrjes së mostrave dhe testimit të tyre, dhe bëjnë që sistemi të mos jetë në gjendje të sigurojë cilësi të derivateve të naftës për qytetarët e Kosovës.

Tema 5 - Menaxhimi i Mirëmbajtjes së Institucioneve Publike Arsimore

Një mjedis i shëndetshëm shkollor është domosdoshmëri për garantimin e zhvillimit të aktivitetit mësimor dhe paraqet performancën institucionale edukative dhe zhvillimin kulturor e social të komunitetit. Hapësirat e shkollës përcaktojnë mënyrën se si reagojnë pjesëmarrësit brenda këtij dimensionit, ato afektojnë shëndetin, sjelljen e tyre, duke ndikuar drejtpërdrejtë edhe në procesin dhe cilësinë e mësimin.

Mesazhi i auditimit - *Auditimi ka konstatuar se institucionet publike nuk kanë siguruar mirëmbajtje në nivel të duhur në institucionet arsimore dhe për pasojë nuk ofrojnë kushtet elementare për zhvillimin e procesit mësimor. Nuk ka mirëmbajtje të vazhdueshme për të mundësuar zhvillimin e mësimin në një ambient të shëndetshëm dhe me kushte themelore mësimore.*

Nga 18 objektet shkollore që janë vlerësuar, vetëm shtatë (7) prej tyre janë në nivel të pranueshëm për zhvillimin e aktiviteteve mësimore. Përderisa, në objektet tjera shkollore mangësi të theksuara kishte në furnizimin me materiale dhe pajisje higjienike, gëlqerosjen vjetore të mureve dhe dezinfektimin e tyre, gjendjen e inventarit shkollor, nyjeve sanitare, ajrosjen e objektit dhe ventilimin e tualeteve. Raporti thekson se institucionet qendrore dhe lokale nuk kanë arritur që të koordinojnë, mbikëqyrin dhe delegojnë detyrat rreth inspektimeve që duhet kryer në nivele të ndryshme dhe nuk kanë hartuar infrastrukturë të plotë ligjore. Menaxhimi i mirëmbajtjes ka qenë sfidues për shumicën e shkollave në aspektin e planifikimit të aktiviteteve dhe ndërmarrjes së masave për të siguruar shërbime më të mira të mirëmbajtjes.

Tema 6 - Menaxhimi i kontratave publike të ndërtimit

Prokurimi publik ka për qëllim të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve tjera të organizatave buxhetore në Kosovë. Kjo arrihet duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet dhe organizatat buxhetore. Në institucionet publike përmes procedurave të prokurimit publik kontraktohen rreth 30% e buxhetit të vendit.

Mesazhi i auditimit - *Raporti ka theksuar se kontratat publike të ndërtimit nuk ishin menaxhuar në mënyrë efikase dhe efektive nga organizatat buxhetore.*

Auditimi ka evidentuar dobësi thelbësore në procesin e menaxhimit të kontratave publike të ndërtimit në të gjitha fazat. Entitetet e audituara nuk kishin kryer vizita në terren për të verifikuar përshtatshmërinë e lokacionit, bashkëpunimi në mes palëve të përfshira në memorandum të mirëkuptimit nuk ishte në nivelin e duhur dhe mjetet ligjore që ndihmojnë në realizimin e kontratave nuk kishin efektin e duhur. Për më tepër, dështimi i marrjes së lejeve të ndërtimit dhe aplikimi i duhur i të gjitha dokumenteve të nevojshme për ndërtim ka rezultuar që projektet të pësojnë vonesa në realizim duke filluar nga 2 deri në 22 muaj.

Tema 7 - Projektet e financuara nga grantet e DEMOS

Në vitin 2017, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) ishin pajtuar për krijimin dhe financimin e një sistemi të grantit të performancës për komunat. Granti i performancës ka në dispozicion një buxhet vjetor prej rreth 2.25 milionë euro, për vitet 2018-2021. Të gjitha (38) komunat e Kosovës gëzojnë të drejtën e aplikimit për grantin e performancës.

Mesazhi i auditimit - *Auditimi ka nxjerrë në pah se të gjitha projektet e audituara në të cilat është investuar nga granti i performancës janë shpenzuar për qëllimet e grantit, po ashtu kanë arritur të funksionalizohen dhe të lëshohen në përdorim për qytetarët brenda kohës së dakorduar me donatorin.*

Mirëpo, pavarësisht kësaj auditimi ka identifikuar disa dobësi siç janë: vonesa në dërgimin e mallit, mungesa e vëmendjes në mbikëqyrjen e projekteve nga menaxherët e kontratave, si dhe mospërdorimi i duhur i fjalorit të përbashkët të prokurimit gjatë vlerësimit të tenderëve. Pos kësaj, komunat e audituara nuk kanë arritur të dokumentojnë mënyrën e prioritizimit të investimeve në projektet përkatëse, po ashtu edhe përfshirjen e qytetarët në vendimmarrje. Një situatë ku komunat nuk mund të dokumentojnë prioritizimin e projekteve, mund të rezultojë në investime jo në pajtim me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve.

Tema 8 - Zbatimi i rekomandimeve të raportit "Fondi Zhvillimor" dhe efektet e fondit

Fondi Zhvillimor i Mirëbesimit (Fondi) është themeluar në vitin 2013 me marrëveshjen në mes të Bashkimit Evropian dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës. Fondi ka për qëllim të promovojë zhvillimin social dhe ekonomik në komunat Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan nga i cili do të përfitojë popullata lokale e këtyre komunave.

Është në interes të qytetarëve që komunat t'i zbatojnë projektet sa më parë në mënyrë që t'iu sigurojnë qytetarëve kushte për zhvillim social e ekonomik, dy përfitimet që janë synuar me themelimin e këtij Fondi, gjithnjë duke i respektuar procedurat e kërkuara me ligjet e Kosovës.

Mesazhi i auditimit - Konkluzioni i auditimit përcjellës është se vetëm katër (4) nga 13 rekomandimet e dhëna ishin zbatuar plotësisht, pesë (5) pjesërisht ndërsa katër (4) rekomandime nuk ishin zbatuar fare. Progresi ishte i limituar dhe mbetet hapësirë për menaxhim më të mirë dhe kontroll financiar gjatë zbatimit të projekteve të financuara nga ky fond.

Bordi Menaxhues i Fondit Zhvillimor nuk kishte mundur të zbatojë të gjitha rekomandimet lidhur me monitorimin e projekteve, shqyrtimin e kërkesave në nivel profesional teknik si dhe kërkesën për raportim të komunave mbi progresin e projekteve. Kjo është pamundësuar, në mes tjerash, si rezultat i dorëheqjeve të Kryetarëve të Komunave e që është pasuar me procesin e zgjedhjeve lokale dhe zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Ministria e Financave projektet e financuara nga Fondi i kishte përfshirë në tabelat e buxhetit, kishte instaluar Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës tek katër komunat si dhe kishte ofruar trajnime relevante. Gjithashtu, kishte zbatuar pjesërisht rekomandimin sa i përket kategorizimit të shpenzimeve në kode të duhura. Komunat nuk e kishin zbatuar rekomandimin e dëgjimeve publike. Asnjëra komunë nuk e kishte kryer një analizë të rrethanave që kishin shkaktuar prolongimin e zbatimit ose mos zbatimin e projekteve, rrjedhimisht asnjë masë lidhur me rritjen e efikasitetit nuk ishte ndërmarrë.

Për më shumë, komunat nuk ishin mjaft efikase në vënien në dispozicion të projekteve të financuara nga Fondi e në disa raste nuk ishin as efektive. Nga disa projekte qytetarët nuk kishin asnjë dobi edhe pse ishin përfunduar pasi që ende nuk ishin në dispozicion të tyre.

Tema 9 - Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2018 - 2020 në sektorin e arsimit dhe të infrastrukturës

Çdo qeveri vepron në kuadër të një kornize të gjithmbarshme në të cilën përcaktohen politikat dhe prioritetet afatgjate dhe afatmesme, dhe e cila i ndan resurset sipas politikave dhe prioritetëve në mënyrë të tillë që të sigurojë të ardhme të mirë për qytetarët. Planifikimi i aktiviteteve dhe buxhetit është proces i përgatitjes së planeve strategjike për periudha kohore të përcaktuara (afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata).

Mesazhi i auditimit - Raporti i auditimit ka theksuar se Korniza Afatmesme e Shpenzimeve nuk trajtohet mjaftueshëm për të siguruar planifikime buxhetore në përputhje me prioritetet strategjike në sektorin e arsimit dhe të infrastrukturës. Auditimi vë në pah se planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i realizimit të objektivave strategjike nuk është në nivelin e duhur.

Kjo ka bërë që të zbehet rëndësia dhe qëllimi që ka Korniza Afatmesme e Shpenzimeve në planifikim afatgjatë të objektivave dhe buxhetit. Ministria e Financave bën finalizimin e buxhetit në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve duke u bazuar në projeksionet makroekonomike dhe projeksionet e buxhetit vjetor paraprak për vitet e ardhshme, por jo duke u bazuar edhe në analiza të mirëfillta të kërkesave nga organizatat buxhetore. Ministria e Financave ka bërë aprovimin e projekteve të caktuara të cilat nuk janë objektiva strategjike të nivelit qendror. Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit dhe Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, nuk kanë arritur të bëjnë planifikim të duhur financiar të projekteve/aktiviteteve dhe realizim të buxhetit për projekte të caktuara duke rrezikuar realizimin e objektivave prioritare strategjike qeveritare. Për rrjedhojë, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve nuk është plotësisht në funksion të një planifikimi të qëndrueshëm.

Tema 10 - Menaxhimi i Obligimeve Tatimore në Sistemet e Informacionit të Administratës Tatimore të Kosovës

Institucionet publike duhet t'i sigurojnë tatimpaguesit se sistemet të cilat mbështesin mbledhjen dhe regjistrimin e të hyrave dhe borxheve tatimore ruajnë integritetin, konfidencialitetin dhe disponueshmërinë e të dhënave. Nga rreziqet e identifikuar nga auditimi, tregojnë që ka nevojë për përmirësime në menaxhimin e sistemeve të informacionit, nëpërmjet të cilave administrohen detyrimet tatimore.

Mesazhi i auditimit - Konkluzioni i auditimit është se Administrata Tatimore e Kosovës ka disa mangësi, që ndërlihen me kontrollet e aplikacionit, kontrollet e qasjes logjike në sisteme, si dhe me sigurinë e informacionit dhe vazhdimësinë e sistemeve. Për rrjedhojë, ekziston rreziku që sistemet të ekspozohen ndaj rreziqeve të humbjes së integritetit dhe konfidencialitetit të të dhënave dhe disponueshmërisë së sistemeve.

Këto mangësi ndikojnë në paraqitjen e një pasqyre jo të saktë dhe jo të plotë të llogarive të deklaratave tatimore, rreziqe të funksionimit të sistemeve të informacionit, humbje të integritetit dhe konfidencialitetit të të dhënave dhe rreziqe në sigurinë e informacionit dhe vazhdimësinë e punës së sistemeve.

Tema 11 - Organizimi dhe menaxhimi i investimeve të teknologjisë së informacionit në institucionet publike

Për të siguruar qeverisje të mirë, rol të rëndësishëm ka teknologjia e informacionit, si një instrument i fuqishëm në përkrahje të transparencës, përgjegjësisë dhe efikasitetit të qeverisë dhe në funksion të përmirësimit të jetës së qytetarëve. Institucionet e Kosovës, gjatë periudhës 2015-2018, kishin shpenzuar rreth 49 milion euro në teknologji të informacionit.

Mesazhi i auditimit - Auditimi ka nxjerrë në pah se, mungesa e organizimit dhe koordinimit mes institucioneve publike ka krijuar shpenzime të panevojshme në fushën e teknologjisë së informacionit.

Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka arritur të miratojë Strategjinë e Qeverisjes Elektronike e cila është hartuar nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit. Në mungesë të saj, Qeveria nuk ka një plan të prioriteteve për investime në fushën e TI-së. Kjo situatë ka mundësuar që institucionet publike të zhvillojnë projekte paralele për nevojat e tyre, duke krijuar kështu shpenzime të panevojshme dhe investime të dyfishta. Fillimisht, nuk ka regjistër të projekteve të TI-së, si në nivel shtetëror, ashtu edhe në nivel të organizatave buxhetore. Kjo e pamundëson identifikimin e saktë të gjendjes ekzistuese.

Institucionet publike kanë hyrë në investime pa bërë identifikimin e nevojave për projekte, analiza të mirëfillta të fizibilitetit për zhvillimin e projekteve si dhe pa bërë analiza paraprake dhe hulumtim të çmimeve të tregut. Po ashtu, ministritë me departamentet e tyre dhe agjencitë nuk bashkëpunojnë për shfrytëzim më optimal të infrastrukturës së TI-së. Edhe në komunat të cilat kanë qenë subjekt i auditimit kemi hasur në mangësi, duke filluar nga planifikimi strategjik, politikat dhe procedurat e TI-së si dhe në menaxhimin e investimeve në fushën e TI-së.

Tema 12 - Qeverisja, menaxhimi i operacioneve dhe siguria e sistemeve në ASK

Qëllimi i statistikave zyrtare është mbledhja, përpunimi dhe shpërndarja e të dhënave për qëllime statistikore për aktivitetet ekonomike, sociale dhe kushtet e përgjithshme në Republikën e Kosovës. Agjencia e Statistikave të Kosovës është bartëse dhe shpërndarëse e statistikave zyrtare dhe koordinator i statistikave zyrtare të Kosovës, e cila vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Mesazhi i auditimit - *Auditimi ka konkluduar se mënyra ekzistuese e menaxhimit të teknologjisë së informacionit nuk ka ofruar mjaftueshëm ambient të sigurt për ruajtjen e integritetit të të dhënave. Agjencia e Statistikave të Kosovës në përgjithësi nuk kishte vendosur mekanizmat e nevojshëm për kontrollet në të cilin aktivitetet e TI-së janë zhvilluar, operuar, menaxhuar dhe mirëmbajtur.*

Agjencia e Statistikave të Kosovës ka vështirësi në menaxhimin e resurseve të teknologjisë së informacionit, ka mungesë të vlerësimit adekuat të nevojave në fushën e TI-së, ndarje joadekuatë të detyrave dhe përgjegjësive të stafit të TI-së si dhe staf të pamjaftueshëm të TI-së. Po ashtu, menaxhimi i aktiviteteve të TI-së nuk është mjaftueshëm i bazuar në politika, procedura dhe procese të operimit. Trajtimi i incidenteve dhe problemeve bazohet në kërkesa të çastit si dhe mungon një regjistër i tyre. Nuk ka proces adekuat për menaxhimin e ndryshimeve, zhvillimit dhe testimit të aplikacioneve softuerike, si dhe mungon plani i vazhdimësisë së proceseve të punës në rast të ndonjë katastrofe natyrore, gabimi njerëzor apo dështimit të sistemeve të informacionit.

Auditimi gjithashtu ka treguar se Agjencia e Statistikave të Kosovës nuk ka mekanizma efektiv për të vlerësuar rrezikun e sigurisë së informacionit. Nuk kishte marrë hapat e mjaftueshme për t'u siguruar që informacioni nuk ekspozohet ndaj palëve të paautorizuara si dhe nuk ka kontroll të mjaftueshëm mbi të dhënat që dalin/hyjnë nga/në Agjencinë e Statistikave të Kosovës. Mungojnë politikat që trajtojnë çështjet e sigurisë së informacionit.

Tema 13 - Efektiviteti i ndërlidhjes së arsimit dhe aftësimit profesional me nevojat e tregut të punës

Qëllim parësor i Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (AAP) është përgatitja e kuadrove për treg të punës, ndërkaq është më se e domosdoshme që sistemi i AAP-së të jetë në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit. Po ashtu, AAP-ja duhet të shikohet si mundësi përmes së cilës arrihet përmirësimi i performancës dhe avancimi në punë.

Mesazhi i auditimit - *Sistemi aktual i arsimit dhe aftësimit profesional nuk është në gjendje t'i përgjigjet nevojave dhe kërkesave të tregut të punës. Përkundër përpjekjeve për të ndërlidhur njohuritë dhe aftësitë profesionale me nevojat dhe kërkesat e vazhdueshme të tregut të punës, ky sistem është përcjellë me mangësi të shumta, dhe kjo ka ndikuar që institucionet përgjegjëse të mos jenë të suksesshme në arritjen e qëllimeve.*

Pavarësisht bashkëpunimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me akterët tjerë me qëllimin për të rishikuar kurrikulat e profileve të arsimit dhe aftësimit profesional, e sidomos për të bazuar kurrikulat e rishikuara në zhvillimin e standardeve të profesionit, ky qëllim nuk u arrit. Po ashtu, mësimi praktik në punëtoritë e Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe praktika profesionale në biznese janë realizuar me vështirësi dhe ngecje të mëdha. Institucionet përgjegjëse nuk kanë arritur të ofrojnë mundësi efektive për përvetësimin dhe zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive dhe nuk kanë siguruar se janë krijuar kushtet e nevojshme në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional për zbatimin e formave dualiste të arsimit, kushte këto që mundësojnë realizimin e mësimi praktik në ambientet e shkollës dhe praktikës profesionale në biznese.

Në 13 raportet e auditimit të performancës, Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë 198 rekomandime për përmirësimin e aspekteve të ndryshme në administratën publike.

Rekomandojmë Kuvendin e Kosovës që:

Përmes Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe komisioneve relevante për fusha përkatëse, të shqyrtojnë raportet e auditimit të performancës dhe të mbajnë llogaridhënës krerët e institucioneve publike për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të dhëna në raportet e performancës.

Rekomandojmë Qeverinë dhe Komunitetin që:

T'i analizojnë rekomandimet të cilat kanë rezultuar nga auditimet e performancës dhe të përgatisin dhe monitorojnë planet e veprimit për zbatimin e tyre. Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve duhet të bëhet duke caktuar dhe mbajtur përgjegjës funksionet përkatëse në organizatë përmes raportimit të rregullt.

15 Ndërmarrjet publike

Zyra Kombëtare e Auditimit këtë sezonë ka audituar Pasqyrat Financiare Vjetore të 14 Ndërmarrjeve Publike (NP) për vitin 2019. Pprej tyre, tri (3) janë audituar për herë të parë nga ZKA, ndërsa 11 të tjera janë audituar edhe në vitet paraprahe.

Auditimi i PFV-ve të vitit 2019, ka nxjerrë në pah se sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit në NP ka mangësi të mëdha dhe nevojë për përmirësime të thelbësore. Fakti që për 13 NP kemi dhënë opinione të modifikuara, tregon për cilësinë jo të mirë të sistemeve financiare në NP. Të dhënat financiare të raportuara në PFV individuale, kishin gabime materiale. Kjo, dobëson cilësinë e raportimit financiar dhe transparencën lidhur me menaxhimin e fondeve dhe të pasurive publike.

Për më shumë, në shumicën e ndërmarrjeve publike ende nuk ishte instaluar një mekanizëm i qeverisjes së mirë i cili do t'i kontribuonte zbatimit të politikave efektive që sigurojnë se objektivat janë duke u arritur në mënyrë ekonomike dhe efikase.

Mungesa e ndarjes së detyrave në mënyrë adekuate, e publikimeve të rregulloreve, e zyrtarëve certifikues, e raporteve dhe informatave të nevojshme për qëllime të transparencës, auditimeve të brendshme jo efektive, dhe prezantimeve jo të sakta të transaksioneve dhe të zërave në pasqyra financiare, duke përfshirë edhe vetë PFV-të me gabime dhe keq deklarime, tregojnë për domosdoshmërinë e reformave të thella në ndërmarrjet publike.

Proceset ekzistuese të përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore nuk ishin adekuate. Ato nuk përmbajnë analiza të mjaftueshme dhe nuk marrin në konsideratë rreziqet të cilat mund të ndodhin dhe të rrezikojnë NP-të në arritjen e objektivave të përcaktuara për të prezantuar gjendjen e vërtetë dhe të drejt të transaksioneve, zërave dhe pasqyrave financiare.

Për të përmirësuar mënyrën aktuale të menaxhimit të Ndërmarrjeve Publike, ne kemi dhënë një numër të rekomandimeve, të cilat janë prezantuar në raportet individuale të auditimit dhe janë adresuar tek personat e ngarkuar me përgjegjësi menaxhuese të NP-ve dhe tek aksionarët e tyre.

15.1 Opinionet e auditimit për ndërmarrjet publike

Në tabelën në vijim është dhënë një pasqyrë e opinioneve për PFV-të e vitit 2019.

Tabela 29 - Opinionet e dhëna për Ndërmarrjet Publike të audituara

Nr.	Ndërmarrjet e audituara	Opinionit i auditimit
1	KMDK sh.a.	I Kualifikuar
2	Stacioni i Autobusëve Prishtinë sh.a.	I Kualifikuar
3	Hortikultura sh.a. Prishtinë	I Kualifikuar
4	Hekurudhat e Kosovës Trainkos sh.a.	I Kualifikuar
5	KRU Hidroregjioni Jugor sh.a. Prizren	I Kundërt
6	Posta e Kosovës sh.a	I Kundërt
7	Telekomi i Kosovës sh.a	I Kundërt
8	KRU Prishtina sh.a.	I Kundërt
9	KRM Pastrimi sh.a	I Kundërt
10.	KRM Uniteti sha. Mitrovicë	Mohim i Opinionit
11.	KRU Drini i Bardhë sh.a. Pejë	I Kundërt
12.	KRU Bifurkacioni sh.a	I kundërt
13.	KRU Hidromorava sh.a	I kualifikuar
14.	Ndërmarrja e Re Energjetike e Kosovës	I Pamodifikuar me theksim të çështjes

Parregullsitë e identifikuar gjatë auditimit të cilat kanë shkaktuar modifikimin e opinionit apo theksimin e çështjes, kanë të bëjnë me shkaqet si në vijim:

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes - ishte dhënë për shkak të ngjarjes pas periudhës raportuese, ku investitori i projektit Kosova e Re kishte deklaruar tërheqjen e tij nga ndërtimi i termocentralit Kosova e Re dhe rrjedhimisht ende nuk është definuar se si do jetë e ardhmja e kësaj ndërmarrjes (Ndërmarrja e Re Energjetike e Kosovës).

Opinionet e Kualifikuara - janë dhënë për shkak të mos rivlerësimit të pasurive jo qarkulluese për më gjatë se pesë vite, respektivisht që nga transformimi i tyre në vitin 2007 kur ishin nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për prezantim jo të drejt të rrjedhës së parasë sipas aktiviteteve, për mos njohje të pasurive të pranuar dhe në shfrytëzim sipas kërkesave të kornizës konceptuale për raportim financiar, njohja e të hyrës si e hyrë e shtyrë, njohja e objektit me qira si pasuri afat shkurtër dhe njëkohësisht afatgjatë, nuk u janë zbritur konsumatorëve përkatës obligimet e kryera ndaj kompanisë, mos korrigjimi i mbivlerësimeve të zërit të kapitalin rezervë, pronës pajisjeve dhe impianteve edhe për periudhën paraprake duke mos respektuar kërkesën për korrigjime retrospektive dhe shënimeve shpjeguese që nuk ishin të plota dhe të sakta.

Në këtë grup bëjnë pjesë pesë (5) ndërmarrje: Hekurudhat e Kosovës - Trainkos sh.a, Hortikultura sh.a, KMDK sh.a, Stacioni i Autobusëve të Prishtinës sh.a, dhe KRU Hidromorava sh.a.

Opinionet e Kundërta - janë dhënë për shkak se informatat lidhur me llogaritë e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme, pasuritë jo qarkulluese, të hyrat e shtyra nga grantet, pasuritë tjera afatshkurtëra, detyrimet tjera afatshkurtëra, të hyrat, rrjedha e parasë sipas aktiviteteve (operative dhe investuese), pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe shënimeve shpjeguese nuk ishin të plota

dhe të sakta. Po ashtu, kishte mbi vlerësim të llogarive të arkëtueshme, nënvlerësim të detyrimeve tatimore, të llogarive të pagueshme tregtare, dhe për shkak të përdorimit të bazës kontabël të pa përshtatshme për çështje të vijimësisë.

Në këtë grup gjithashtu janë shtatë (7) ndërmarrje: KRU Drini i Bardhë sh.a, KUR Prishtina sh.a, KRU Hidroregjioni Jugor sh.a, KRM Pastrimi sh.a, Posta e Kosovës sh.a, Telekom i Kosovës sh.a dhe KRU Bifurkacioni sh.a.

Mohim i Opinionit - ZKA ka refuzuar të jap opinion të auditimit për shkak se nuk ishim në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të pasur një bazë për një opinion të auditimit. Kufizimet në marrjen e evidencave të përshtatshme dhe të besueshme dhe pamundësia për të nxjerrë konkluzionet e qarta dhe të bazuara të auditimit, kanë shkaktuar edhe pamundësinë për të formuar një opinion të auditimit.

Mohim të opinionit ka KRM Uniteti sha. Mitrovicë.

Rekomandimet për Bordet Drejtuese dhe Aksionarët e Ndërmarrjeve

- Bordet e Drejtorëve të NP-ve përkatëse duhet të analizojnë shkaqet të cilat kanë ndikuar për Modifikim të Opinionit dhe të merren të gjitha veprimet e nevojshme që çështjet të cilat kanë ndikuar në opinion të korrigjohen apo parandalohen. Gjithashtu, të sigurojnë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që hartimi i PFV të vitit 2020 i adreson të gjitha çështjet që janë ngritur nga auditimi i PFV-ve të vitit 2019; dhe
- Aksionarët të mbajnë përgjegjës Bordet Drejtuese të NP-ve përkatëse dhe të kërkojnë llogari për përgatitjen e drejt dhe korrekte të PFV-ve, si dhe zbatimin e rekomandimeve në të gjitha fushat.

15.2 Rekomandimet e vitit paraprak

NP-të që janë audituar nga kompanitë audituese private vitin paraprak kanë rezultuar me numër më të ultë të rekomandimeve për shkak se fokusi dhe metodologjia e punës së tyre ishte e përqendruar kryesisht tek pjesa e raportimeve financiare, dhe më pak tek pajtueshmëria.

Tabela më poshtë ofron të dhëna në detaje për shkallën e zbatimit të rekomandimeve të vitit 2018.

Tabela 30 - Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të dhëna për vitin 2018

Nr	Ndërmarrjet e audituara	Numri i rekomand.	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara	Të mbyllur të pa zbatuar
1.	KMDK sh.a.	13	8	0	4	1
2.	Stacioni i Autobusëve Prishtinë sh.a.	19	9	3	6	1
3.	Hortikultura sh.a. Prishtinë	14	9	0	3	2
4.	Hekurudhat e Kosovës Trainkos sh.a.	17	7	3	6	1
5.	KRU Hidroregjioni Jugor sh.a. Prizrenit	12	4	0	0	8
6.	Posta e Kosovës sh.a	17	10	7	0	0
7.	Telekomi i Kosovës sh.a	32	13	3	16	0
8.	KRU Prishtina sh.a.	39	10	4	23	2
9.	KRM Pastrimi sh.a	37	16	2	17	2
10.	KRM Uniteti sh.a. Mitrovicë	31	6	3	16	6
11.	Drini i Bardhë sh.a. Pejë	21	12	5	4	0
12.	KRU Bifurkacioni sh.a	4	0	1	3	0
13.	KRU Hidromorava sh.a	9	6	1	2	0
14.	Ndërmarrja e Re Energjetike e Kosovës sh.a ⁸	0	0	0	0	0
Totali i rekomandimeve		265	110	32	100	23

Nga përpunimi i të dhënave në tabelën më lart shihet se:

- Nga rekomandimet e dhëna në vitin paraprak, 42% prej tyre janë zbatuar, 12% prej tyre janë në proces të zbatimit, 38% prej tyre nuk janë zbatuar, dhe 8% janë mbyllur të pa zbatuara.
- NP-të që auditohen nga ZKA, janë më të përkushtuara në zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi paraprak, madje duke e ndikuar edhe ndryshimin/përmirësimin e opinionit të auditorit për PVF e tyre.

15.3 Prokurimet në ndërmarrjet publike

Procesi i prokurimit edhe te NP-të duhet të zbatohet sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Ligjin e Prokurimit Publik në Kosovë.

Rezultatet e auditimit kanë treguar se kontrollet ekzistuese në fushën e prokurimit publik te ndërmarrjet publike përcillen me mangësi në të gjitha fazat. Të gjitha çështjet e ngritura në këtë fushë, janë paraqitur në detaje në raportet individuale të auditimit, por në mënyrë përmbledhëse, po i praqesim edhe në tabelën në vijim.

Tabela 31 - Çështjet kryesore të cilat janë identifikuar gjatë auditimit të Ndërmarrjeve Publike

Çështja	Shkaku	Ndikimi	Veprimet e kërkuara nga menaxhmenti
Planifikimi jo i duhur i procedurave të prokurimit (KRM Pastrimi)	Njësitë kërkuese nuk kishin bërë kërkesën për mallra apo shërbime me kohë.	Mosrealizimi i objektivave vjetore të kompanisë sipas parashikimeve fillestare.	Njësitë kërkuese duhet të parashitrojnë kërkesat me kohë për t'i lejuar zyrës së prokurimit planifikimin dhe inicimin me kohë të aktiviteteve dhe procedurave të prokurimit.
Specifikime teknike jo në harmoni me LPP. (KRM Pastrimi)	Për shkak të mungesës së kontrollit të brendshëm janë hartuar specifikime teknike jo në përputhje me LPP.	Hartimi i specifikimeve teknike në mënyrë diskriminuese, të pa krahasueshme dhe pa përshkrime specifike, ndikon në mungesën e transparencës, duke eliminuar konkurrencën dhe vë në pikëpyetje cilësinë e shërbimeve/ produkteve të pranuar për parane e dhënë.	Të sigurohen, kontrolle adekuate në mënyrë që specifikimet teknike në dosjen e tenderit të përcaktohen duke u bazuar plotësisht në dispozitat ligjore të ligjit të prokurimit, duke ofruar qasje të barabartë të gjithë operatorëve ekonomik.
Mos emërimi i menaxherit të kontratës. (Telekomi i Kosovës, Trainkos, KMDK)	Mos përkushtimi jo i duhur i zyrtarit kryesor administrativ për emërimin e menaxherit të kontratës.	Zbatimi i kontratave në mungesë të menaxherit të kontratave mund të shpie në devijime esenciale të kushteve të kontratës dhe e zvogëlon sigurinë se kontrata është realizuar konform specifikave të parapara.	Të sigurohet emërimi i menaxherëve të kontratave sipas kërkesave ligjore, duke siguruar mbikëqyrje për kontraktuesit që të zbatojnë kontratat në përputhje me termet dhe kushtet e specifikuar në kontratë.
Blerjet pa procedura të prokurimit. (KRM Pastrimi, Stacioni i Autobusëve, KRM Uniteti)	Kjo ka ndodhur pasi që është paraqitur nevoja për blerje të pajisjeve, mallra apo shërbime brenda një periudhe të shkurt kohore, dhe në këtë mënyrë kanë bërë zgjidhje më të shpejtë.	Mosrespektimi i LPP, rrezikon që fondet publike për blerje të mos përdoren në mënyrë transparente dhe të mos respektohet konkurrenca e tregut. Më tej, blerjet e bëra duke mos u mbështetur në kontratë nuk japin siguri për ndodhjen dhe saktësinë e shpenzimeve.	Të sigurohet, që përmes akteve të brendshme të krijojë mekanizma të cilat do të siguronin se të gjitha blerjen e mallrave dhe shërbimeve të jenë në harmoni të plotë me Ligjin e Prokurimit Publik në mënyrë që të arrihet transparenca dhe konkurrenca e nevojshme dhe të sigurohet shfrytëzimi efikas i fondeve publike.

<p>Ndarje e tenderëve për furnizime, shërbime të njëjta, ndërlidhura.</p> <p>(KRU Bifurkacioni, Stacioni i Autobusëve, KRM Uniteti)</p>	<p>Pakujdesia nga ana e njësisë kërkuese, paraqitja e nevojave të paparashikuara në terren për furnizime/ shërbime.</p>	<p>Mungesë transparence dhe kufizim të konkurrencës, duke rrezikuar edhe aspektin kualitativ të furnizimeve të pranuar për parane e shpenzuar.</p>	<p>Planifikim të drejtë dhe të saktë, duke evituar çfarëdo ndarje të aktiviteteve të njëjta të prokurimit, ashtu që të sigurohet blerje efikase dhe të mundësohet në këtë formë respektimi i kërkesave ligjore për parane e shpenzuar.</p>
<p>Mos përmbushja e kërkesës për sigurimin e tenderit nga operatori ekonomik fitues</p> <p>(Posta e Kosovës Sh.A)</p>	<p>Shkak i lëshimeve nga ana e Operatorit Ekonomik dhe Kompanisë së Sigurimeve gjatë përgatitjes së dokumentit për sigurim të tenderit, si dhe lëshimeve nga ana e Komisionit vlerësues të kompanisë për vlerësim të tenderëve.</p>	<p>Në rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik nga procesi i tenderimit, rezulton me anulim të aktivitetit të prokurimit, me ç'rast pamundësohet konfiskimi i vlerës së sigurisë së tenderit nga ana e kompanisë</p>	<p>Komisionet vlerësuese të tenderëve të respektojnë kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, si dhe kërkesat ligjore të prokurimit lidhur me sigurimin e tenderit.</p>
<p>Shpërblimi me kontratë i operatorit ekonomik të papërgjegjshëm</p> <p>(KRU Bifurkacioni)</p>	<p>Pakujdesia e anëtarëve të komisionit të vlerësimit, mungesa e mbikëqyrjes së procesit të vlerësimit nga njësia e prokurimit.</p>	<p>Rrezik për përmbushjen e kontratave sipas kërkesave të specifikuar në dosjen e tenderit dhe kontratës dëme financiare për kompaninë.</p>	<p>Mbikëqyrje efektive ndaj komisioneve të vlerësimit, në mënyrë që të evitohen rastet e shpërblimit me kontratë të operatorëve ekonomik të papërgjegjshëm.</p>
<p>Mangësi gjatë hartimit të dosjeve të tenderit dhe vonesa në kryerjen e punëve.</p> <p>(KRU Bifurkacioni)</p>	<p>Mos konsiderimi i arsyeshëm nga njësia e prokurimit për përfshirje të kërkesave teknike/profesionale në dosjet e tenderëve për punë, mos kërkesa nga njësia kërkuese, mos informimi i njësisë së prokurimit nga menaxherët e projekteve për vonesat në realizim të kontratave.</p>	<p>Shpërblimi me kontratë i operatorëve ekonomik me kapacitete të kufizuara profesionale dhe mungesë stafi, probleme gjatë realizimit të kontratave, dështim në përmbushje të kontratave, dëme financiare për kompaninë si shkak i vonesave në realizim.</p>	<p>Dosjet e tenderit për punë të përfshijnë kërkesat esenciale të përshtatshmërisë teknike dhe profesionale</p>
<p>Vonesë në realizimin e projektit dhe mos vazhdimi i sigurimit të ekzekutimit.</p> <p>(KRU Hidromorava)</p>	<p>të operatorëve ekonomik, si dhe mbikëqyrje rigoroze</p>	<p>Skadimi i periudhës valide të sigurimit të ekzekutimit të kontratës ndikon në zbehjen e përgjegjësisë së OE ndaj Ndërmarrjes për shkak të mungesës së mekanizmave mbrojtës, rastet kur ata mos t'i përmbahen detyrimeve kontraktuale.</p>	<p>Të siguroj se të gjitha projektet e kontraktuara realizohen brenda afateve të parapara, të jenë të mbuluara me sigurim të ekzekutimit të kontratës deri në pranimin final të tyre, dhe në rast të skadimit të vlefshmërisë së sigurimit para përfundimit të projektit, të vazhdohet afati i vlefshmërisë së tij.</p>

<p>Prokurimi i mallrave të përdorura</p> <p>(KRM Pastrimi)</p>	<p>nga menaxherët e projekteve për realizim të kontratave brenda afateve kohore të përcaktuara.</p>	<p>Prokurimi i mallrave të përdorura mund të ndikojnë në cilësinë, performancën dhe funksionalitetin e mallrave dhe mund të ndikojnë në blerje krejtësisht jo efektive për autoritetin kontraktues.</p>	<p>Para inicimit të procedurave të prokurimit nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.</p>
<p>Dëmtim i buxhetit të kompanisë si pasojë e mos përfshirjes së aktivitetit në plan vjetor dhe aplikimit të procedurës së papërshtatshme të prokurimit</p> <p>(Telekomi i Kosovës)</p>	<p>Mos përkushtimit i duhur nga ana e menaxhmentit të kompanisë për përfshirje të aktivitetit në plan vjetor të prokurimit dhe inicim të procedurave brenda afateve kohore optimale, mungesa e informimit me kohë të departamentit të prokurimit.</p>	<p>Kosto shtesë dhe përdorim jo-racional të buxhetit në dëm të kompanisë për ri-alokim të mjeteve brenda departamenteve. Njëkohësisht këto situata vënë në pikëpyetje edhe arritjen e vlerës për para.</p>	<p>Përfshirja e aktiviteteve në planin vjetor të prokurimit si dhe të inicimi me kohë, duke shmangur procedurat e papërshtatshme të cilat shpijnë në shpërblimin e kontratave me kosto shtesë në dëm të kompanisë.</p>

15.4 Analiza e gjendjes financiare në ndërmarrjet publike

Në vijim të kësaj analize, janë paraqitur treguesit kryesor të gjendjes financiare për nëntë ndërmarrje publike të nivelit qendror dhe pesë të nivelit lokal. Subjekt i kësaj analize kanë qenë: të hyrat, shpenzimet, rezultati financiar, detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata.

Tabela 32 - Rezultati financiar dhe detyrimet e Ndërmarrjeve Publike më 31.12.2019 (në euro)

Nr	Subjekti i audituar	Të Hyrat	Shpenzimet	Rezultati financiar	Detyrimet afatshkurtëra	Detyrimet afatgjata
1	Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës Sh.a	2,514,602€	2,295,965€	567,632€	888,235€	750,236
2	Stacioni i Autobusëve Sh.a, Prishtinë	1,015,465	1,079,900	(64,519)	72,134	0
3	Hortikultura Sh.a	1,223,508	1,215,207	8,301	27,651	0
4	Hekurudhat e -Trainkos Sh.a	4,302,127	4,462,991	(160,864)	1,678,548	2,343,782
5	KRU Hidroregjioni Jugor Sh.a, Prizren	5,507,899	5,493,490	14,409	2,290,379	13,670,974
6	Posta e Kosovës sh.a	12,135,707	13,126,013	(990,306)	3,901,626	0
7	Telekomi i Kosovës sh.a	53,589,000	80,505,000	(26,916,000)	71,866,000	0
8	KRU Prishtina Sh.a	17,491,270	17,519,704	(28,434)	4,254,346	45,552,098
9	KRM Pastrimi Sh.a	7,953,770	7,609,699	344,071	1,601,863	0
10	KRM Uniteti Sh.a	1,984,034	1,858,833	125,201	2,554,406	0
11	KRU Drini i Bardhë sh.a	456,327	449,450	6,877	60,946	3,354,825
12	KRU Bifurkacioni sh.a	2,402,109	2,442,188	(40,079)	521,376	5,076,691
13	KRU Hidromorava sh.a	2,840,541	2,638,183	202,358	94,943	5,582,299
14	Ndërmarrja e Re Energjetike e Kosovës	115,000	94,502	20,498	2,934	0

Të hyrat e realizuara nga ndërmarrjet e audituara në vitin 2019 janë 113,531,359€, kurse totali i shpenzimeve ishte 140,791,125€. Gjashtë (6) ndërmarrje publike kishin prezantuar rezultat negativ financiar që në total paraqesin humbje prej 28,200,202€, ndërsa tetë (8) ndërmarrjet tjera kishin prezantuar rezultat pozitiv financiar me një fitim total prej 1,289,347€. Pjesën më të madhe të humbjeve e përbënë Telekomi i Kosovës sh.a në shumën 26,9 milion euro.

Tabela më lartë prezanton shifra shqetësuese për stabilitetin financiar të këtyre ndërmarrjeve. Ato, të gjitha së bashku, kanë afër 90 milionë euro detyrime afatshkurtëra, dhe mbi 71 milionë detyrime afatgjata. Kthimi i këtyre detyrimeve është mjaft i pasigurt, marrë parasysh faktin se të gjithat janë në kufij të rentabilitetit, e në terma real, operojnë edhe me humbje. Madje, parimi i vijimësisë së veprimtarisë në disa prej tyre, mund të vie në pikëpyetje serioze.

Pasi që rreth 90 milionë euro janë obligime afatshkurtra, ekziston rreziku real që këto ndërmarrje të mos jenë në gjendje t'i përmbushin këto detyrime. Në një situatë të tillë, Qeveria do të jetë nën presion që t'i mbulojë deficitet e këtyre ndërmarrjeve për t'iu shmangur procedurave të falimentimit për shkak të interesit publik. Kështu që, nëse nuk merren masa për hartimin e strategjive për

tejkalimin e situatës së krijuar, barra financiare e Qeverisë do të ngarkohet edhe më shumë.

Konkluzionet tona janë se Bordet Drejtuese të ndërmarrjeve publike, nuk ishin mjaftueshëm të përkushtuara për vendosjen e politikave dhe strategjive për tejkalimin e gjendjes jo të mirë në të cilat ndodhen këto ndërmarrje. Prandaj, përfshirja më aktive e Qeverisë në zgjidhjen e problemeve është e domosdoshme.

Rekomandojmë Qeverinë, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Komunitet qe:

- Në bashkëpunim me Bordet e Drejtorëve, të analizojnë rezultatet financiare të ndërmarrjeve publike, me theks të veçantë të atyre që me vite operojnë me humbje, marrjen e masave për një riorganizim të tyre, analizën e detyrimeve afatshkurtëra dhe hartimin e planeve strategjike me masa konkrete përmirësuese; dhe
- Aksionarët të shqyrtojnë performancën e Bordeve të Drejtorëve, dhe aty ku ka ngecje në përmbushjen e detyrave, të merren masa për rritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për “Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit”.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjikimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një opinion të kundërt nëse, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë mohim të opinionit nëse, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin "Theksim i Çështjes" ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në RVA 2018

Institucioni përgjegjës	Rekomandimet e dhëna në RVA 2018	Rekomandimet e zbatuara	Rekomandimet pjesërisht të zbatuara	Rekomandimet e pazbatuara
<i>Kapitulli 1</i>				
Kuvendi i Kosovës	Kuvendi i Kosovës, para se të miratoj Ligjin vjetor të ndarjeve buxhetore për vitin vijues, duhet të sigurohet se të gjitha shpenzimet janë planifikuar sipas kategorive ekonomike adekuate, dhe se të njëjtat nuk janë në kundërshtim me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik; dhe			Edhe në vitin 2019, keqklasifikimet e shpenzimeve në raportet individuale janë evidente. Kjo është e shprehur sidomos me projektet të cilat janë të planifikuara me buxhet në kategori jo përkatëse të shpenzimeve.
	Të siguroj se të gjitha të hyrat e planifikuara me buxhet, janë të specifikuara qartë sipas burimeve përkatëse të financimit.	Është bërë plani vjetor për specifikimin e të hyrave dhe buxhetimi, sipas organizatave buxhetore.		
<i>Kapitulli 9</i>				
	Të siguroj që plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve i përgatitur nga Qeveria, është shqyrtuar nga KMFP. Po ashtu, të përcaktoj saktë veprimet, afatet kohore dhe personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve dhe monitorimin e tyre. Po ashtu, të siguroj që të paktën një herë në vit të shqyrtoj progresin e arritur për rekomandimet e dhëna.		Plani i veprimit është bërë dhe dërguar në ZKA. Megjithatë, i njëjti Sipas KMFP, nuk është dërguar nga Qeveria në KMFP për shqyrtim.	
<i>Kapitulli 13</i>				
Qeveria, Komunitet dhe Bordet përkatëse të Ndërmarrjeve Publike	Qeveria duhet të shqyrtoj çështjen e operimit pa licencë pune të Ndërmarrjes publike KMDK dhe në bashkëpunim me MMPH dhe Bordin Drejtues të kësaj Ndërmarrje, brenda një afati të arsyeshëm, të njëjtën ta pajis me licencë valide të punës;			Nuk është bërë vazhdimi i licencës për administrimin e mbeturinave nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

	<p>Në bashkëpunim me MZHE, të zgjidhin problemin e përcaktimit të tarifave për grumbullimin dhe deponimin e mbeturinave për nevojat e KMDK-së;</p> <p>Aksionari dhe Kryesuesi i Bordit të NP "Uitetit duhet të sigurojë që të hartohen rregulloret e brendshme për menaxhimin e pasurive, ku përcaktohen procedurat standarde për dokumentimin, ruajtjen, tjetërsimin e pasurive dhe regjistrin e plotë dhe të saktë të pasurive, si dhe përgjegjësitë e zyrtarëve përgjegjës për menaxhimin e saj;</p> <p>Aksionari dhe Kryesuesi i Bordit të NP "Uniteti" duhet të sigurojë që janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për nxjerrjen e rregulloreve përkatëse për trajtimin e të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme në funksion të përmirësimit të kontrolleve të brendshme duke përcaktuar procedura dhe kontrolle të qarta, në mbështetje të standardeve dhe rregullave në fuqi; dhe</p> <p>Aksionari dhe Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj krijimin dhe funksionimin e ueb-faqes së internetit me të dhënat e kompanisë dhe të publikojë të gjitha rregulloret, raportet dhe dokumentet që i kërkon ligji i ndërmarrjeve publike, me qëllim të transparencës ndaj palëve të interesit.</p>	<p>Është përpiluar rregullorja për menaxhimin e pasurive.</p> <p>Është përpiluar rregullorja për të hyrat.</p> <p>Është funksionalizuar ueb-faqe e internetit dhe i ka publikuar materialet e nevojshme.</p>		<p>Mos sigurimi i tarifores së re për deponimin e mbeturinave nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE).</p> <p>Kjo situatë vazhdon të jetë e njëjtë edhe për vitin 2019, KMDK-së ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për rregullimin e kësaj situatë. Është bërë kërkesa tek të dy Ministrinë, mirëpo ende nuk kanë marrë ndonjë përgjigje adekuate).</p>
<i>Kapitulli 1</i>				
<p>Ministria e Financave</p>	<p>Me rastin e përgatitjes së Projektligjit vjetor të buxhetit, Ministria e Financave duhet të merr të gjitha masat, të ushtroj kontrolle shtesë dhe të siguroj se organizatat buxhetore kanë planifikuar dhe klasifikuar shpenzimet buxhetore në kategoritë adekuate ekonomike, dhe Qeverisë ë mos i dorëzohet Projektligji me</p>		<p>Ministria e financave ka ndërmarrë masa në rasste të veçanta si psh. te furnizimi me libra, ku është trajtuar drejt kjo çështje. Mirëpo, Edhe në vitin 2019, keqklasifikimet e shpenzime</p>	

	<p>gabime qysh në fazën e planifikimit. Departamenti i buxhetit dhe Thesari duhet të punojnë ngushtë për eliminimin e këtyre gabimeve, para se Plani buxhetor t'i dorëzohet Qeverisë;</p> <p>Para se të miratohet Ligji vjetor i buxhetit, Ministri i Financave duhet të siguroj se amendamentet ligjore të paraqitura nga Komisionet parlamentare, grupet parlamentare apo deputetët, janë në përputhje me kërkesat e planit kontabël dhe nuk implikojnë keq klasifikime të shpenzimeve; dhe</p> <p>Me rastin e planifikimit të të hyrave buxhetore, të siguroj se ekzistojnë analiza të mjaftueshme dhe të qarta për dokumentimin e burimeve përkatëse të të hyrave.</p>		<p>në raportet individuale janë evidente. Kjo është e shprehur sidomos me projektet të cilat janë të planifikuara me buxhet në kategorin e kapitaleve të cilat shpenzime i përkasin kategorive tjera ekonomike.</p> <p>Ka planifikim të të hyrave nga divizioni i makros, mirëpo kërkohet koordinim me OB që janë përgjegjëse për grumbullimin e të hyrave.</p>	<p>Nuk janë vërejtur veprime konkrete për këtë çështje.</p>
<i>Kapitulli 2</i>				
	<p>Ministria e Financave, duhet që me rastin e përgatitjes së Buxhetit fillestar të sqarojë të gjithë zërat buxhetor në mënyrë që bartja e të dhënave nga Tabela 1 në Pasqyra Financiare të jetë e qartë, konsistente dhe pa gabime;</p> <p>Ministria e Financave me rastin e hartimit të buxhetit duhet që shpenzimet t'i planifikoj nëpër kategoritë dhe kodet adekuate, dhe të parandalohet mundësia që keq klasifikimet të përsëriten;</p>		<p>Thesari ka mbajtur trajnimet lidhur me PVF dhe rekomandimet e dhëna. Megjithatë, në 73 OB, PVF-të është dashtë të korrigjohen.</p> <p>Keqklasifikimet në vitin 2019 kanë shënuar rënie. Megjithatë, me rastin e planifikimit të buxhetit kjo dukuri duhet të eliminohet në tërësi.</p>	

	<p>Ministria e Financave në koordinim me komunat të zhvilloj një proces më efikas të monitorimit dhe vlerësimit të planit për grumbullimin e të hyrave, të identifikohen shkaqet që kanë ndikuar në mos përmbushjen e planit dhe të ndërmerren veprime të duhura dhe efikase me qëllim të realizimit të planit; dhe</p> <p>Ministria e Financave duhet të sigurojë që planifikimi i projekteve kapitale i nënshtrohet një analize të kapaciteteve të organizatës për menaxhimin e projekteve në përputhje me planet fillestare. Kontrollat në planifikimin e projekteve dhe realizimin e buxhetit duhet të forcohen për të tejkaluar sfidat e identifikuara me qëllim të arritjes së objektivave brenda afateve kohore. Një harmonizim i rrjedhës së parasë me planifikimin e projekteve, është i domosdoshëm për të adresuar nivelet e ulëta të realizimit financiar të projekteve kapitale.</p>		<p>MF ka hartuar UA për prioritizimin dhe vendosjen e kriterëve për projektet kapitale. Po ashtu Thesari është në proces të zbatimit të reformës në Strategjinë për menaxhimin e financave publike (3 vjeçare).</p> <p>Mirëpo, prapë realizimi i projekteve kapitale ka ngecje të konsiderushme.</p>	<p>Nuk ka progres në këtë fushë.</p>
<i>Kapitulli 3</i>				
	<p>Ministria e Financave duhet të vazhdoj me veprimet e marra në adresimin e projekteve që financohen nga huamarrja dhe t'i paraqes dy herë në vit Qeverisë për informim dhe shqyrtim, raport të konsoliduar të progresit të projekteve me huamarrje, duke i identifikuar sfidat përkatëse dhe duke i propozuar edhe masat për tejkalimin e tyre; dhe</p> <p>Departamenti i Buxhetit të vazhdoj përkrahjen në zbatimin e këtij rekomandimi përmes hartimit të një udhëzimi administrativ për kriteret përzgjedhëse dhe prioritizimin e projekteve kapitale, ndërsa Thesari, para negociimit të huamarrjes, të vazhdoj të aplikoj kërkesën për letër zotuese.</p>	<p>Është hartuar Udhëzimit Administrativ për kriteret dhe prioritizimin e projekteve kapitale</p>	<p>Ministria e Financave ka raportuar në Qeveri mbi nivelin e ekzekutimit të projekteve të huamarrjes dhe sfidave përkatëse. Njëkohësisht, janë dhënë konkluzione dhe rekomandime. Megjithatë, gjendja aktuale nuk ka ndryshuar, dhe niveli i realizimit të projekteve nga borxhet publike mbetet mjaftë i ulët.</p>	

Kapitulli 4			
<p>Thesari përmes trajnimeve të fund vitit lidhur me hartimin e Pasqyrave financiare, të fuqizoj kërkesën që të gjitha organizatat buxhetore t'i themelojnë me kohë komisionet e inventarizim- it dhe vlerësimit të pasurive, dhe rezultatet e inventarizimit të reflektojnë në pasqyra financ- iare; dhe</p>		<p>Thesari ka mbajtur trajnimet lidhur me PVF dhe rekomandimet e dhëna. Megjithatë, nga raportet individuale janë vërejtur mangësitë në PVF dhe Inventarizim.</p>	
<p>Me rastin e pranimit të PFV-ve nga organi- zatat buxhetore, të vendos kontrole formale në veçanti lidhur me raportimin e stoqeve me gjendjen zero, dhe në rastet e tilla të kërkoj sqarime, pasi në raportet e tri viteve të fundit ka diferenca të theksuara.</p>		<p>Gjithashtu, në trajnimet e organizuara, në axhendën e trajnimeve kanë qenë edhe barazimet e llogarive.</p>	
		<p>Mirëpo, prapë ka organizata të cilat kanë raportime të stoqeve me gjendjen zero.</p>	
Kapitulli 6			
<p>Ministria e Financave në koordinim me organi- zatat që kanë detyrime të papaguara, duhet të rishikojnë prioritetin e pagesës së detyrimeve të prapambetura. Madje, MF duhet të shqyrtoj mundësinë që të mos bëj alokime buxhetore para se të jenë shlyer detyrimet e pa paguara. Për rastet e caktuara kur obligimet janë në shuma të larta, pagesa e këtyre borxheve të jetë e programuar me shumë kujdes në mënyrë që të mënjanohen shpenzimet shtesë të kamatave dhe shpenzimet tjera administrative.</p>			<p>Detyrimet e prapambetura ende mbesin sfidë për organizatat bux- hetore. Në anën tjetër, edhe pse detyrimet janë evidente, alokimet për shpenzimet e vitit vijues kanë ndodhur, pa u kryer detyrimet.</p>
<p>Ministria e Financave në koordinim me organizatat buxhetore duhet të sigurohet se nga OB bëhet një vlerësim i përafërt i detyrimeve kontingjente në mënyrë që shpalosjet në RVF të jenë sa më të sakta.</p>		<p>Fakti që në trajnimet e organizuara janë diskutuar rekomandimet dhe vlerësimi/ barazimi i llogarive, megjithatë, tek detyrimet kontingjente, mbesin ende pa vlerësuar drejtë.</p>	

Kapitulli 8				
Ministria e Financave / Ministria e Administratës Publike	Që në bashkëpunim me OB-të, të ndihmojnë përmes procesit buxhetor dhe procedurave të rekrutimit të mundësojnë angazhimin e stafit në pozita të rregullta aty ku ky numër është i aprovuar me ligj.			Situata në vitin 2019 nuk ka ndryshuar, kjo dukuri është hasur prapë në auditimet e raporteve individuale për OB.
Kapitulli 11				
Ministria e Financave	Të sigurohet se të gjitha organizatat hartojnë regjistër të rreziqeve, duke monitoruar menaxhimin e rreziqeve përmes veprimeve të duhura për të vendosur nën kontrollë kërcënimet e mundshme kundrejt objektivave. Të sigurohet përmes monitorimit se menaxhmenti i organizatave buxhetore të cilat janë të obliguara të themelojnë NjAB-në, sa më parë t'i themelojnë këto njësi si dhe t'i plotësojnë me staf, përmes së cilave do të sigurohet funksionimi efikas dhe efektiv i sistemit të kontrollit të brendshëm. Ndërsa, OB-të që nuk janë të obliguara të kenë NjAB-në, funksionin e auditimit të brendshëm ta ushtrojnë përmes mënyrave tjera të parapara me rregullore; dhe	NjQH/MFK ka organizuar trajnime me zyrtarët e të gjitha SSP lidhur me analizën, identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve. Në bazë të informatave nga NjQH, nga pyetësorët vet-vlerësues del se rreth 90% e SSP kanë listat e rreziqeve.	Sipas NjQH, për këtë çështje janë organizuar trajnime me të gjitha Subjektet e Sektorit Publik, rezultatet konkrete dihen pasi të marrim raportet nga SSP (muajin qershor/2020). Krahasuar me periudhën paraprake, ka rënë numri i organizatave që nuk kanë themeluar NjAB-në. Megjithatë, sfidat vazhdojnë për mos kompletimin e stafit të mjaftueshëm brenda NjAB-së. Në kuadër të reformave të Qeverisë, kjo pritet të ndryshojë.	

	<p>Të sigurohet se subjektet e sektorit publik themelojnë Komitetet e Auditimit, të cilat duhet të jenë efektive në mbajtjen e takimeve dhe të kontribuojnë në rritjen e llogaridhënies dhe forcimin e rolit të AB-së dhe ta mbështesin arritjen e objektivave.</p>		<p>Derisa, sipas NjQH-së, përmes ministrit të financave u është dërguar gjitha komunave shkresë për plotësimin e NjAB-ve me staf të nevojshëm.</p> <p>Sipas vendimit të Qeverisë 06/2019, janë obliguar subjektet e sektorit publik që të funksionalizojnë NjAB.</p> <p>Po ashtu, sipas NjQH/ AB, në Nëntor është organizuar një trajnim me të gjitha anëtarët e komiteteve të AB me qëllim të ngritjes së efikasitetit të punës së KA (kjo çështje është trajtuar përmes një puntorie të organizuar nga NjQH, ZKA dhe USAID-i.</p> <p>Mirëpo, nga auditimet individuale është vërejtur se ende ka OB të cilat nuk kanë të themeluar Komitetin e Auditimit.</p>	
<i>Kapitulli 9</i>				
Kuvendet e Komunave	<p>Përsërisim rekomandimin e vitit të kaluar që Kryetarët e Komunave t'i diskutojnë në baza të rregullta raportet e menaxherëve përgjegjës për zbatimin e planeve të veprimit, dhe së paku dy herë në vit, të raportojnë në Kuvendin Komunal lidhur me progresin dhe sfidat në këtë fushë.</p>	<p>Në raportet individuale, nuk janë paraqitur mangësi në këtë proces.</p>		

<i>Kapitulli 14</i>			
Qeveria e Kosovës / Komunat	Qeveria duhet ta sigurojë mekanizma të qëndrueshëm që do të ndihmonin në zbatimin e programeve dhe çështjen e banimit në mënyrë të duhur dhe të siguroj zhvillim të qëndrueshëm social dhe ekonomik;		Janë ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim përmes përpilimit të politikave të punësimit dhe dokumenteve të tjera të rëndësishme. Veprimet e ndërmarra përfshijnë:
	Qeveria duhet të sigurojë që politikat e hartuara do të shërbejnë si përgjigje ndaj gjendjes së krijuar të papunësisë në vend. Politikat qeveritare duhet të nxisin rishpërndarjen e punësimit nëpër sektorë të ndryshëm që janë më premtues dhe që kanë potencial për vende të reja të punës;		Divizioni i Politikave të Punësimit në Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka përgatitur dhe hartuar Politikën e Punësimit 2019 – 2021. MPMS ka Strategjinë Sektoriale 2018 – 2022. Objektivi i parë i Strategjisë Sektoriale i referohet tregut të punës. Po ashtu, Ministria ka përgatitur dhe hartuar Planin e Veprimit për Krijtjen e Punësimit të Rinjve 2018 - 2020 Janë ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim, kontrata për Projektin e Sigurisë është nënshkruar e cila është në realizim deri në vitin 2021. Janë hartuar: strategjia për qeverisje elektronike dhe miratuar strategjia ndaj sulmeve kibernetike. Rekomandimi lidhur me rishikimin dhe aprovimin e listës esenciale është zbatuar. Për auditimin për pajisje mjekësore,
			Periudha e implementimit 2020 – 2021.

			<p>MSh dhe ShSKUK kanë përgatitur planin e veprimit për trajtuar këto çështje.</p> <p>MBPZhR nuk ka dorëzuar plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Vërehet se rekomandimi rreth Përforcimit të mekanizmit për menaxhimin dhe monitorimin e shpenzimeve, ka progres në zbatim.</p>	
	<p>Qeveria duhet të ofroj përkrahje për Sistemet e Teknologjisë Informativë dhe të siguroj që ato janë të besueshme, të sigurta dhe të paprekshme ndaj sulmeve kompjuterike. Qeveria duhet të sigurojë se informacioni është konfidencial dhe të ruaj integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave Qeveria duhet të ndërmarrë veprimet e duhura në mënyrë që barnat esenciale dhe pajisjet mjekësore në QKUK dhe Spitalet e Përgjithshme të jenë në dispozicion për qytetarët gjatë tërë vitit në kohën që ju duhen;</p>	<p>Zyra e Kryeministrit, në fund të vitit 2018 ka rekrutuar dhjetë anëtarë të ri të stafit në sekretariatit koordinues të Qeverisë dhe janë të përfshirë drejtpërdrejtë në zhvillimin e koncept dokumenteve. Nivelet e rritura të stafit i mundësojnë Sekretariatit që të angazhohet më shumë me ministrinë e linjës pasi ekziston një ekuilibër më i</p>	<p>Për auditimin për pajisje mjekësore,</p> <p>MSh dhe ShSKUK kanë përgatitur planin e veprimit për trajtuar këto çështje.</p> <p>MBPZhR nuk ka dorëzuar plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Vërehet se rekomandimi rreth Përforcimit të mekanizmit për menaxhimin dhe monitorimin e shpenzimeve, ka progres në zbatim.</p> <p>Ndërsa, Raporti i rregullsisë për vitin 2019 adreson dy gjetje që ndërlidhen me programin për grantet dhe subvencionet që tregojnë se dy rekomandimet e ngjashme me auditimin e performances janë të pazbatuara.</p>	

	<p>Qeveria duhet të jetë e fokusuar më shumë në zhvillimin e kapaciteteve në nivelin qeveritar duke rritur dhe përdorur kapacitetet e ekspertëve vendor për të kryer analizat e nevojshme të ndikimit ekonomik, planifikimit strategjik dhe komponentëve të tjera të procesit për zhvillimin e politikave dhe legjislacionit; Qeveria duhet të siguroj se ka funksionalizuar mekanizmat monitorues dhe llogaridhënës për të vlerësuar rezultatet e arritura në sektorin e bujqësisë përmes subvencioneve dhe ndihmës nga fondet publike; dhe</p> <p>Komunat duhet të sigurojnë arritjen e plotë të objektivave e synuara përmes ndarjes së tenderëve në lloje si dhe të kryejnë një analizë e plotë e tregut që përfshin mbledhjen dhe analizën e të dhënave të tregut si dhe dokumentimin e tyre.</p>	<p>përshtatshëm mes detyrave dhe mandatit të Sekretariatit dhe burimeve njerëzore të kërkuara.</p>		<p>Nuk ka plan të veprimit për zbatim të rekomandimit. Nuk është vlerësuar.</p>
<p>Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Bordet përkatëse të Drejtorëve</p>	<p>MZHE në bashkëpunim me Kryesuesit e Bordeve të Drejtorëve të NP-ve përkatëse duhet të analizojnë shkaqet të cilat kanë ndikuar në Modifikimin e Opinioneve dhe të merren të gjitha veprimet e nevojshme që çështjet të cilat kanë ndikuar në opinione, të korrigjohen apo parandalohen. Gjithashtu, të sigurojnë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që hartimi i PFV të vitit 2019 i adreson të gjitha çështjet që janë ngritur nga auditimi i viti 2018. Kjo, duke ndërmarrë veprime konkrete për t'i adresuar ato në mënyrë sistematike, përfshirë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme; dhe</p>		<p><i>Kapitulli 15</i></p>	<p>NP-të ende mbesin me Opinione të Modifikuara.</p>

	Aksionarët të mbajnë përgjegjës Bordet e Drejtoreve të NP-ve dhe të kërkojnë llogari për përgatitjen e PFV-ve që paraqesin pamje të drejt dhe korrekte që të përmirësohet cilësia e raporteve për ndërmarrjet respektive dhe për zbatimin e rekomandimeve.		Për një pjese të NP aksionari i ka marr në përgjegjësi Bordet duke i shkarkuar shumicës bordeve të NP-ve në nivelin qendror, por jo ndaj të gjitha NP-ve.	
Qeveria / MZhE / Komunitat	<p>Në bashkëpunim me Kryesuesit e Bordeve Drejtuese duhet të analizojnë rezultatet financiare të ndërmarrjeve publike, në veçanti ndërmarrjeve që operojnë me humbje, të ndërmarrin masa adekuate për riorganizim të NP-ve, të analizojnë gjendjen e detyrimeve, në veçanti atyre afatshkurtëra, të përcaktojnë burimet për likuiditetin e detyrimeve, si dhe përmes planeve vjetore dhe strategjike, të bëjnë riprogramim të borxheve; dhe</p> <p>Komunitat përkatëse si aksionarë kryesor të ndërmarrjeve në nivel lokal, të ushtrojnë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe më rigorozë ndaj menaxhmentit të ndërmarrjeve. Po ashtu, edhe performanca e Bordeve Drejtuese duhet të jetë subjekt i rishikimit, dhe aty ku vlerësohet se Bordet nuk janë të afta në përballimin e detyrave, të merren masa për rritjen e përgjegjësisë dhe efektivitetit në punë.</p>	Është analizuar gjendja e detyrimeve në planet vjetore dhe strategjike të NP-ve përkatëse, ato kanë bërë edhe ri programimin e të tyre në shumicën e rasteve.		Në nivel lokal nuk kanë ndonjë mbikëqyrje më rigorozë. Situata është kryesisht është e njëjtë.

Shtojca III: Pasqyrat kryesore financiare të Qeverisë 2019

*Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për Qeverinë e Përgjithshme
Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019*

		2019	2018	2017
		Llogaria e Vetme e Thesarit	Llogaria e Vetme e Thesarit	Llogaria e Vetme e Thesarit
	Shënim	'000	'000	'000
PRANIMET				
Tatimet Direkte				
Tatimi në të ardhura të korporatave	2	94,593	86,797	75,277
Tatimi në të ardhura personale	3	165,616	152,820	136,924
Tatimi në pronë	4	27,277	24,195	22,407
Tatime tjera direkte	5	4,773	3,692	3,426
		292,259	267,504	238,034
Tatimet Indirekte				
Tatimi mbi vlerën e shtuar	6	845,647	799,020	756,117
Detyrimi doganor	7	130,326	123,747	125,993
Akciza	8	435,496	418,903	432,279
Tatime tjera indirekte	9	3,822	2,460	847
		1,415,291	1,344,130	1,315,236
Kthimet tatimore				
Kthimet tatimore	10	-45,507	-47,880	-57,583
		-45,507	-47,880	-57,583
Të hyrat jo-tatimore				
Taksa, ngarkesa dhe tjera nga OB-të Qeveria Qendrore	11	121,405	110,398	103,445
Taksa, ngarkesa dhe tjera nga OB-të Qeveria Lokale	12	50,050	46,350	43,348
Taksa koncesionare	13	11,083	8,792	8,519
Renta minerare	14	29,385	25,233	30,570
Të hyrat nga interesi (kreditë për NP)	15	2,691	2,092	2,633
		214,614	192,865	188,515
Huamarrja				
Huamarrja e jashtme shtetërore	16	35,041	11,334	108,256
Pranimet për shërbimin e nën-huazimeve	17	7,901	8,250	8,377
Huamarrja e brendshme shtetërore	18	115,322	102,434	95,301
		158,264	122,018	211,934
Grantet dhe ndihmat				

Grantet e përcaktuara të donatorëve	19	7,987	8,319	8,312
Grantet për mbështetje buxhetore	20	11,500	-	-
		19,487	8,319	8,312
Pranimet tjera				
Fondi i depozitave	21	2,081	3,612	2,481
Kthimet e kredive nga ndërmarrjet publike	22	10,876	10,876	6,716
Të hyrat e dedikuara	23	5,555	10,493	9,390
Financimi i njëhershëm i AKP-së	24	150,002	86,146	325
Financimi i njëhershëm nga FKPK-së	25	-	11,590	-
Gjithsej Pranimet		2,222,922	2,009,673	1,923,360
PAGESAT				
Operacionet				
Paga dhe rroga	26	616,921	592,587	550,749
Mallra dhe shërbime	27	273,312	229,057	204,161
Shërbime komunale	28	24,866	23,441	24,158
		915,099	845,085	779,068
Transferet				
Subvencione dhe transfere	29	627,959	558,778	508,316
Shpenzime kapitale				
Prona, impiantet, pajisjet, transferet	30	533,773	533,064	471,098
Pagesat tjera				
Pagesa e borxhit	31	74,633	40,741	77,308
Kthimet nga fondet e depozitave	32	1,082	1,890	1,014
Gjithsej Pagesat		2,152,546	1,979,559	1,836,805
Rritje/(Zbritje) në para të gatshme		70,376	30,115	86,555
Para të gatshme në fillim të vitit	33	387,874	357,760	271,204
Para të gatshme në fund të vitit	33	458,251	387,874	357,760

Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të buxhetit me realizimin për Qeverinë e Kosovës
Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

	2019				2018	2017
	Realizimi	Buxheti përfundimtar	Buxheti fillestar	Ndryshimet buxhetore	Realizimi	Realizimi
	A	B	C	D=B-A		
Shënim	'000 €	'000 €	'000 €	'000 €	'000 €	'000 €
RRJEDHA HYRËSE E PARASË SË GATSHME						
Tatimet direkte	292,259	288,510	288,510	(3,748)	267,504	238,034
Tatimet indirekte	1,415,291	1,492,040	1,492,040	76,749	1,344,130	1,315,236
Kthimet tatimore	(45,507)	(50,000)	(50,000)	(4,493)	(47,880)	(57,583)
Të hyrat jo-tatimore	214,614	208,227	208,227	(6,387)	192,865	185,881
Grantet dhe ndihmat	19,487	18,487	10,500	(1,000)	8,497	8,698
Huamarrja	158,264	336,195	336,195	177,931	122,018	211,934
Pranimet tjera ¹	168,514	187,400	187,400	18,886	122,717	21,547
Gjithsej Pranimet	2,222,922	2,480,859	2,472,872	257,938	2,009,851	1,923,746
RRJEDHA DALËSE E PARASË SË GATSHME						
Shërbimet e përgjithshme publike	285,221	329,487	338,642	44,266	204,611	193,212
Mbrojtja	49,936	56,785	58,990	6,849	46,477	34,914
Rendi dhe siguria publike	197,747	206,425	194,744	8,679	176,342	156,050
Çështjet/marrdhëniet ekonomike	404,517	588,914	571,900	184,397	450,818	418,819
Mbrojtja e ambientit	23,672	41,207	42,786	17,534	16,447	9,934
Çështje banimi dhe komuniteti	43,706	57,416	53,097	13,710	43,212	35,288
Shëndetësia	220,805	240,953	234,284	20,148	199,806	178,607
Rekreacioni, kultura dhe religjioni	60,992	75,944	78,083	14,953	57,080	47,929
Arsim	323,007	351,621	346,048	28,614	301,877	282,747
Mbrojtja sociale	490,679	495,010	459,658	4,331	440,435	401,370
Të tjera ²	52,264	74,005	74,005	21,741	42,631	78,322
Gjithsej Pagesat	33 2,152,546	2,517,767	2,452,237	365,222	1,979,737	1,837,191
Deficiti/Suficiti	70,376	(36,908)	20,635	(107,284)	30,115	86,555

1 Përfshihen: të hyrat e dedikuara, kthimet e kredive nga ndërmarrjet publike, të hyrat e njëhershme të AKP-së, pranimet nga depozitat, si dhe pranimet nga të hyrat e bartura të komunave në vlerë prej 23 milionë euro. Ky pozicion te planifikimi buxhetor (kolona B dhe C) është pasqyruar në përputhje me tabelën 1 të Ligjit të Buxhetit Nr. 06/L-133, ndërsa sipas kërkesave te standardeve te kontabilitetit për sektorin publik (SNKSP) nuk trajtohen si pranime në LLVTH (veçse janë pjese e bilancit bankar të vitit paraprak), por meqë janë planifikuar si pranime - burim i financimit (pra vetem si e hyrë) sipas ligjit të buxhetit (Tabelës 1), pozicioni pranimet nga të hyrat e bartura të komunave është paraqitur në këtë pasqyrë, ashtu siç është aprovuar me ligjin e buxhetit Nr 06/L-133.

2 Përfshihen, pagesa e kryegjësë, nen-huazimi, pagesat për anëtarësim në IFN dhe kthimet nga fondet e depozitave (neto)

*Pasqyra e konsoliduar e pasurive financiare dhe bilanceve të fondeve për Qeverinë e Kosovës
Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019*

		2019	2018	2017
		Llogaria e Vetme e Thesarit	Llogaria e Vetme e Thesarit	Llogaria e Vetme e Thesarit
	Shënim	'000 €	'000 €	'000 €
Pasuritë financiare - paraja e gatshme				
Banka Qendrore e Kosovës	34	444,301	374,663	339,906
Kuotat në IFN	35	1,741	1,741	-
Fondi në mirëbesim për zhvillim	36	4,754	4,514	5,047
Paratë e gatshme në transit	37	4,632	4,031	10,179
Llogaritë e ambasadave të Republikës së Kosovës	38	1,136	1,074	1,045
Paratë e gatshme (arka) dhe avance të hapura	39	1,687	1,851	1,583
Gjithsej pasuritë në para të gatshme		458,251	387,874	357,760
Qëllimet specifike				
Të përcaktuara nga donatorët	40	8,866	7,803	6,452
Të hyrat vetanake të bartura - niveli qendror	41	5,741	3,932	2,772
Të hyrat vetanake të bartura - niveli lokal	42	49,477	44,308	30,108
Fondi në mirëbesim për zhvillim	43	8,004	8,689	8,755
Të hyrat e dedikuara	44	803	1,706	803
Të tjera	45	17,504	16,432	14,722
Fondet e pashpenzuara nga huamarrja ³	46	7,000	-	-
		97,395	82,870	63,612
Të pashpërndara⁴		360,856	305,004	294,147
Gjithsej Bilanci i Fondeve	33	458,251	387,874	357,760

³ Përfshihet shuma e disbursuara prej 7 mil. Euro dhe e pashpenzuar, për projektin: "Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore 10 nga kreditori Banka Evropiane për Investime". Për detaje referoju aneksit 20.1

⁴ Përfshihen bilancet e pashpenzuara nga fondet e AKP-së të mbetura në fund të vitit 2019, në shumë prej 18.2 milionë euro, të cilat mbahen si rezervë në përputhje me Nenin 22/C të LMFPP-së.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije Ministry of Finance Arkiva - Arhiva - Archive	
№. I faqeve Broj stranica No. pages: Kryesia Org. Org. Indim. Org. Unit	01
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No:	1259
Data Datum Date:	14. 08. 2020
PRISHTINË/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, ju konfirmojmë se:

- kemi pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare Vjetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kemi ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzojmë një plan të veprimt për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Prishtinë, 14 Gusht 2020


.....
Hykmete Bajrami
Ministre e Ministrisë së Financave




.....
Ahmet Ismaili
Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit

